Banka e Shqipërisë

RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2012

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë, sheshi "Avni Rustemi", nr.24, Tiranë
Tel: 355 4 2419301/2/3
Faks: + 355 4 2419409/10/11
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

Tirazhi: 900 kopje

P Ë R M B A J T J A

HYRJE		*7*
SQARIME		*8*
DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2012		*9*
1.	*ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE*	*15*
1.1	*Zhvillimet kryesore në tregjet financiare*	*19*
2.	*ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012*	*23*
2.1	*Sektori i ekonomisë reale*	*23*
2.2	*Tregu i banesave*	*26*
2.3	*Pozicioni financiar dhe ekspozimi ndaj rreziqeve i individëve dhe bizneseve*	*28*
3.	*TREGJET FINANCIARE*	*41*
3.1	*Tregu primar i titujve të borxhit*	*41*
3.2	*Tregu sekondar i titujve të borxhit*	*43*
3.3	*Tregu ndërbankar*	*44*
3.4	*Tregu i këmbimeve valutore*	*45*
4.	*ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012*	*46*
4.1	*Ecuria e sistemit të pagesave*	*46*
5.	*ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR*	*48*
6.	*SEKTORI BANKAR*	*53*
6.1	*Ecuria e aktiv-pasiveve dhe përbërja e tyre*	*53*
6.2	*Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve*	*54*
6.3	*Teprica e kredisë*	*57*
6.4	*Ecuria e depozitave*	*63*
6.5	*Kapitalizimi i veprimtarisë*	*65*
6.6	*Rezultati financiar dhe eficienca e burimeve*	*66*
7.	*MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILËVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR*	*69*
7.1	*Rreziqet e tregut*	*69*
7.2	*Rreziku i kreditit*	*71*
7.3	*Rreziku i likuiditetit*	*75*
7.4	*Vlerësim i qëndrueshmërisë së sektorit bankar sipas ushtrimit të provës së rezistencës*	*77*
ANEKS		*81*
Shtojcë 1. Indeksi i Fortësisë Financiare		*81*
Shtojcë 2. Indeksi i rrezikut sistemik dhe rezultatet e vrojtimit për perceptimin e rrezikut sistemik nga bankat		*84*

HAPËSIRA INFORMUESE

Hapësirë Informuese 1.	Vendimet politike të Samitit Evropian të 28-29 qershorit 2012.	18
Hapësirë informuese 1.2.	Zhvillimet për grupet bankare që operojnë në Shqipëri.	22
Hapësirë informuese 2.	Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj Greqisë dhe Italisë.	25
Hapësirë informuese 3.	Vrojtimi mbi situatën financiare të individëve dhe bizneseve.	38
Hapësirë informuese 5.1.	Sektori financiar jobankar.	50
Hapësirë Informuese 6.2.	Ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët.	56
Hapësirë informuese 6.3.1.	Kredia e re.	59
Hapësirë informuese 6.3.2.	Lidhja midis kredisë së re nga njëra anë, dhe cilësisë së portofolit dhe normave të interesit nga ana tjetër.	61
Hapësirë informuese 6.4.1.	Depozitat e reja me afat.	64
Hapësirë informuese 6.6.	Faktorët që ndikojnë kthimin nga kapitali (ROE).	67
Hapësirë informuese 7.4.	Prova e rezistencës përmes përqasjes "poshtë-lart".	80
Hapësirë informuese 8.1.	Indeksi i rrezikut sistemik financiar për Shqipërinë	84
Hapësirë informuese 8.2.	Rezultatet e vrojtimit "Perceptimi i rrezikut sistemik nga sektori bankar".	86

PËRMBAJTJA E TABELAVE

1. Zhvillimet ndërkombëtare

Tabelë 1.1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën. 17
Tabelë 1.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për Evropën Lindore Qendrore e Juglindore. 19
Tabelë 1.3. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri (miliardë euro). 22

2. Zhvillimet makroekonomike në Shqipëri gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012

Tabelë 2.1. Ecuria e investimeve të huaja direkte sipas vendeve. 26

4. Zhvillimet në sistemin e pagesave gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012

Tabelë 4.1. Aktiviteti në AIPS për gjashtëmujorin e parë 2012. 46
Tabelë 4.2. Aktiviteti në AECH për periudhën janar-qershor 2012. 46
Tabelë 4.3. Shpërndarja e pagesave për klient sipas llojit të instrumenteve për periudhën janar-qershor 2012. 47

5. Zhvillimet në sistemin financiar

Tabelë 5.1. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në përqindje). 48
Tabelë 5.2. Ecuria e disa treguesve të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre. 51

6. Sektori bankar

Tabelë 6.1. Angazhimet e marra nga bankat mëma dhe bankat e tjera të grupit. 55
Tabelë 6.5.1. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit. 65
Tabelë 6.6.1. Zbërthimi i ROE-s. 67

7. Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar

Tabelë 7.4.1. Supozimet për ndërtimin e stress test-it. 78
Tabelë 7.4.2 a). Rezultatet për fundin e vitit 2012. 79
Tabelë 7.4.2 b). Rezultatet për fundin e vitit 2013. 79

Shtojca

Tabelë 8.1. Ecuria e nënindekseve dhe indeksit të fortësisë financiare për sektorin bankar. 83

P Ë R M B A J T J A E G R A F I K Ë V E

1. Zhvillimet ndërkombëtare

Grafik 1.1. Ecuria e normave të interesit në tregjet kryesore të parasë dhe të obligacioneve shtetërore. 20

2. Zhvillimet makroekonomike në Shqipëri gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012

Grafik 2. Struktura e eksport-importeve sipas vendeve. 25
Grafik 2.1. Zhvillimet në tregun e banesave. 27
Grafik 2.2. Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit. 29
Grafik 2.3. Ecuria e kredisë për individët. 30
Grafik 2.4. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit. 31
Grafik 2.5. Cilësia e kredisë së individëve. 31
Grafik 2.6. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë për shkak të normës së interesit. 32
Grafik 2.7. Pozicioni financiar i bizneseve. 33
Grafik 2.8. Struktura e kredisë sipas afatit të maturimit për bizneset. 34
Grafik 2.9. Cilësia e portofolit të bizneseve. 35
Grafik 2.10. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë për shkak të kursit të këmbimit. 35
Grafik 2.11. Cilësia e kredisë për bizneset. 36
Grafik 2.12. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit. 37
Grafik 2.13. Balanca neto e përgjigjeve mbi zhvillimet në aftësitë paguese të individëve dhe pritshmëritë përkatëse. 39
Grafik 2.14. Indeksi i shpërndarjes së pritshmërive mbi pagesën e huasë. 40

3. Tregjet financiare

Grafik 3.1.1. Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë (në %). 42
Grafik 3.1.2. Vëllimi dhe normat e kthimit të bonove në tregun primar. 42
Grafik 3.1.3. Ecuria e ankandeve të obligacioneve. 43
Grafik 3.1.4. Normat mesatare të interesit të borxhit në tregun primar. 43
Grafik 3.2.1. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar. 44
Grafik 3.3.1. Vëllimi dhe normat e interesit në tregun ndërbankar. 44
Grafik 3.4.1. Ecuria e kursit të këmbimit për tre monedhat kryesore. 45
Grafik 3.4.2. Treguesit e kursit nominal efektiv (NEER) dhe të kursit real efektiv (REER). 45

5. Zhvillimet në sistemin financiar

Grafik 5.1. Pesha e subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi, në përqindje. 49
Grafik 5.2. Ecuria e aktiveve dhe portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka. 50
Grafik 5.3. Ecuria e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe e raportit të huave me probleme, në përqindje. 50
Grafik 5.4. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit, në përqindje. 52

6. Sektori bankar

Grafik 6.1.1. Kontributi i zërave të aktiveve në rritjen e aktiveve, në pikë përqindje. 53
Grafik 6.1.2. Financimi me bazë vjetore i aktiveve të sektorit bankar, në pikë përqindje. 54
Grafik 6.2.1. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve. 55
Grafik 6.2.2. Ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët. 56
Grafik 6.3.1. Ecuria vjetore e kredisë për subjektet individë dhe biznese, në përqindje. 58
Grafik 6.3.2. Ecuria e kredisë për subjektet private dhe sektorët me kontributin në rritje. 58

Grafik 6.3.3. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit. 58
Grafik 6.3.4. Kredia e re dhe përdorimi i kredisë. 59
Grafik 6.3.5. Shpërndarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe për individët sipas qëllimit të përdorimit, në përqindje. 59
Grafik 6.3.6. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë. 60
Grafik 6.3.7. Ecuria e normës të interesave për kreditë e reja në lekë dhe valutë. 61
Grafik 6.3.8. Indeksi i korrelacionit midis kredisë së re dhe raportit të kredive me probleme, sipas sektorëve. 62
Grafik 6.3.9. Indeksi i korrelacionit midis kredisë së re dhe normës së interesit, sipas qëllimit të përdorimit. 62
Grafik 6.4.1. Norma e rritjes së depozitave, në përqindje. 63
Grafik 6.4.2. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit. 63
Grafik 6.4.3. Ecuria e depozitave të reja. 64
Grafik 6.4.4. Normat e interesit për depozitat e reja me afat, në përqindje. 64
Grafik 6.5.1. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, në përqindje. 65
Grafik 6.6.1. Ecuria e kthimit nga kapitali (RoE) dhe aktivet (RoA), në përqindje. 66
Grafik 6.6.2. Kthimi nga kapitali dhe aktivet për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje. 66
Grafik 6.6.3. Ecuria dhe përbërja (e linearizuar) e ROE-s. 68

7. Monitorimi i rreziqeve ndaj të cilëve ekspozohet sektori bankar

Grafik 7.1.1. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '06 – qershor '12). 69
Grafik 7.1.2. Ecuria e pozicioneve valutore neto ndaj kapitalit rregullator, në përqindje. 69
Grafik 7.1.3. Ecuria e pozicioneve valutore neto ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje. 70
Grafik 7.1.4. Diferenca midis aktiveve-pasiveve sipas periudhave të riçmimit (në mln lekë). 70
Grafik 7.1.5. Ecuria e ndryshimit të normave të kredive dhe depozitave me afat, në përqindje. 71
Grafik 7.2.1. Ecuria e aktiveve me rrezik, indeks dhjetor 2005=100. 72
Grafik 7.2.2. Ecuria e aktiveve me rrezik sipas grupeve të bankave, në përqindje. 72
Grafik 7.2.3. Ecuria e huave me probleme, në përqindje. 72
Grafik 7.2.4. Ecuria e provigjoneve (boshti në të majtë) dhe e raportit të mbulimit të huave me probleme (boshti në të djathtë), në përqindje. 73
Grafik 7.2.5. Ecuria e klasave të portofolit të kredisë, në përqindje. 73
Grafik 7.2.6. Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, në përqindje. 74
Grafik 7.2.7. Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve. 75
Grafik 7.3.1. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve, në muaj. 75
Grafik 7.3.2. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave dhe kredive, në muaj. 76
Grafik 7.3.3. Ecuria e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje. 76
Grafik 7.3.4. Ecuria e aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në përqindje. 77
Grafik 7.4.1. Shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të kredive me probleme për tremujorin e fundit të vitit 2012 dhe 2013 të simuluara me metodën Monte Carlo sipas skenarit bazë dhe skenarit të rënduar. 78

Shtojca

Grafik 8.1. Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare. 82
Grafik 8.1.1. Indeksi i rrezikut sistemik financiar. 84
Grafik 8.1.2. Indeksi i stresit të sistemit financiar pa përfshirjen e nënindeksit të tregut të shtëpive. 85
Grafik 8.2.1. Rreziqet më të vështira për t'u përballuar në nivel institucioni. 86
Grafik 8.2.2. Probabiliteti i ndodhjes së një rreziku të rëndësishëm sistemik. 86
Grafik 8.2.3. Ndryshimi i probabilitetit të ndodhjes së një rreziku sistemik. 87
Grafik 8.2.4. Besueshmëria e bankave në sistemin financiar shqiptar. 87

HYRJE

Ky është numri i tetë i Raportit të Stabilitetit Financiar, një dokument i Bankës së Shqipërisë që publikohet dy herë në vit. Qëllimi i raportit është identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve me të cilat ndeshet sistemi financiar dhe infrastruktura e tij, për t'i dhënë autoriteteve publike mundësinë që të identifikojnë masat përkatëse për korrigjimet e nevojshme. Në hyrje të dokumentit është vendosur Deklarata e Stabilitetit Financiar, publikimi i së cilës çdo gjashtë muaj është një kërkesë ligjore.

Për hartimin e raportit, janë shfrytëzuar të dhëna që disponohen në Bankën e Shqipërisë, është shkëmbyer informacion me autoritete të tjera që mbikëqyrin veprimtarinë e tregut financiar, si edhe janë shfrytëzuar informacione dhe analiza të institucioneve të vendit dhe të atyre financiare ndërkombëtare, publike dhe private. Të dhënat dhe analizat e paraqitura përfshijnë kryesisht zhvillimet gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012. Nëse nuk përcaktohet ndryshe në raport, pritjet për zhvillimet e ardhshme ekonomike dhe financiare shtrihen deri në fund të vitit 2012.

Qëndrueshmëria e sistemit financiar është vlerësuar në bazë të ecurisë dhe rreziqeve që krijohen nga ndërveprimi i tij me mjedisin e përgjithshëm ekonomik, të brendshëm dhe të jashtëm, si edhe nga vetë veprimtaria e tij. Për të vlerësuar rreziqet që vijnë për shkak të ndërveprimit me mjedisin rrethues, janë analizuar zhvillimet më të fundit në tregjet financiare ndërkombëtare dhe në ekonomitë e zhvilluara e ato të rajonit, si dhe është bërë një vlerësim mbi ndikimin e tyre në sistemin financiar të vendit dhe sektorin bankar. Ndër treguesit e brendshëm, janë vlerësuar zhvillimet e përgjithshme dhe pritshmëritë për rritjen ekonomike, bilancin tregtar, nivelin e përgjithshëm të çmimeve, kursin e këmbimit dhe treguesit fiskalë. Gjithashtu, nëpërmjet një analize të situatës së punëzënies dhe të ecurisë së të ardhurave, është vlerësuar gjendja financiare e bizneseve dhe e individëve dhe ndikimi mbi aftësinë paguese të kredimarrësve të sektorit bankar.

SQARIME

Në fund të muajit qershor 2012, bankat e sektorit bankar shqiptar ndahen sipas madhësisë së aktivitetit të tyre në:

a) banka të Grupit 1 (secila nga 0-2% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Veneto Banka, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Banka e Parë e Investimeve, Banka e Kreditit të Shqipërisë;

b) banka të Grupit 2 (secila nga 2-7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Procredit, Banka Emporiki, Banka Kombëtare e Greqisë, Banka Societe Generale - Albania, Banka Alfa – Shqipëri, Banka Union;

c) banka të Grupit 3 (secila mbi 7% të totalit të aktiveve të sektorit): Banka Raiffeisen, Banka Credins, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Intesa Sanpaolo –Shqipëri, Banka Tirana.

Në fund të muajit qershor 2012, sipas origjinës së kapitalit, bankat e sektorit bankar shqiptar ishin:

d) me kapital[1] austriak: Banka Raiffeisen;

e) me kapital italian: Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, Veneto Banka;

f) me kapital grek: Banka Alfa-Shqipëri, Banka Tirana, Banka Kombëtare e Greqisë;

g) me kapital francez: Banka Societe Generale, Banka Emporiki;

h) me kapital shqiptar: Banka Credins, Banka Union.

Në fund të muajit qershor 2012, shtrirje të rrjetit të degëve jashtë vendit evidenton Banka Kombëtare Tregtare dhe Banka Intesa Sanpaolo – Shqipëri, përkatësisht në Prizren, Kosovë dhe Athinë, Greqi.

[1] *Sipas origjinës së kapitalit, kur kapitali i huaj përbën më shumë se 50% të madhësisë së kapitalit të paguar të bankës.*

DEKLARATA E STABILITETIT FINANCIAR PËR GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2012

Në mbështetje të kërkesës së nenit 69 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr. 9962, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për të informuar Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave, si edhe për të tërhequr vëmendjen e institucioneve financiare dhe të publikut mbi gjendjen e sistemit financiar në vend dhe rreziqet potenciale që mund të kërcënojnë qëndrueshmërinë e tij, Banka e Shqipërisë publikon këtë deklaratë periodike. Kjo deklaratë është pjesë përbërëse e Raportit të Stabilitetit Financiar për të njëjtën periudhë.

Gjatë periudhës, gjendja dhe ecuria e sektorit bankar dhe e sistemit financiar u paraqitën të qëndrueshme. Sektori bankar dhe sistemi financiar kanë vepruar në një mjedis më sfidues, të karakterizuar nga ngadalësim i rritjes ekonomike të brendshme dhe të jashtme, rënie e stimulit financiar publik dhe ngadalësim i investimeve dhe konsumit privat, ngadalësim i ritmeve të kreditimit të sektorit bankar dhe rënie e mëtejshme e cilësisë së saj, si edhe ndryshime të diktuara strukturore të likuiditetit në tregun ndërbankar. Megjithatë, gjatë periudhës, sektori bankar ka gjeneruar fitim dhe treguesit e kapitalizimit e të likuiditetit të veprimtarisë u paraqitën në nivele të mira. Ndikimi i drejtpërdrejtë i rreziqeve të tregut në sektorin bankar vlerësohet i moderuar, por ndikimi i tërthortë që buron si rezultat i ekspozimit të individëve dhe bizneseve është i rëndësishëm, duke sugjeruar nevojën për një monitorim të kujdesshëm nga ana e sektorit bankar. Rënia e cilësisë së kredisë përfaqëson shqetësimin kryesor për qëndrueshmërinë e treguesve financiarë të sektorit bankar. Në kushtet kur zhvillimet në mjedisin ekonomik të brendshëm dhe të jashtëm nuk mbështesin një përmirësim të qëndrueshëm të pritjeve të operatorëve për zhvillimet ekonomike, përmirësimi i cilësisë së kredisë nuk mund të vijë në masën dhe me shpejtësinë e duhur vetëm nga veprimtaria normale e sektorit bankar. Trajtimi me efektivitet i këtij problemi, kërkon bashkëpunimin dhe angazhimin e sektorit bankar dhe të autoriteteve publike në vend, për ndërmarrjen e masave paralele në disa drejtime, si në vijim.

Së pari, përmirësimi i monitorimit të kredisë në banka duhet të vijojë me përparësi në drejtim të: forcimit të strukturave përkatëse për vlerësimin e cilësisë së kredimarrësit dhe mbledhjen e kredisë; përshpejtimit të veprimeve që mundësojnë ristrukturimin e kredisë për kredimarrësit e vlefshëm; krijimin e rezervave për mbrojtjen nga rreziku i kredisë në mënyrë proaktive; ndërmarrjen e veprimeve të vendosura për njohjen e efektit financiar që buron nga kreditë e humbura, fshirjen e tyre nga bilanci dhe ekzekutimin e kolateralit për rikuperimin maksimal të vlerës

së kredisë. Nëse kryhen në mënyrë profesionale dhe transparente, këto veprime do të çlirojnë burime financiare për sektorin bankar që do të mbështesin më mirë veprimtarinë e kreditimit në vijim.

Së dyti, angazhimi i autoriteteve publike, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, është i nevojshëm për të stimuluar dhe përshpejtuar këto procese në sektorin bankar nëpërmjet krijimit të stimujve të nevojshëm ligjorë dhe financiarë. Banka e Shqipërisë thekson rëndësinë që ka përmirësimi i shpejtë i kuadrit ligjor për forcimin e infrastrukturës së ekzekutimit të kolateralit për kredinë bankare, dhe vlerëson reformën e rëndësishme të realizuar me krijimin e subjekteve përmbarimore private. Në vijim, është e nevojshme të kryhen përmirësime të tjera ligjore dhe operacionale që: përmirësojnë edukimin financiar të gjykatësve dhe rrisin eficiencën e gjykatave në trajtimin e shpejtë e të saktë të praktikave kredituese të paraqitura; sigurojnë konsistencën e vendimeve të gjykatave të së njëjtës shkallë për praktika të ngjashme kredituese; çojnë në përmirësimin e rezultatit të ankandit për shitjen e kolateralit që siguron kredinë; lidhin më mirë shpërblimin financiar të subjekteve përmbarimore private me performancën e tyre në zbatimin e urdhrit të ekzekutimit të kolateralit; nxisin zgjidhjen jashtë gjykatës të pretendimeve mes kreditorit dhe debitorit; mundësojnë formimin dhe hyrjen në treg të institucioneve financiare jobanka që, nëpërmjet negocimit me bankat, marrin përsipër të vlerësojnë dhe të administrojnë apo blejnë pjesë të portofolit të kredive me probleme. Banka e Shqipërisë vlerëson se këto propozime, të identifikuara nëpërmjet bashkëpunimit mes autoriteteve publike, institucioneve financiare ndërkombëtare dhe Shoqatës Shqiptare të Bankave, ofrojnë zgjidhje të provuara edhe në vende edhe situata të ngjashme, duke krijuar premisat për një trajtim të gjithanshëm dhe zgjidhje të qëndrueshme të kredive me probleme.

Së treti, në këtë proces sektori bankar duhet të vijojë të mbetet i mirëkapitalizuar dhe likuid. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë do të sigurojë që bankat të realizojnë vlerësime të sakta të nevojave të tyre për kapital shtesë dhe për mjete likuide, duke analizuar me kujdes profilin e rrezikut të veprimtarisë së tyre dhe duke vepruar në mënyrë proaktive për sigurimin e tyre.

Më konkretisht, ndërveprimi i sistemit financiar me mjedisin ekonomik dhe ekspozimi ndaj rreziqeve të ndryshme në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, vlerësohet në vijim.

Gjatë periudhës, ritmet e rritjes së ekonomisë botërore ishin të paqëndrueshme. Ato reflektuan kryesisht ecurinë e dobët ekonomike të Eurozonës dhe dobësitë strukturore, kryesisht në tregjet e punës dhe të pasurive të paluajtshme. Kontributi i vendeve të zhvilluara në rritjen ekonomike botërore vijoi të ishte ndjeshëm më i ulët se ai i vendeve në zhvillim. Pritjet më të ulëta për rritjen e ekonomisë botërore si edhe tensionet në tregjet financiare, veçanërisht në Eurozonë, kanë nxitur autoritetet evropiane të ndërmarrin disa veprime që synojnë të lehtësojnë

koston e rifinancimit të borxhit për vendet anëtare periferike, të stabilizojnë sistemin bankar dhe të forcojnë mekanizmat evropiane për kapitalizimin e tij. Suksesi i këtyre masave është i dëshiruar jo vetëm për vendet e Eurozonës, por edhe për vendet e tjera që rrethojnë Bashkimin Evropian dhe që ndikohen negativisht nga gjendja e tij përmes kanaleve të tregtisë, të lëvizjeve të kapitalit njerëzor dhe financiar, si edhe të integrimit të sistemit financiar.

Rënia e kërkesës së huaj, duket se ka patur ndikimin e saj edhe në ecurinë e dobët të ekonomisë së vendit. Prodhimi i Brendshëm Bruto u tkurr në tremujorin e parë të vitit 2012 me 0.2% në terma vjetorë dhe 1.2% në terma tremujorë. Sektorët që kontribuan në këtë rënie ishin industria, ndërtimi, postë-komunikacioni dhe transporti. Sektorët që patën një ecuri pozitive ishin shërbimet, tregtia dhe bujqësia. Treguesit e tërthortë sugjerojnë se zhvillimet në terma të konsumit privat dhe investimeve private janë të ngadalta, duke sjellë ulje të kontributit të tyre në ecurinë e ekonomisë. Procesi i konsolidimit fiskal është shoqëruar me tkurrjen e stimulit financiar publik për ekonominë. Dobësia e kërkesës së huaj u shoqërua me një ngadalësim të ndjeshëm të eksporteve shqiptare krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Gjendja financiare e individëve/familjeve dhe bizneseve, shfaqi të njëjtat prirje si në periudhën e mëparshme. Individët kanë zgjeruar më tej pozicionin e tyre kreditor, për shkak të rritjes së depozitave më shpejt se kreditimi në sistemin financiar. Pozicioni i bizneseve vijon të mbetet thellësisht debitor dhe në pjesën dërrmuese të tij është në valutë. Kreditimi i sektorit të biznesit gjatë pjesës së parë të vitit 2012 u rrit me ritme më të ulëta, ndërsa kreditimi i individëve u tkurr. Cilësia e kredisë për individët dhe bizneset ka rënë. Individët dhe bizneset janë të ekspozuar ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit, që mund të vijë për shkak të lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit ose në normën e interesit.

Aktiviteti i operatorëve në tregjet financiare është zgjeruar. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga vëllime më të larta të transaksioneve dhe qëndrueshmëri e normave të interesit, duke dëshmuar aftësinë për të përmbushur nevojat e bankave për likuiditet. Në tregun e titujve të borxhit, janë regjistruar nivele më të larta të kërkesë-ofertës në tregun primar dhe tregtimin e tyre në atë sekondar. Gjatë periudhës, tregu sekondar i titujve të borxhit ka shënuar vëllime më të larta të tregtimit, duke reflektuar veprimet mes bankave për t'iu përshtatur ndryshimeve strukturore të likuiditetit, si edhe hyrjen në treg të operatorëve të rinj jobankarë. Një ndër zhvillimet kryesore në tregjet financiare ka qenë vendimi i një banke të madhe në vend, pjesë e një grupi të rëndësishëm bankar evropian, për tërheqjen e papritur nga ankandet e borxhit të Qeverisë Shqiptare. Shkak për këtë veprim ishte kërkesa e autoritetit rregullativ të vendit të origjinës, në zbatim të rekomandimeve të Autoritetit Bankar Evropian për përmirësimin e treguesve të kapitalit të grupeve më të mëdha bankare evropiane. Oferta e likuiditetit të bankave të tjera të sektorit dhe veprimet e fuqishme mbështetëse të Bankës së Shqipërisë, arritën të plotësojnë

vakumin e krijuar dhe të ruajnë luhatshmëri të ulët të normave të interesit tek titujt e borxhit të qeverisë. Sidoqoftë, kjo ngjarje, e cila testoi kuadrin e Bankës së Shqipërisë për operacionet në treg, tregoi nevojën për rritjen e konkurrencës në tregun bankar, për zgjerimin e bazës së investitorëve në titujt e borxhit të qeverisë dhe përmirësimin e funksionimit të tregut sekondar, me qëllim uljen e përqendrimit në shpërndarjen e borxhit dhe pakësimin e rrezikut të rifinancimit. Edhe tregu i këmbimeve valutore ka njohur rritje të vëllimeve të tregtimit. Në këtë treg, monedha kombëtare ka shfaqur qëndrueshmëri ndaj shportës së valutave kryesore.

Sistemi financiar zgjeroi më tej veprimtarinë e tij, ndonëse me ritme më të ngadalësuara. Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i llogaritur si raport i aktiveve të sistemit financiar ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) vlerësohet në nivelin 92.8% në fund të qershorit 2012, nga 89.5% në fund të vitit 2011 dhe 86.9% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar, aktivet e të cilit përfaqësojnë rreth 93.9% të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi dhe rreth 87.2% të PBB-së. Gjatë periudhës, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 3.4% krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe me rreth 11% ndaj së njëjtës periudhë të një viti më parë. Shoqëritë e sigurimit përfaqësojnë segmentin e dytë më të rëndësishëm të sistemit financiar. Në këtë periudhë, ka filluar të veprojë edhe një institucion financiar që ofron skema të investimit kolektiv, duke zgjeruar mundësitë e investimit të subjekteve të ndryshme. Në sektorin bankar, kontribuesi kryesor në ecurinë e aktiveve është aktiviteti kreditues, ndonëse ai ka ardhur në rënie si pasojë e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe të një sjelljeje më të kujdesshme nga ana e bankave në akordimin e kredisë. Në financimin e aktivitetit bankar ka kontribuar pothuaj totalisht aktiviteti depozitues. Ky konsiderohet si zhvillim pozitiv, i cili ndikon në qëndrueshmërinë e gjendjes së likuiditetit të sektorit bankar. Nga ana tjetër, ky zhvillim evidenton nevojën për ruajtjen e vazhdueshme të besimit të publikut në sektorin bankar. Në fund të periudhës, treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit rezultoi 15.7%. Sektori bankar gjeneroi rezultat financiar pozitiv, ndonëse ai vijoi të ishte i përqendruar tek bankat më të mëdha. Cilësia e kredisë ka shënuar rënie, pothuaj në të gjitha grupndarjet e saj. Raporti i kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë shënoi vlerën 21.1% në fund të periudhës.

Rreziqet për sistemin financiar burojnë nga ndërveprimi i tij me mjedisin ekonomik rrethues dhe nga vetë veprimtaria e tij.

Në lidhje me ndikimin prej zhvillimeve makroekonomike, vlerësohet se stimuli fiskal dhe kontributi i kërkesës së huaj në rritjen ekonomike do të mbeten të ulëta. Ashtu si edhe në deklaratat e mëparshme, Banka e Shqipërisë vlerëson se përparësi e politikës fiskale duhet të jenë veprimet që synojnë uljen e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik, uljen e rrezikut të rifinancimit përmes zgjatjes së afatit mesatar të maturimit të borxhit dhe zgjerimit të bazës së investitorëve institucionalë dhe të individëve, sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin ose shlyerjen e detyrimeve

në valutë. Disa nga këta objektiva bëhen më të vështirë në kushtet e performancës së ekonomisë në tremujorin e parë të vitit, dobësisë së kërkesës së jashtme dhe uljes së pritjeve për rritjen ekonomike përgjatë vitit. Në afat të parashikueshëm, presionet inflacioniste mund të vijojnë të mbeten të dobëta duke i dhënë më shumë mundësi autoritetit monetar për ruajtjen e kushteve monetare akomoduese. Sidoqoftë, shkalla e përfitimit të operatorëve ekonomikë në treg prej mundësisë së kushteve më të favorshme monetare do të varej nga gjendja e tyre financiare, si edhe nga sasia e kreditimit nga sektori bankar e niveli përkatës i normës së interesit.

Rreziku i drejtpërdrejtë dhe ai i tërthortë i kreditit përfaqësojnë rreziqet kryesore për sektorin bankar. Ndonëse me ritme të ndryshme, cilësia e kredisë ka rënë për kredinë në lekë, për kredinë në valutë, për kredinë për sektorin e biznesit dhe për individët. Rënia e cilësisë së kredisë përfshin sektorët kryesorë të ekonomisë. Trajtimi i kredive me probleme në sektorin bankar, është i rëndësishëm për ritmin e dhënies së kredisë dhe kontributin e ardhshëm që mund të japë sektori bankar dhe sistemi financiar në zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë nxit bashkëpunimin mes autoriteteve publike dhe sektorit bankar në vend, për të ndërmarrë masa që do të ofronin një zgjidhje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të këtij problemi. Disa nga këto veprime, janë përmendur si pjesë e deklaratës së stabilitetit financiar që çel këtë raport.

Sektori bankar paraqitet relativisht i mbrojtur ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë prej lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit, por ndjeshmëria është rritur. Pozicioni i hapur në valutë i sektorit bankar është brenda niveleve historike. Ndërkohë, vlerat e aktiveve dhe të detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit janë të krahasueshme me njëra-tjetrën. Megjithatë, sektori bankar paraqitet i ndjeshëm ndaj ndikimit që japin mbi klientët e tij lëvizjet në kursin e këmbimit dhe në normën e interesit. Një nënçmim i ndjeshëm i kursit të këmbimit ose një rritje e tillë e normës së interesit, mund të dëmtojë aftësinë paguese të klientëve të sektorit bankar, veçanërisht të sektorit të biznesit. Kanali kryesor i transmetimit të këtij rreziku përfaqësohet nga kredia në valutë kur burimi kryesor i shlyerjes së saj është në monedhën vendase, dhe nga kredia me normë të ndryshueshme të interesit.

Rreziku i likuiditetit për sektorin bankar, vlerësohet gjithashtu në nivele të moderuara. Si edhe më parë, depozitat përbëjnë burimin kryesor të financimit për sektorin bankar dhe ato janë rritur me ritme të mira. Huamarrja nga jorezidentët mbetet në nivele të kontrolluara. Aktivet likuide të sektorit, në lekë dhe në valutat kryesore, janë mbi nivelet minimale të kërkuara nga kuadri rregullativ.

Treguesit e kapitalizimit të veprimtarisë janë aktualisht në nivele të mira por bankat duhet të vlerësojnë me kujdes nevojat e tyre për kapital shtesë në të ardhmen. Gjatë periudhës, kontributin kryesor në këtë ecuri, e ka dhënë ngadalësimi i rritjes së aktiveve të ponderuara me koeficientët e

rrezikut, si edhe rritja e moderuar e kapitalit. Pavarësisht arritjes së një rezultati financiar pozitiv, aftësia e sektorit bankar për të prodhuar të ardhura të mjaftueshme për të mbështetur rritjen e kapitalit dhe zhvillimin e veprimtarisë me burime të brendshme, është ende e paqëndrueshme. Nga ana tjetër, mbulimi me kapital i kredisë me probleme neto është ulur. Për këto arsye, vlerësimi i kujdesshëm dhe proaktiv i nevojave për kapital shtesë në përputhje me profilin e rrezikut të veprimtarisë, përfaqëson një domosdoshmëri për bankat.

Ushtrimi i provës së rezistencës mund t'iu shërbejë bankave si mjet për të mbështetur vlerësimin e nevojave të mundshme për kapital shtesë. Banka e Shqipërisë realizon rregullisht ushtrimet e provës së rezistencës, për të vlerësuar ndjeshmërinë e treguesve kryesorë të kapitalizimit të sektorit bankar ndaj lëvizjeve në treguesit makroekonomikë. Skenarët, bazë dhe të rrezikut, përfshijnë supozime lidhur me lëvizjet në normën e rritjes së PBB-së, në nivelin e kursit të këmbimit dhe të normës së interesit, si edhe në nivelin e kreditimit, dhe shtrihen për një periudhë dyvjeçare, deri në fund të vitit 2013. Rezultatet e ushtrimit tregojnë që në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm në rast të realizimit të supozimeve për treguesit përkatës. Niveli i kapitalizimit për të gjithë sektorin mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar në rastin e skenarit bazë. Në rastin e skenarëve më të rënduar që përfshijnë supozimet përkatëse për uljen e normës së rritjes së PBB-së, uljen e nivelit të kreditimit dhe nënçmimin e kursit të këmbimit, banka të veçanta mund të kenë nevojë për kapital shtesë.

Infrastruktura teknike që mbështet veprimtarinë e sektorit bankar, vlerësohet të ketë funksionuar sipas parametrave të pritshëm. Sistemet e pagesave janë një pjesë e rëndësishme në strukturën e një sistemi financiar, duke qenë kanalet nëpërmjet të cilave mundësohet transferimi i fondeve ndërmjet bankave, institucioneve të tjera financiare dhe klientëve. Si rrjedhojë, operimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe eficiente kontribuon në mënyrë të rëndësishme në ruajtjen e stabilitetit financiar. Në këtë kuadër, vlerësohet që sistemet AIPS dhe AECH, infrastruktura bazë e pagesave në lekë, kanë operuar në përputhje me kërkesat që përcakton kuadri i tyre rregullativ dhe operacional. Banka e Shqipërisë mbetet e angazhuar të kryejë të gjitha përmirësimet e nevojshme në kuadrin rregullativ dhe infrastrukturën teknologjike mbështetëse, që ecuria e këtyre sistemeve t'i paraprijë nevojave të operatorëve për një veprimtari pagesash të sigurt dhe eficiente.

I. ZHVILLIMET NDËRKOMBËTARE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, ritmet e rritjes së ekonomisë botërore ishin të paqëndrueshme. Ato reflektuan kryesisht ecurinë e dobët ekonomike të Eurozonës dhe dobësitë strukturore, kryesisht në tregjet e punës dhe të pasurive të paluajtshme. Kontributi i vendeve të zhvilluara në rritjen ekonomike botërore vijoi të ishte ndjeshëm më i ulët se ai i vendeve në zhvillim. Pritjet më të ulëta për rritjen e ekonomisë botërore si edhe tensionet në tregjet financiare, veçanërisht në Eurozonë, kanë nxitur autoritetet evropiane të ndërmarrin disa veprime që synojnë të lehtësojnë koston e rifinancimit të borxhit për vendet anëtare periferike, të stabilizojnë sektorin bankar dhe të forcojnë mekanizmat evropianë për kapitalizimin e tij. Suksesi i këtyre masave është i dëshiruar jo vetëm për vendet e Eurozonës, por edhe për vendet e tjera që rrethojnë Bashkimin Evropian dhe që ndikohen negativisht prej gjendjes së tij përmes kanaleve të tregtisë, të lëvizjeve të kapitalit njerëzor dhe financiar, si edhe të integrimit të sistemit financiar.

Pas një periudhe të pafavorshme në gjysmën e dytë të vitit 2011, ekonomia botërore shfaqi shenja stabilizimi në fillim të vitit 2012, duke shënuar një rritje vjetore prej 3.6%[2] në tremujorin e parë. Tregtia dhe prodhimi industrial u rigjallëruan duke favorizuar ekonomitë eksportuese si ato të Azisë apo të Gjermanisë. Këto zhvillime ishin kryesisht rezultat i lehtësimit të tensioneve në tregjet financiare pas një sërë veprimesh politike dhe ekonomike në Eurozonë, ku veçohen: operacionet e rifinancimit afatgjatë të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) për bankat evropiane dhe hartimi i programeve fiskale afatmesme nga qeveritë e Eurozonës, veçanërisht në Itali dhe Spanjë, për konsolidimin fiskal dhe për mbështetjen e reformave ambicioze që liberalizojnë tregun e punës dhe përmirësojnë konkurrueshmërinë e ekonomisë. Megjithatë, këto zhvillime pozitive rezultuan afatshkurtra pasi në periudhën maj-qershor 2012, vendet periferike të Eurozonës u vendosën sërish në qendër të tensioneve në tregjet financiare. Shqetësimet lidhur me mungesën e stabilitetit politik e financiar në Greqi pas zgjedhjeve politike në maj, problemet e sektorit bankar në Spanjë dhe rritja e dyshimeve mbi zbatimin e plotë dhe rezultatin e reformave fiskale nga qeveritë e Eurozonës pas zgjedhjeve presidenciale në Francë, nxitën një valë të re mosbesimi në tregjet financiare. Perceptimi më i lartë për rreziqet e ndryshme u shfaq me lëvizje të kapitalit drejt produkteve më të sigurta dhe likuide në ekonomitë më të qëndrueshme, rritje të normave të interesit të borxhit të qeverive në vendet periferike të Eurozonës dhe shtrëngim të kushteve të rifinancimit për sektorin bankar në Eurozonë.

[2] *Parashikim i FMN-së, Korrik 2012.*

Në këtë mënyrë, efekti stabilizues i masave të lartpërmendura u zbeh shpejt dhe treguesit e sektorit real të ekonomisë në tremujorin e dytë të vitit reflektuan efektin frenues të tensioneve në Eurozonë. Ecuria më e dobët ekonomike në tremujorin e dytë të vitit, ka ndikuar edhe pritjet për rritjen e ekonomisë botërore për vitin 2012. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), rritja e ekonomisë botërore parashikohet të jetë e moderuar gjatë vitit 2012 në nivelin 3.5% dhe të gjallërohet disi gjatë vitit të ardhshëm në nivelin 3.9%, çka përbën gjithsesi një parashikim të përkeqësuar krahasuar me parashikimin e prillit 2012. Në vendet e zhvilluara, ngadalësimi ekonomik shfaqet më i ndjeshëm dhe ky grup vendesh pritet të rritet me një normë 1.4% në vitin 2012 (1.6% në vitin 2011) dhe 1.95% në vitin 2013. Kjo pritshmëri reflekton tkurrjen e ekonomisë së Eurozonës dhe dobësitë strukturore kryesisht në tregjet e punës dhe të pasurive të paluajtshme. Në vendet në zhvillim, aktiviteti ekonomik ka vazhduar të zgjerohet me ritme të larta gjatë vitit 2012, duke siguruar kontributin kryesor në rritjen e ekonomisë botërore. Gjithsesi, ritmi i rritjes ekonomike pritet të ulet në nivelin 5.6% gjatë vitit 2012 (nga 6.2% në vitin 2011) si pasojë e reflektimit të politikave konsoliduese fiskale dhe dobësimit të kërkesës nga vendet e zhvilluara, dhe të përmirësohet në 5.9% në vitin 2013. Ndërkohë, presionet inflacioniste kanë ardhur duke u zbehur si rezultat i dobësimit të kërkesës globale dhe stabilizimit të çmimit të naftës dhe të lëndëve të para. Në shkallë botërore, inflacioni pritet të bjerë në nivelin 3-3.5% në fund të vitit 2012, krahasuar me 4.5% në fund të vitit 2011.

Optimizmi që karakterizoi aktivitetin ekonomik të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) në fund të vitit 2011 me një rritje vjetore 4.1% në tremujorin e fundit, u zbeh në dy tremujorët e parë të vitit 2012 kryesisht për shkak të rënies së konsumit në sektorin privat e atë shtetëror dhe kontributit negativ të tregtisë neto. Besimi i biznesit shënoi rënie në tremujorin e dytë në kushtet e përkeqësimit të mjedisit makroekonomik global, veçanërisht në rajonin e Eurozonës. Gjithsesi, efektet negative nga Eurozona u kompensuan pjesërisht si pasojë e lëvizjes së kapitalit nga tregjet evropiane drejt atyre amerikane të konsideruara më të sigurta e likuide. Kushtet në tregun e punës dhanë shenja përmirësimi, veçanërisht në tremujorin e parë të vitit dhe norma e papunësisë është stabilizuar rreth nivelit 8.2%. Aktiviteti në tregun e pasurive të paluajtshme, pavarësisht disa sinjaleve pozitive, vazhdon të mbetet një dobësi strukturore që frenon rritjen ekonomike. Presionet inflacioniste kanë qenë të dobëta (Tabela 1.1). Në këto kushte, Rezerva Federale ka mbajtur të pandryshuar normën e interesit për huadhënien e fondeve në nivelin 0-0.25%, dhe ka deklaruar publikisht prirjen për të ruajtur këtë nivel të normës së interesit deri në fund të vitit 2014.

Në Eurozonë, aktiviteti ekonomik u ngadalësua ndjeshëm gjatë pjesës së parë të vitit 2012, ndonëse pati ritme të ndryshme midis vendeve anëtare. Pas një situate ekonomike relativisht të stabilizuar në fillim të vitit, pritshmëritë për ecurinë ekonomike të rajonit u goditën nga rritja e tensioneve lidhur me qëndrueshmërinë financiare të disa vendeve.

Eurozona hyri sërish në recesion ekonomik në tremujorin e dytë të vitit 2012[3]. Rënia ekonomike u theksua më tej në vendet më të prekura nga kriza e borxhit si Greqia, Italia, Spanja e Portugalia. Nga ana tjetër, vendet më të zhvilluara si Gjermania, Finlanda, Franca dhe Austria ruajtën një rritje pozitive modeste gjatë të dy tremujorëve (Tabela 1.1). Ecuria e dobët ekonomike shpjegohet kryesisht me dobësimin e kërkesës së brendshme nga kombinimi i një sërë faktorësh, si efekti negativ i krizës së borxhit tek besimi i bizneseve dhe i konsumatorëve, dhe kushtet e pafavorshme të kredidhënies e shtrëngimi fiskal në disa nga vendet anëtare. Për Eurozonën, FMN parashikon një recesion ekonomik në masën 0.3% për vitin 2012 dhe një rritje të lehtë ekonomike prej 0.7% për vitin 2013[4]. Në kushtet e dobësimit të aktivitetit ekonomik dhe uljes së luhatshmërisë së çmimeve të lëndëve të para dhe ushqimore, inflacioni ka ardhur në rënie në gjysmën e parë të vitit 2012 dhe pritet të luhatet nën nivelin 2% në vitin 2013. Progresi i konsolidimit fiskal në Eurozonë ishte i konsiderueshëm gjatë vitit 2011 dhe ka vazhduar intensivisht në gjysmën e parë të vitit 2012. Gjithsesi, deficitet buxhetore në shumicën e vendeve mbeten mbi nivelin referencë prej 3%. Në tregun e punës, kushtet kanë vazhduar të përkeqësohen dhe norma e papunësisë është rritur duke arritur nivelin 11.2% në qershor 2012. Ekspertët evropianë presin që papunësia në Eurozonë të arrijë pikun prej 11.4% gjatë vitit të ardhshëm dhe të bjerë në nivelin 10.8% në vitin 2014.

Tabelë 1.1. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për SHBA-në dhe Eurozonën.

	Ndryshimi i PBB-së (% vjetore)				Inflacioni (% vjetore)			Papunësia (% vjetore)			Borxhi sovran (% ndaj PBB-së)	
	2011	2012*	T1'12	T2'12	2011	Maj'12	Korr.'12	2011	Maj'12	Korr.'12	2011	T1'12
SHBA	1.8	2.0	2.4	2.3	3.2	1.7	1.4	9	8.2	8.3	102.9*	:
Eurozonë	1.4	-0.3	0.0	-0.5	2.7	2.4	2.4	10.2	11.2	11.3	87.3	89.3
Gjermani	3.0	1.0	1.2	1.0	2.5	2.2	1.9	6	5.5	5.5	81.2	80.9
Francë	1.7	0.3	0.3	0.3	2.3	2.3	2.2	9.6	10.1	10.3	85.8	89.2
Itali	0.4	-1.9	-1.4	-2.5	2.9	3.5	3.6	8.4	10.5	10.7	120.1	123.3
Greqi	-6.9	:	-6.5	-6.2	3.1	0.9	0.9	17.7	23.1	:	165.3	132.3
Spanjë	0.7	-1.5	-0.6	-1.3	3.1	1.9	2.2	21.7	24.8	25.1	68.5	72.1

Burimi: Byroja e Analizave Ekonomike - SHBA, Eurostat, BQE: Buletine Mujore (Qershor 2012, Shtator 2012).
** Parashikim i FMN-së.*
: Nuk ka të dhëna.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve negative, autoritetet evropiane kanë ndërmarrë disa nisma që synojnë stabilizimin e kushteve në tregjet financiare dhe nxitjen e rritjes ekonomike. Takimi evropian i 28-29 qershorit 2012, përfaqëson një moment kulmor për identifikimin e këtyre nismave, ku vendimet përfshijnë ngritjen e një mekanizmi të vetëm mbikëqyrës dhe autorizimin e Mekanizmit të Stabilitetit Evropian për rikapitalizimin e drejtpërdrejtë të bankave evropiane (Hapësirë informuese 1).

[3] *Sipas vlerësimeve më të fundit të Eurostat-it.*
[4] *Parashikim i korrikut 2012.*

Hapësirë informuese 1. Vendimet politike të Samitit Evropian të 28-29 qershorit 2012.

Në 28 - 29 qershor 2012, krerët e vendeve të Eurozonës u takuan për të diskutuar masa të mëtejshme lidhur me krizën në Eurozonë dhe sigurimin e stabilitetit në rajon. Takimi u pasua nga dy mbledhje të tjera të Eurogrupit në 9 dhe 20 korrik, për të diskutuar detajet e zbatimit të tyre. Vendimet kryesore të dala nga këto mbledhje ishin:

- *Ngritja e një mekanizmi të vetëm mbikëqyrës të drejtuar nga Banka Qendrore Evropiane e më pas autorizimi i Mekanizmit të Stabilitetit Evropian (ESM) për të rikapitalizuar direkt bankat. Kjo synon të thyejë rrethin vicioz të krijuar mes ekspozimit të bankave evropiane në borxhin sovran dhe qëndrueshmërinë e këtij të fundit, çka ka luajtur një rol mjaft negativ në zgjatjen e krizës së borxhit. Rikapitalizimi i drejtpërdrejtë i bankave përmes ESM-së nuk do të rrisë barrën e borxhit shtetëror, duke ulur në këtë mënyrë presionet mbi këto tregje.*

- *Aprovimi i ndihmës financiare për rikapitalizimin e bankave në Spanjë (në mbledhjen e Eurogrupit të datës 20 korrik), në formën e një huaje deri në 100 miliardë euro. Kjo do të sigurohet fillimisht nga Fondi i Stabilitetit Financiar Evropian (EFSF) sipas rregullave ekzistuese, derisa ESM të fillojë funksionimin (pas korrikut 2012). Më pas, fondet do të transferohen pranë ESM-së pa marrë statusin e fondeve shtetërore.*

- *Rritje e fleksibilitetit në përdorimin e instrumenteve ekzistuese të EFSF/ESM me qëllim stabilizimin e tregjeve të borxhit sovran nga ato vende të Eurozonës që kanë arritur të respektojnë në kohë rekomandimet dhe angazhimet e caktuara nga autoritetet evropiane.*

Zbatimi në kohë i këtyre masave mund të mos jetë i lehtë pasi disa prej tyre kërkojnë unanimitet të të gjithë anëtarëve të eurogrupit, ndërkohë që shumë detaje teknike mbeten ende të paqarta. Gjithsesi, Samiti i qershorit, duke vënë në lëvizje procesin drejt një mbikëqyrjeje të unifikuar, hodhi hapin e parë drejt një bashkimi bankar në Eurozonë dhe përbën një iniciativë të rëndësishme për rindërtimin e besimit të tregjeve.

Në vijim, BQE uli normën bazë të interesit në korrik 2012 duke zbritur në nivelin 0.75% dhe vazhdoi të sigurojë likuiditet të bollshëm për bankat, për të adresuar nevojat e tyre për rifinancim të detyrimeve dhe vijimin e kreditimit.

Thellimi i problemeve në Eurozonë ka vazhduar të dëmtojë aktivitetin ekonomik të vendeve në zhvillim të Evropës. Rritja ekonomike në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore është dobësuar veçanërisht gjatë tremujorit të dytë 2012. Vendet me performancë më të dobët kanë qenë Republika Çeke dhe Hungaria, recesioni ekonomik i të cilave është thelluar për shkak të rënies së kërkesës së jashtme dhe masave për shtrëngime fiskale. Polonia dhe vendet e rajonit të Baltikut kanë kryesuar rritjen ekonomike në këtë rajon, por me shenja të dukshme ngadalësimi gjatë vitit 2012. Përsa i përket vendeve të Evropës Juglindore (rajoni i Ballkanit), të dhënat për tremujorin e parë 2012 tregojnë rënie të aktivitetit ekonomik, veçanërisht në Kroaci, në Ish - Republikën

Jugosllave të Maqedonisë dhe në Serbi, duke thelluar një prirje të nisur që në tremujorin e fundit 2011. Edhe treguesit ekonomikë për Bosnje dhe Hercegovinën, dhe Malin e Zi sinjalizojnë një performancë të dobët ekonomike gjatë këtij viti. Përkeqësimi ekonomik i vendeve të këtij rajoni erdhi kryesisht si rezultat i rënies së eksporteve, të ndikuara negativisht nga përkeqësimi i kushteve të mjedisit të jashtëm. Në të kundërt, Turqia vazhdon të regjistrojë norma të larta të rritjes ekonomike duke kryesuar në vlerat e ritmit të rritjes ekonomike për vendet në zhvillim të Evropës.

Tabelë 1.2. Disa tregues kryesorë makroekonomikë për Evropën Lindore Qendrore e Juglindore.

Evropa Lindore Qendrore	Rritja e PBB-së (% vjetore)			Inflacioni (% vjetore)			Papunësia (% vjetore)			Borxhi sovran (% PBB-së)	
	2011	T1' 12	T2'12	Dhj.'11	Maj '12	Korr'12	2011	Maj '12	Korr '12	2011	T1'12
Hungari	1.6	-1.2	-1	4.1	5.4	5.7	11.0	11.0	10.8	80.6	79.0
Poloni	4.3	3.5	2.5	4.5	3.6	4.0	9.7	10.0	10.0	56.3	56.1
Rumani	2.5	1.2	1.7	3.2	2.0	3.1	7.4	7.1	7.0	33.3	34.3
Serbi	1.6	-1.3	-0.6	7*	2.7	5.5	23.0	25.5**	:	47.7	50.7
Kosovë	4.9***	:	:	4.1*	1.1	:	:	:	:	:	:
Bosnje&Hercegovinë	1.6	:	:	4.0	2.3	:	43.8	43.8**	44.1**	25.7	26.1
IRJ Maqedonisë	3.1	-1.4	:	2.8	1.4	2.1	31.4	31.5**	:	28.2	:
Mal i Zi	2.5	:	:	1.0	-1.5	1.8	13.2	:	:	45.3	45.1
Turqi	8.5	3.2	:	9.2*	8.28	9.07	9.8	10.4**	:	38.4f	:

Burimi: Eurostat, Komisioni Evropian, bankat qendrore përkatëse, institucionet statistikore përkatëse.
f - Parashikim i ECFIN, vjeshtë 2011.
** Të dhënat për T4 2011.*
*** Të dhënat e papunësisë janë për T1 2012 , T2 2012.*
**** Parashikim i ECFIN, FMN.*
: Nuk ka të dhëna.

Zhvillimet negative në Eurozonë dhe në rajon pritet të vazhdojnë të ndikojnë negativisht mbi ekonominë e vendit tonë. Dobësimi i aktivitetit ekonomik në Evropë do të ndikojë negativisht në kërkesën për eksporte shqiptare, ndërkohë që rënia e presioneve inflacioniste mund të ndikojë në uljen e çmimeve të importit. Nga ana tjetër, nivelet ende të larta të papunësisë në Eurozonë dhe veçanërisht në Itali dhe Greqi, kombinuar dhe me zbatimin e mëtejshëm të masave shtrënguese fiskale, do të vazhdojnë të rëndojnë situatën financiare të emigrantëve shqiptarë në këto vende dhe të ndikojnë negativisht dërgesat e tyre në atdhe përgjatë kohës.

1.1 ZHVILLIMET KRYESORE NË TREGJET FINANCIARE

Tregjet financiare përjetuan një moment qetësimi në fillim të vitit por pas rezultatit të zgjedhjeve politike të majit në Greqi dhe rritjes së dyshimeve mbi shëndetin e sistemit bankar në Spanjë, besimi i tregjeve u lëkund përsëri dhe lëvizja e kapitalit drejt tregjeve më të sigurta dhe likuide, u intensifikua.

Sidoqoftë, në tregjet evropiane të parasë normat e interesit ishin të stabilizuara dhe me një prirje rënëse gjatë gjithë gjashtëmujorit të parë, si rezultat i likuiditetit të bollshëm të siguruar nga BQE përmes operacioneve të rifinancimit dhe lehtësimit të mëtejshëm të politikës monetare me uljen e normës bazë deri në 0.75% në korrik 2012. Në tregjet e borxhit sovran, ndryshimet e normave të kthimit kanë qenë të skajshme, duke reflektuar lëvizjet e kapitalit drejt vendeve me ecurinë më të mirë ekonomike dhe fiskale. Nga njëra anë patëm rënien e ndjeshme të normave të kthimit për borxhin sovran të SHBA-së, Zvicrës, Gjermanisë (për këtë fundit, norma e kthimit për borxhin 2-vjeçar zbriti poshtë 0), ndërsa nga ana tjetër patëm rritje të luhatshmërisë dhe përgjithësisht një prirje rritëse të normave të kthimit për borxhin sovran të Italisë dhe Spanjës. Përkohësisht, normat e kthimit për borxhin 10-vjeçar të Italisë dhe të Spanjës, u ngjitën mbi nivelin 7%, gjerësisht të konsideruar si kufiri maksimal që përcakton qëndrueshmërinë e tij.

Grafik 1.1. Ecuria e normave të interesit në tregjet kryesore të parasë dhe të obligacioneve shtetërore.



Burimi: Banka Qendrore Evropiane, Eurostat.

Aktiviteti në tregjet e kapitalit përjetoi një periudhë përmirësimi në tremujorin e parë të vitit, kur çmimet e aksioneve u rritën në tregjet amerikane dhe ato evropiane, dhe kushtet e tregtimit u përmirësuan edhe në tregjet e obligacioneve të korporatave. Por rritja e pasigurisë lidhur me krizën evropiane në periudhën mars–qershor shkaktoi një tkurrje të re të aktivitetit në tregjet e kapitalit, veçanërisht në segmentin e institucioneve financiare. Së fundmi, iniciativat politike për të forcuar stabilitetin financiar në Eurozonë dhe zgjatja e politikës monetare akomoduese në ShBA, kanë ndikuar pozitivisht në stabilizimin e kushteve në këto tregje. Në tregjet e monedhave, euro ka patur një prirje nënçmuese kundrejt monedhave kryesore që pas fundit të shkurtit 2012 e në vazhdim, duke reflektuar pasigurinë e investitorëve lidhur me zhvillimet fiskale e ekonomike të Eurozonës. Nga ana tjetër, lëvizja e fondeve drejt tregjeve të sigurta, një pjesë e të cilave brenda Eurozonës (si obligacionet shtetërore të Gjermanisë, Austrisë), kanë ndihmuar në ruajtjen e vlerës së euros.

Në tregjet e lëndëve të para, çmimet e naftës u rritën me shpejtësi në fillim të vitit 2012, duke reflektuar rritjen e tensioneve gjeopolitike në rajonin e Lindjes së Mesme dhe optimizmin mbi ecurinë e ekonomisë botërore pas daljes së të dhënave pozitive të ekonomisë amerikane dhe asaj kineze. Kjo rritje kulmoi në muajin mars, kur çmimi i naftës arriti në 122.7 dollarë/fuçi. E njëjta prirje rritëse u shfaq edhe në çmimet e lëndëve të tjera të para gjatë kësaj periudhe. Në tremujorin e dytë të vitit, dobësimi i aktivitetit ekonomik në vendet e zhvilluara dhe në Kinë, si edhe ruajtja e niveleve të prodhimit të naftës, rikthyen prirjen rënëse të çmimit të naftës. Si rezultat, çmimi i një fuçie naftë zbriti në 90 dollarë në 26 qershor 2012, rreth 28% më i ulët krahasuar me nivelin e shënuar në fund të tremujorit të parë 2012.

Grupet e Mëdha Komplekse Bankare Globale (GMKBG) zhvilluan veprimtarinë në një mjedis sfidues, veçanërisht për bankat me ekspozim të lartë ndaj pasurive të paluajtshme. Grupet bankare amerikane u ndikuan negativisht nga zhvillimet në Eurozonë, ndërsa fitimet e grupeve bankare angleze u goditën nga rënia e çmimeve të pasurive të paluajtshme. Të ardhurat nga aktiviteti i tregtimit shënuan përmirësim pas rënies së theksuar në fund të vitit 2011, ndërsa të ardhurat nga interesat ishin përgjithësisht të qëndrueshme. Treguesit e kapitalit për GMKBG mbetën përgjithësisht të pandryshuar gjatë fundit të vitit 2011 dhe tremujorit të parë 2012. Pas vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit nga autoritetet, niveli i saj rezultoi pozitiv për bankat amerikane, ndërkohë që bankave angleze iu kërkua shtim kapitali. Çmimet e aksioneve të këtyre grupeve bankare, veçanërisht të atyre amerikane, regjistruan rritje në fillim të vitit 2012, por kjo rritje rezultoi e përkohshme për shkak të pasigurisë së tregjeve në tremujorin e dytë të vitit.

Performanca financiare e Grupeve të Mëdha e Komplekse Bankare të Eurozonës (GMKBE) u dobësua pas marsit 2012 duke reflektuar rritjen e rrezikut të kreditit dhe përkeqësimin e kushteve në tregun e pasurive të paluajtshme në disa prej vendeve. Nga ana tjetër, shumica e bankave të mëdha të Eurozonës përmirësuan normat e tyre të kapitalit gjatë tremujorit të parë 2012, si pjesë e zbatimit të rekomandimeve të Autoritetit Bankar Evropian (EBA) për të rritur kapitalin pas ushtrimit të provës së rezistencës së zhvilluar në nëntor 2011. Më tej, shumë banka të mëdha evropiane kanë njoftuar planet e tyre të ristrukturimit, që përfshijnë zvogëlim të aktivit gjatë periudhës afatmesme dhe mbështetjen në burime të qëndrueshme financimi. Kjo periudhë ndryshimesh strukturore të nevojshme për sektorin bankar, është mbështetur me likuiditet të bollshëm nga Eurosistemi.

Hapësirë informuese 1.2. Zhvillimet për grupet bankare që operojnë në Shqipëri.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten në mënyrë të përmbledhur treguesit kryesorë të pasqyrave financiare të grupeve bankare që operojnë në Shqipëri. Në krahasim me fundin e vitit të kaluar apo me të njëjtën periudhë të një viti më parë, këta tregues paraqesin një pirje rënëse të nivelit të fitimit, kryesisht prej rënies së të ardhurave, pavarësisht pakësimit të shpenzimeve të veprimtarisë. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit paraqitet në nivele të kënaqshme për këto grupe, pa shfaqur nevojën për shtesë të kapitalit ekzistues, sipas përcaktimeve të detyrimeve ligjore. Totali i aktiveve të secilës bankë në vendin tonë ndaj totalit të aktiveve të grupit të tyre zotërues ka shfaqur ndryshime mjaft të lehta për të gjitha grupet bankare të shqyrtuara në krahasim me periudhat e mëparshme.

Tabelë 1.3. Të dhëna financiare mbi grupet e huaja bankare të pranishme në Shqipëri (miliardë euro).

	Raiffesen Bank International[I]	Intesa San Paolo[II]	Alpha Bank*[III]	Piraeus Bank*[IV]	National Bank of Greece*[V]	Societe Generale[VI]	Credit Agricole[VII]
Totali i aktiveve	152.7	666.4	57.6	46.4	104.1	1,246.7	1,956.7
Ndryshimi 6-mujor	3.9%	4.3%			-12%	6%	4.1%
Vëllimi i kredive të klientëve	84.9	374.9	43.7	34.1	70.7	360.5	805.6
Ndryshimi 6-mujor	4.1%	-0.5%			-5%	-2%	0.8%
Vëllimi i depozitave të klientëve	72	365.6	27.9	20.7	57.4	348.5	678.1
Ndryshimi 6-mujor	7.9%	2.3%			-15%	2%	1.7%
Norma e kredive me probleme	9.8%	7%	14.9%				
Provigjone	0.4	2.1	3.1	0.3	0.8		
Fitimi neto	0.73	1.3	-0.1	0.3	-0.5	-1.2	1.7
Ndryshimi vjetor	8.3%	-9.1%				-29.9%	-33.2%
Të ardhurat operative	2.6	8.9	0.5	0.4	0.8	2.5	3.4
Ndryshimi vjetor	-4.9%	2.6%	-15.5%			4%	-28%
Të ardhurat neto nga interesi, ndryshim vjetor	-3.6%	3.6%	-5%				
Të ardhurat neto nga komisionet, ndryshim vjetor	-2.2%	-5.9%	-7.7%				
Shpenzimet operative, ndryshim vjetor	0.2%	-1.9%	-3.3%		-7%	-3.5%	0%
Kosto të stafit, ndryshim vjetor	1.5%	-1.4%	-1.9%				
Rezultati neto operativ, ndryshim vjetor	-11.2%	7.4%					-8.2%
Marzhi neto nga interesat	2.3%		2.8%		4%		
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit	10.6%	11.7%	9.6%	9%	8.1%	11.6%	12.7%
Totali i aktiveve të bankës në Shqipëri ndaj totalit të grupit	1.52%	0.14%	0.82%	1.38%	0.26%	0.03%	0.01%

**Të dhënat për tremujorin e parë të vitit 2012.*

I *Raporti financiar gjashtëmujor, qershor 2012, URL: http://investor.rbinternational.com/fileadmin/ir/2012_Q2/2012-08-29_Q2_Report_RBI.pdf*

II *Raporti financiar gjashtëmujor, qershor 2012, URL: http://www.group.intesasanpaolo.com/scriptlsir0/si09/contentData/view/20120824_Relazione_Semestrale_06_12_uk.pdf?id=CNT-04-00000000BCF2B&ct=application/pdf*

III *Rezultatet financiare për tremujorin e parë 2012, njoftim për shtyp, URL: http://www.alpha.gr/files/deltia_typou/Deltio_Typou_20120531EN.pdf*

IV *Pasqyrat financiare për tremujorin e parë 2012, URL: http://www.piraeusbank.gr/Documents/internet/ConsolidatedCo2012/3M_1st_ENG.pdf*

V *Rezultatet financiare për tremujorin e parë 2012, URL: http://www.nbg.gr/wps/wcm/connect/2c09bb804b6f4efca8e6ae277c464667/20120530+NBG+%26+Group+Q1+2012+Results+EN.pdf?MOD=AJPERES&CACHEID=2c09bb804b6f4efca8e6ae277c464667*

VI *Informacioni financiar për gjashtëmujorin e parë 2012, njoftim për shtyp, URL: http://www.societegenerale.com/sites/default/files/documents/CP_Q212-.pdf*

VII *Rezultatet financiare për gjashtëmujorin e parë 2012, URL: http://www.credit-agricole.com/en/Finance-and-Shareholders/Financial-reporting/Credit-Agricole-S.A.-financial-results*

2. ZHVILLIMET MAKROEKONOMIKE NË SHQIPËRI GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012

2.1 SEKTORI I EKONOMISË REALE

Në tremujorin e parë të vitit 2012, ekonomia shqiptare u tkurr me 0.2% në terma vjetorë dhe 1.2% në terma tremujorë. Industria dhe ndërtimi kanë reflektuar një thellim të ndjeshëm të tkurrjes së tyre vjetore gjatë tremujorit të parë 2012, përkatësisht me 19.3% dhe 17.6%, ndërkohë që si postë-komunikacioni ashtu edhe transporti shënojnë rënie. Sektorët e shërbimeve të tjera dhe tregtia vijojnë të kontribuojnë pozitivisht në rritjen ekonomike me përkatësisht 11.1% dhe 5.3% në terma vjetorë. Edhe bujqësia është rritur me 4.5% ndaj fillimit të vitit 2011 dhe me 1.6% ndaj fundvitit 2011.

Treguesit e tërthortë sugjerojnë se zhvillimet në terma të konsumit privat dhe investimeve private janë të ngadalta. Rritja e prirjes për kursim e shoqëruar nga një sjellje konsumatore e kujdesshme është reflektuar në një kontribut të kufizuar të konsumit në rritjen ekonomike. Pavarësisht mbështetjes së investimeve private me kredi, prania e kapaciteteve të lira të prodhimit, ulja e kërkesës agregate dhe zhvillimet e ngadalta në tregun e punës janë reflektuar në nivele të ulëta të investimeve private. Gjatë kësaj periudhe, politika fiskale është përcaktuar si konsoliduese duke ulur stimulin fiskal në ekonomi. Zhvillime të dobëta janë shfaqur dhe nga krahu i kërkesës së huaj, të cilat të shoqëruara nga ulja e prodhimit të energjisë elektrike, janë reflektuar në një ngadalësim të ndjeshëm të eksporteve shqiptare krahasuar me fillimin e vitit të kaluar.

Duke prezantuar më në detaje zhvillimet e mësipërme, vlerësohet se përkeqësimi i ndjeshëm i besimit konsumator[5] në gjashtëmujorin e parë 2012 reflekton pritshmëritë në rënie për situatën ekonomike të konsumatorëve dhe rritje të prirjes për kursim. Tremujori i parë i vitit 2012, shënoi dhe një tkurrje të ndjeshme të pagës mesatare në ekonomi me 12.4% në terma realë. E shoqëruar dhe me rënien e dërgesave të emigrantëve me 2.08% në terma vjetorë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, vlerësohet se të ardhurat e disponueshme janë në ngadalësim.

Konsumi është kufizuar dhe nga zhvillimet në tregun e punës. Në tremujorin e parë 2012, norma e papunësisë shënoi vlerën 13.32% krahasuar me 13.29% në fund të vitit 2011. Gjithsesi, norma e papunësisë ka shënuar rënie me 0.11 pikë përqindje ndaj një viti më parë. Zhvillimet e punësimit në sektorin privat jobujqësor mbeten pozitive me një zgjerim

[5] *Në tremujorin e dytë të vitit 2012, Treguesi i Besimit Konsumator (TBK) ra me 1.1 pikë përqindje në vijim të prirjes rënëse të nisur në fund të vitit 2011.*

prej 8.3% ndaj një viti më parë, por më të ngadalta se në fundin e vitit 2011, kur shënonte një zgjerim prej 9.9%. Nga ana tjetër, punësimi në sektorin shtetëror në fillim të vitit vijon të shënojë rënie me 0.5% në terma vjetorë. Pritshmëritë[6] për tregun e punës gjatë tremujorit të dytë të vitit 2012 vlerësohen në rënie për sektorët e industrisë dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektori i shërbimeve ka pritshmëri pozitive por me një ritëm më të ulët rritjeje.

Ulja e stimulit fiskal në ekonomi gjatë gjashtëmujorit të parë 2012, është reflektuar në rritjen e të ardhurave me 4.1% në terma vjetorë, në nivelin 161.6 miliardë lekë, dhe rënien e shpenzimeve buxhetore me 0.3% në terma vjetorë, në nivelin 182.7 miliardë lekë. Rritja e të ardhurave ka reflektuar ecurinë e të ardhurave tatimore dhe jotatimore, ndërsa ulja e shpenzimeve është ndikuar kryesisht prej atyre kapitale. Si rezultat i këtyre zhvillimeve, në fund të periudhës buxheti rezultonte me një deficit prej 21.1 miliardë lekësh ose 3.1% të PBB-së[7]. Financimi i deficitit është bërë në masën 60.6% nga burime të brendshme dhe 39.4% nga burime të jashtme. Në fund të periudhës, stoku i borxhit publik ka arritur në 800.9 miliardë lekë. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, borxhi i brendshëm përbën 56.6% të totalit. Kohëzgjatja mesatare e borxhit ka qenë e luhatshme përgjatë gjashtëmujorit por ka qenë në rritje që prej muajit maj, duke arritur në 386 ditë deri në maturim në fund të periudhës.

Zhvillimet në tregtinë me jashtë gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, reflektojnë një ngushtim të deficitit të llogarisë korrente në nivelin 446 milionë euro, duke u tkurrur me 17.8% në terma vjetorë. Gjatë së njëjtës periudhë, deficiti tregtar vlerësohet në nivelin 904 milionë euro duke u zvogëluar me 10.8% në terma vjetorë. Ky zhvillim reflekton një zgjerim të ulët të eksporteve me 0.5% në terma vjetorë gjatë gjashtëmujorit të parë 2012, ndërkohë që importet janë ulur me 4.2% në terma vjetorë. Ndërkohë, në të njëjtën periudhë, llogaria kapitale dhe financiare shënon vlerën 425.7 milionë euro duke u ngushtuar me 3.8% në terma vjetorë. Investimet e huaja direkte janë rritur me 28.5% në terma vjetorë ndaj një viti më parë, ndërkohë që investimet e portofolit dhe investimet e tjera janë tkurrur.

Përsa i përket zhvillimeve në ecurinë e çmimeve në vend, inflacioni gjatë gjashtëmujorit të parë të 2012 ka qenë nën nivelin minimal të synuar nga Banka e Shqipërisë, ndonëse ka ardhur në rritje kryesisht për shkak të rritjes së çmimeve të ushqimeve të papërpunuara. Në tremujorin e dytë të vitit 2012, inflacioni mesatar vjetor shënoi vlerën 1.9%, rreth 0.8 pikë përqindje më shumë se në fillim të vitit.

Së fundi, zhvillimet negative në Eurozonë dhe në rajon pritet të vazhdojnë të ndikojnë negativisht mbi ekonominë e vendit tonë. Dobësimi i aktivitetit

[6] *Bazuar në Indeksin e Besimit të Bizneseve, në tremujorin e parë të 2012, Indeksi i Pritshmërive për Punësim shënon vlerën -2.8 për industrinë, -7.6 për ndërtimin dhe 2.1 për shërbimet.*

[7] *Raporti bazohet mbi vlerësimet për PBB-në e gjashtëmujorit të parë të 2012.*

ekonomik në Evropë do të vazhdojë të ndikojë negativisht tregtimin e eksporteve shqiptare, ndërkohë që rënia e presioneve inflacioniste mund të ndikojë në uljen e çmimeve të importit. Nga ana tjetër, nivelet ende të larta të papunësisë në Eurozonë dhe veçanërisht në Itali dhe Greqi, kombinuar dhe me zbatimin e mëtejshëm të shtrëngimeve fiskale, do të vazhdojnë të rëndojnë situatën financiare të emigrantëve shqiptarë në këto vende dhe të ushtrojnë presion për pakësimin e dërgesave të tyre në atdhe.

Hapësirë informuese 2. Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj Greqisë dhe Italisë.

Ekspozimi i ekonomisë shqiptare ndaj Greqisë dhe Italisë në terma të ekonomisë së jashtme vlerësohet i rëndësishëm. Kanalet kryesore përmes të cilave ekonomia jonë ndikohet nga zhvillimet në këto vende janë në terma të kërkesës për eksporte, të vlerës së dërgesave të emigrantëve (remitancave) e të investimeve të huaja direkte që vijnë prej tyre.*

Në grafikun 1.1 paraqitet ecuria e eksporteve dhe importeve nga Greqia dhe Italia duke i krahasuar me zhvillimet në totalin e tregtisë me jashtë. Pesha e eksporteve shqiptare në Greqi ka ardhur vazhdimisht në rënie dhe në qershor 2012 shënon vlerën 3.9% të totalit të eksporteve. Vlerat e ulëta të ekspozimit me Greqinë e bëjnë të përballueshëm ndikimin prej një krize edhe më të thelluar në Greqi. Në të njëjtën periudhë, eksportet me Italinë përfaqësonin 52.1% të totalit të eksporteve, duke e bërë të rëndësishëm ndikimin mbi ekonominë tonë të një ngadalësimi ose tkurrjeje të ekonomisë italiane.

Përsa i përket strukturës së eksporteve, në qershor 2012, 39.2% e eksporteve drejt Greqisë përbëhet nga materiale ndërtimi dhe metale, 23.8% nga tekstile dhe këpucë, dhe 19.4% nga ushqim, pije dhe duhan. Në rastin e Italisë, 50.7% përbëhet nga tekstile dhe këpucë, 25% nga minerale, lëndë djegëse, energji elektrike dhe 10.2% nga materiale ndërtimi dhe metale. Këto zhvillime tregojnë se ulja e eksporteve drejt Greqisë prek kryesisht sektorin e ndërtimit, ndërsa ulja e eksporteve ndaj Italisë prek sektorin e tekstileve dhe të mineraleve, lëndëve djegëse dhe energjisë

Grafik 2. Struktura e eksport importeve sipas vendeve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

elektrike. Gjithsesi, reagimi i bizneseve shqiptare përmes rritjes së përpjekjeve për diversifikim të vendeve me të cilat bëjnë tregti, ka zbutur disi efektet negative të krizës financiare.

Nga ana e importeve, varësia ndaj Greqisë është më e lartë, me 8.9% të totalit, tregues që ka ardhur gjithashtu në rënie. Përgjithësisht, diversifikimi i importeve është më i lehtë se i eksporteve, ndaj problemet e mundshme në sigurimin e importeve nga Greqia janë më të përballueshme.

Përsa i përket remitancave, ato do të ndikohen negativisht nga zhvillimet ekonomike në Greqi e Itali, duke patur ndikim në të ardhurat e disponueshme dhe konsumin e familjeve në vend. Ndikimi tek remitancat pritet të jetë më i dukshëm në një periudhë afatmesme.

Në lidhje me zhvillimet në Investimet e Huaja Direkte, pesha e kapitalit grek në totalin e stokut është e rëndësishme, por ka ardhur në rënie. Të dhënat më të fundit zyrtare i referohen vitit 2010, ku pesha e investimeve të huaja direkte nga Greqia është zvogëluar në 27.42% të totalit nga niveli 42.48% që përbënte në vitin 2007. Ndërkohë, investimet e huaja direkte nga Italia përbëjnë një peshë në rritje me 15.18% në vitin 2010 nga niveli 11.72% në vitin 2007. Këto zhvillime reflektojnë ndikimin e ndjeshëm të krizës financiare që ka prekur këto vende në financimin e investimeve të tyre drejt vendeve të tjera. Gjithsesi, zgjerimi i totalit të Investimeve të Huaja Direkte (tabela 2.1) në kushtet kur pesha e Greqisë ka rënë vazhdimisht tregon mundësinë e vendit për thithjen e kapitalit edhe nga vende të tjera jo fqinje.

Tabelë 2.1. Ecuria e investimeve të huaja direkte sipas vendeve.

	Investimet e huaja direkte në mln euro		
Periudhat	Greqi	Itali	Totali i IHD-ve
2007	771.05	212.7	1,815.08
2008	694.22	317.57	2,039.85
2009	670.69	349.99	2,233.38
2010	723.97	400.62	2,639.85

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithsesi, një pjesë e investimeve të huaja direkte në formën e kapitalit nga Greqia, kanë qenë të rëndësishme për mbështetjen e veprimtarisë së bankave me kapital grek që veprojnë në vend.

* *Të dhëna të përditësuara për dërgesat e emigrantëve nga Greqia mungojnë. Gjithsesi, sipas publikimit nga A. Frashëri, "Informacion mbi rezultatet e vrojtimit pranë familjeve", Buletini Ekonomik, Banka e Shqipërisë, Shtator 2007, 37.7% e dërgesave të emigrantëve janë nga Greqia dhe 45.8% vijnë nga Italia.*

2.2 TREGU I BANESAVE

Gjatë periudhës, zhvillimet në tregun e banesave nuk shfaqin ndryshime të dukshme në krahasim me periudhat e kaluara, në kushtet kur indekset kryesore kanë lëvizur pranë prirjes së tyre afatgjatë. Në pjesën e parë të vitit 2012, indeksi i çmimit të banesave ka shënuar një rritje më të shpejtë se indeksi i çmimit të qirasë. Kredia për blerje pasurie të paluajtshme është tkurrur edhe në kushtet e një kërkese më të ulët nga individët, ndërkohë që cilësia e saj vijon të përkeqësohet. Fakti që indekset e banesave janë rritur në një kohë kur kredia për blerje pasurie të paluajtshme është

tkurrur, është një tregues i kompleksitetit të faktorëve që ndikojnë kërkesën për pasuri të paluajtshme, madhësinë e ndikimit të tyre në një periudhë kohe të caktuar dhe mund të jetë gjithashtu një tregues për nevojën e përmirësimit të metodologjisë së ndërtimit të indekseve.

2.2.1 ZHVILLIMET NË TREGUN E BANESAVE

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, indeksi i çmimit të banesave[8] ka shënuar një rritje mesatare prej 3.3% në terma vjetorë kundrejt një rritjeje prej 2.3% të indeksit të çmimit të qirasë. Në terma tremujorë, është shënuar një rënie e indeksit të qirasë me 6.3%, në një nivel më të ulët se ai i fundit të vitit 2011, ndërsa indeksi i çmimit të banesave është rritur me 3.6% duke qëndruar më lart se niveli i fundit të vitit 2011. Në fund të periudhës, raporti midis indeksit të çmimit të banesave dhe të qirasë arriti në 2.14 nga 1.96 që shënonte në fund të 2011-ës.

Grafik 2.1. Zhvillimet në tregun e banesave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tremujori i dytë i vitit 2012 shënoi tkurrje me 0.6% në terma vjetorë të tepricës së kredisë për blerje pasurie të paluajtshme pas një ritmi pozitiv zgjerimi me 6.3% në tremujorin e parë. Në të njëjtën linjë, kostoja relative e pagesës së kredisë për blerje pasurie të paluajtshme ka shënuar rënie gjatë tremujorit të dytë 2012 me 1.27 pikë përqindje ndaj një viti më parë, ndërkohë që fillimi i vitit kishte një rritje të kostos me 0.63 pikë përqindje. Ky zhvillim[9] reflekton kryesisht një rritje më të shpejtë të çmimit të banesave që në terma relativë e bën koston e pagesës për këtë kredi më të ulët. Norma e ponderuar e interesit për investim në pasuri të paluajtshme gjatë tremujorit të dytë 2012 ka një rënie shumë të lehtë, me vetëm 0.3 pikë përqindje në terma vjetorë.

[8] *Indekset e çmimeve të banesave ndërtohen vetëm për qytetin e Tiranës.*

[9] *Kostoja relative e pagesës për blerje pasurie të paluajtshme është matur si diferenca midis normës së interesit të kredisë për pasuri të paluajtshme dhe normës mesatare të rritjes së çmimit të banesave për katër tremujorët e kaluar. Në rast se norma e interesit rritet më shpejt se rritja e çmimit të banesave, atëherë kostoja relative vlerësohet në rritje dhe anasjelltas.*

Tkurrja e kredisë për pasuri të paluajtshme ka ardhur edhe në kushtet e një kërkese më të ulët të individëve për kredi për shtëpi, ndonëse në tremujorin e dytë të periudhës ka një përmirësim ndaj tremujorit të parë[10]. Ndërkohë, bankat raportojnë se kushtet e miratimit të kredisë në total për individët nuk kanë ndryshuar gjatë tremujorit të dytë dhe pritet të përmirësohen gjatë tremujorit të tretë.

Përsa i përket cilësisë së portofolit të kredisë për pasuri të paluajtshme, ajo vijon të përkeqësohet. Në qershor 2012, raporti i kredive me probleme për pasuri të paluajtshme shënoi vlerën 13.9% në krahasim me 12.55% në dhjetor 2011. Në krahasim me totalin e portofolit të kredisë, cilësia e portofolit për pasuri të paluajtshme mbetet më e mirë për shkak të lidhjes më të fortë që ekziston mes huamarrësit, objektit të kredisë dhe kolateralit të saj.

2.3 POZICIONI FINANCIAR DHE EKSPOZIMI NDAJ RREZIQEVE I INDIVIDËVE DHE BIZNESEVE

Gjendja financiare e individëve/familjeve dhe bizneseve, shfaqi të njëjtat prirje si në periudhën e mëparshme. Individët kanë vijuar prirjen e tyre për kursim, duke zgjeruar më tej pozicionin e tyre kreditor ndaj sistemit financiar për shkak të rritjes së depozitave më shpejt se kreditimi. Pozicioni i bizneseve vijon të mbetet thellësisht debitor, dhe në pjesën dërrmuese të tij është në valutë. Kreditimi i sektorit të biznesit gjatë pjesës së parë të vitit 2012 u rrit me ritme më të ulëta, ndërsa kreditimi i individëve u tkurr. Cilësia e kredisë për individët dhe bizneset ka rënë. Individët dhe bizneset, ndonëse në mënyra të ndryshme, mbeten të ekspozuar ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit që mund të vijë për shkak të lëvizjeve të pafavorshme në kursin e këmbimit ose në normën e interesit.

- *INDIVIDËT*

Në fund të gjashtëmujorit të parë 2012, pozicioni financiar kreditor[11] i individëve shënoi vlerën 653.3 miliardë lekë, rreth 93.98 miliardë lekë më shumë se në qershorin e vitit 2011 dhe 37.87 miliardë lekë më shumë se në dhjetor të vitit 2011. Në krahasim me një vit më parë, depozitat e individëve në sistemin financiar janë rritur me 87.7 miliardë lekë, ndërsa kredia është ngushtuar me 6.3 miliardë lekë. Sipas valutës, individët janë kreditorë në masën 355.3 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 298 miliardë lekë në monedhë të huaj. Pozicioni kreditor në lekë është zgjeruar me 35.1 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë kryesisht

[10] *Sipas Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e dytë të vitit 2012, kërkesa e individëve për blerje shtëpie ka shënuar vlerat negative -30.0 dhe -6.1 për tremujorin e parë dhe të dytë të vitit.*

[11] *Pozicioni financiar i individëve vlerësohet si diferenca midis depozitave të individëve dhe kredive të tyre në sistem. Në kushtet kur kjo diferencë është pozitive, atëherë individët janë kreditorë të sistemit.*

për shkak të zgjerimit më të shpejtë të kredisë në lekë krahasuar me rritjen e depozitave në lekë. Për të njëjtën periudhë, pozicioni kreditor në valutë është zgjeruar me 64 miliardë lekë, kryesisht nga rritja e depozitave në valutë.

Grafik 2.2. Pozicioni financiar i individëve ndaj sistemit*.



*Në grafikun majtas paraqitet ecuria e depozitave të individëve, kredisë së individëve dhe pozicionit kreditor që matet si diferencë midis depozitave dhe kredisë. Në grafikun djathtas, pozicioni financiar i individëve është paraqitur për lekun dhe valutën.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.1 RREZIKU I KREDISË

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, teprica e kredisë për individë[12] është tkurrur në mënyrë të vazhdueshme, duke rënë me 3.72% në terma vjetorë. Një vit më parë, kjo tepricë ishte zgjeruar me 5.57%, ndërkohë që shenjat e ngadalësimit u shënuan në dhjetor 2011 me një zgjerim vetëm 0.5% në terma vjetorë. Gjatë kësaj periudhe, kredia afatmesme ka shënuar edhe normën më të lartë të tkurrjes me 16%, ndërkohë që ajo afatgjatë u tkurr me 3% në terma vjetorë. Vetëm kredia afatshkurtër për individë vijon të zhvillohet me ritme pozitive me një rritje vjetore prej 6%. Struktura e kredisë sipas maturitetit vijon të mbetet e njëjtë, ku kredia afatshkurtër përbën 6.8% të totalit, ajo afatmesme 13.7% dhe ajo afatgjatë 79.3%. Tkurrja më e madhe është reflektuar për kredinë në valutë e cila ka rënë me 6.9% në terma vjetorë, ndërkohë që kredia në lekë ka një zgjerim të lehtë me 1%. Si rrjedhim, në qershor 2012 kredia në valutë përbën 55.6% të totalit të kredisë për individë, kundrejt 57.1% që shënonte një vit më parë, dhe 56.6% në dhjetor 2011.

[12] *Në llogaritje nuk përfshihen jorezidentët.*

Grafik 2.3. Ecuria e kredisë për individët*.



*Në grafikun djathtas, paraqitet norma vjetore e rritjes së stokut të kredive me probleme, të tepricës së kredisë së individëve (në përqindje) në boshtin e majtë dhe raporti i kredive me probleme në përqindje në boshtin e djathtë.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përkeqësimi i ecurisë së kreditimit i shfaqur me një rritje të vazhdueshme të stokut të kredive me probleme, ka sjellë rritjen e raportit të kredive me probleme për individët. Në qershor 2012, ky raport shënoi vlerën 16.41%, krahasuar me 15.4% në fund të vitit 2011 dhe 13.9% në qershor 2011. Rritja e stokut të kredive me probleme gjatë gjysmës së parë të vitit 2012 ka ndodhur me një ritëm më të ngadaltë, por në kushtet kur edhe bankat kanë tkurrur huadhënien për individët, prirja mbetet shqetësuese. Pritshmëritë e fundit të vitit për një ekspozim më të lartë të individëve ndaj rrezikut të kredisë, në kushtet e një rritjeje ekonomike të ngadaltë dhe tendencë më të ulët të bankave për të kredituar, tashmë janë materializuar. Vlerësohet se zhvillimi[13] në terma të kreditimit për individët për pjesën e dytë të vitit 2012, kryesisht nga ana e kërkesës, do të jetë i ngjashëm me pjesën e parë të vitit.

2.3.2 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË KURSIT TË KËMBIMIT

Në qershor 2012, raporti "kredi e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit për individët/ kredia totale për individë" shënon vlerën 37.7%. Një vit më parë, ky raport qëndronte në nivelin 41.4% dhe në dhjetor 2011 ishte në nivelin 40.4%.

Rreth 84.5% e kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit përbëhet nga kredia për blerje shtëpie. Ky raport ka shënuar rritje ndaj nivelit 82.4% që shënonte një vit më parë.

[13] *Sipas Vrojtimit të aktivitetit kreditues për tremujorin e dytë 2012, kërkesa e individëve për kredi është në rënie edhe pse bankat raportojnë pritshmëri pozitive në terma të çlirimit të standardeve të miratimit të kredisë.*

Grafik 2.4. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të kursit të këmbimit*.



*Grafiku djathtas paraqet ecurinë e kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit për individët me dy përbërësit kryesorë të saj: kredia për blerje banese dhe kredia konsumatore.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e portofolit të kredisë së pambuluar nga lëvizjet e kursit të këmbimit është përkeqësuar më shpejt se portofoli i kredisë në valutë dhe portofoli i përgjithshëm i kredisë. Në qershor 2012, pjesa problematike e kredive të pambuluara nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit, për individët, u ngjit në nivelin 19.7%, nga 17.7% që shënonte në dhjetor 2011 dhe 14.7% një vit më parë.

Grafik 2.5. Cilësia e kredisë së individëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesi i cilësisë për portofolin e kredisë për individë në valutë, shënon 17.53% ndërsa për portofolin total të kredisë për individë qëndron në nivelin 16.41%. Për sa i përket cilësisë së portofolit për blerje banese, treguesi shënon 19.9%, një përkeqësim me 2.4 pikë përqindje ndaj fundit të vitit 2011 dhe 5.8 pikë përqindje ndaj qershorit 2011.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, treguesi "hua për blerje banese/ individë" është pothuaj i pandryshuar në nivelin 2.38 milionë lekë kundrejt 2.36 milionë lekë që shënonte në dhjetor 2011. Pavarësisht se pjesa më e madhe e kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit është e mbrojtur me kolateral, përkeqësimi i vazhdueshëm i cilësisë së saj duhet monitoruar me kujdes. Mbiçmimi mesatar i kursit të këmbimit lek/euro me 1.2% gjatë kësaj periudhe ka ndikuar pozitivisht në aftësitë paguese të huamarrësve, por faktorë të tjerë që ndikojnë të ardhurat e disponueshme mund të kenë patur një ndikim të kundërt më të rëndësishëm.

2.3.3 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË NORMËS SË INTERESIT

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit vijon prirjen rënëse. Raporti i kredisë me normë të ndryshueshme interesi ndaj totalit të tepricës së kredisë për individë arriti në nivelin 23.4%, nga 23.8% që shënonte në dhjetor 2011 dhe 26.5% një vit më parë. Ndërkohë normat e interesit për kredinë e marrë nga individët në monedhën vendase dhe atë të huaj, kanë shënuar rënie.

Grafik 2.6. Ekspozimi i individëve ndaj rrezikut të tërthortë të kredisë për shkak të normës së interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zhvillimet e pritshme për pjesën e dytë të vitit 2012 do të përcaktohen nga balancimi i faktorëve përcaktues të normave të interesit. Nga njëra anë, politika monetare akomoduese në vend ushtron presion për rënien e normave të interesit në afatin e parashikueshëm, ndërkohë që shtrëngimi i kushteve të miratimit të kredisë[14] në terma të marzhit mesatar[15] do të balancojë disi këtë efekt. Në tregjet ndërkombëtare, vlerësohet se normat e interesit për valutat kryesore do të ruhen në nivele të ulëta në kushtet e ngadalësimit të aktivitetit ekonomik.

- *BIZNESET*

Në qershor 2012, pozicioni debitor i bizneseve[16] shënoi vlerën 296.5 miliardë lekë, duke u zgjeruar me 40.87 miliardë lekë në krahasim me vitin e kaluar dhe me 15.44 miliardë lekë në krahasim me dhjetorin 2011. Ky zhvillim reflekton rritjen e kredisë me 38.79 miliardë lekë në krahasim me një vit më parë, ndërkohë që depozitat janë ngushtuar me 2.08 miliardë lekë. Sipas valutës, bizneset janë debitorë në masën 84.7 miliardë lekë në monedhën vendase dhe 211.78 miliardë lekë në monedhë të huaj. Pozicioni debitor në monedhën vendase është zgjeruar me 20.48 miliardë lekë dhe ai në valutë të huaj me 20.39 miliardë lekë kryesisht për shkak të rritjes më të shpejtë të kredisë në valutë ndaj depozitave.

Grafik 2.7. Pozicioni financiar i bizneseve*.



*Në grafikun majtas paraqitet ecuria e depozitave të bizneseve, kredisë së bizneseve dhe pozicionit debitor që matet si diferencë midis depozitave dhe kredisë. Në grafikun djathtas, pozicioni financiar i bizneseve është paraqitur per lekun dhe valuten.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

[14] *Sipas vrojtimit të aktivitetit kreditues të bankave, vlerësohet se standardet për miratimin e kredisë së re për bizneset janë shtrënguar lehtë në tremujorin e dytë të vitit 2012. Kjo politikë e bankave është zbatuar nëpërmjet zgjerimit të marzhit mesatar, rritjes së kërkesës për kolateral, rritjes së komisioneve dhe uljes së maturitetit maksimal të kredisë.*

[15] *Marzhi mesatar përcaktohet si ndryshimi ndërmjet normës së interesit të kredisë dhe normës së interesit të referencës së bankës (për shembull, norma e bonove të thesarit, Euribor, Libor).*

[16] *Pozicioni financiar i bizneseve vlerësohet si diferenca midis depozitave të bizneseve dhe kredive të tyre në sistem. Në kushtet kur kjo diferencë është negative, atëherë bizneset janë debitore të sistemit.*

2.3.4 RREZIKU I KREDITIT

Gjashtëmujori i parë i vitit 2012 ka shënuar një ngadalësim të vazhdueshëm të normës së rritjes së kreditimit të bizneseve. Në qershor 2012, kredia për biznese u zgjerua me 11.9% në terma vjetorë kundrejt 16.6% në dhjetor 2011 dhe 14.3% një vit më parë. Në strukturën e kreditimit sipas bizneseve vihet re një rritje e kreditimit për biznesin e vogël kundrejt ngadalësimit të kreditimit për biznesin e mesëm. Biznesi i madh reflekton një prirje të lehtë ngadalësuese të kreditimit. Ai ka ulur në mënyrë të ndjeshme peshën e huamarrjes afatgjatë[17] dhe afatshkurtër duke u përqendruar kryesisht te huamarrja afatmesme. Biznesi i vogël ka ulur peshën e huamarrjes afatshkurtër dhe afatmesme, duke rritur peshën e huamarrjes afatgjatë. Nga ana tjetër, biznesi i mesëm është përqendruar kryesisht te huamarrja afatshkurtër.

Grafik 2.8 Struktura e kredisë sipas afatit të maturimit për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë periudhës, ritmi i përkeqësimit të kredive me probleme për bizneset zbriti në 42.9%, nga 68.2% që shënonte në dhjetor 2011. Gjithsesi, rritja e raportit të kredive me probleme në nivelin 22.8% mbetet shqetësuese.

[17] *Në qershor 2012, huamarrja afatgjatë përbën 28.3% të totalit kundrejt 30.4% një vit më parë.*

Raporti i kredive me probleme për bizneset është rreth 6.4 pikë përqindje më i lartë se i njëjti raport për individët, të cilët nga ana tjetër kanë patur një tkurrje të kreditimit. Pavarësisht se me ritme të ngadalësuara, bizneset vijojnë të mbështeten me kreditim me një rritje vjetore 15.9% në fund të gjashtëmujorit të dytë 2012.

Për pjesën e dytë të vitit, në kushtet kur aktiviteti ekonomik dhe pritshmëritë e bankave për kreditim vlerësohen të ngjashme me pjesën e parë të vitit, rreziku i kredisë për bizneset do të vijojë të jetë i pranishëm.

Grafik 2.9 Cilësia e portofolit të bizneseve*.



*Në grafik paraqitet norma vjetore e rritjes së stokut të kredive me probleme, të tepricës së kredisë së bizneseve (në përqindje) në boshtin majtas dhe raporti i kredive me probleme në përqindje në boshtin djathtas.
Burimi: Banka e Shqipërisë.

2.3.5 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË KURSIT TË KËMBIMIT

Gjysma e parë e vitit 2012 ka shënuar një ulje të ndjeshme të ekspozimit të bizneseve ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit. Raporti i kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit ndaj tepricës totale të kredisë shënon nivelin 30% në krahasim me 37.2% në fund të vitit 2011. Kredia në valutë ndaj tepricës së kredisë për biznese gjithashtu ka shënuar rënie në 70.4%, kundrejt 71.4% në dhjetor 2011 dhe 72.8% një vit më parë.

Grafik 2.10 Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë për shkak të kursit të këmbimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Viti 2012 shënoi dhe tkurrjen e parë për kredinë e pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit akorduar bizneseve me mesatarisht 4.3%, ndërkohë që tkurrja për të njëjtën kredi për individët ka filluar në fund të vitit 2009[18]. Gjatë këtyre 6 muajve të parë të 2012-ës, 45.4% e

[18] *Mesatarja e tkurrjes për kredinë në valutë të pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit për individët, është 14.4% gjatë gjashtëmujorit të parë 2012.*

kredisë së pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit për bizneset përbëhet nga kredia "për tregti", në rritje me 2.4 pikë përqindje ndaj fundit të vitit 2011 por në rënie me 1.5 pikë përqindje ndaj një viti më parë. Përbërësi i dytë i rëndësishëm i kësaj kredie është "për zhvillim biznesi" dhe përbën 30.5% të totalit, në rritje të vazhdueshme ndaj vitit 2011. Ndërkohë, kredia për zhvillimin e pasurive të paluajtshme është zvogëluar në nivelin 9.6% të totalit nga 10.4% që shënonte në dhjetor 2011.

Cilësia e portofolit për kredinë e pambuluar nga lëvizjet e kursit të këmbimit të bizneseve është përkeqësuar më shpejt se portofoli i kredisë totale dhe i kredisë në valutë. Në qershor 2012, raporti i kredive me probleme në valutë për kredinë e pambuluar nga rreziku i tërthortë i kreditit për shkak të kursit të këmbimit shënoi vlerën më të lartë historike 25.2%. Ky tregues është në nivelin 24.1% për kredinë në valutë të bizneseve dhe 22.77% për kredinë totale të bizneseve. Përkeqësimi është vërejtur në të gjitha kategoritë e kredisë në valutë të bizneseve.

Grafik 2.11. Cilësia e kredisë për bizneset.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Portofoli i kredisë së pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit për qëllime tregtie është me probleme në masën 19.1% nga 14.1% që shënonte në dhjetor 2011. Ndërkohë, ky tregues për kredinë për zhvillim biznesi, ka kërcyer në nivelin 35.8% nga 27.2% në dhjetor 2011. Përkeqësimi është edhe më i ndjeshëm për kredinë dhënë bizneseve për zhvillim të pasurive të paluajtshme në nivelin 37.6% nga 33% që shënonte në fund të vitit 2011. Këto zhvillime reflektojnë një rritje të stokut të kredive me probleme por edhe tkurrjen e kreditimit të pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012.

2.3.6 RREZIKU I TËRTHORTË I KREDITIT PËR SHKAK TË NORMËS SË INTERESIT

Në qershor të vitit 2012, ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit është rritur. Raporti i kredisë me normë të ndryshueshme të interesit ndaj tepricës së kredisë për bizneset arriti në 63.8% kundrejt 63.5% në dhjetor 2011 dhe 60.8% një vit më parë. Raporti vijon të mbetet mbi mesataren afatgjatë të tij.

Grafik 2.12. Ekspozimi i bizneseve ndaj rrezikut të tërthortë të kreditit për shkak të normës së interesit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht se në qershor 2012 normat e interesit të kredisë së re për bizneset kanë shënuar një rritje të lehtë për kredinë në lekë dhe dollarë, sërish ato mbeten në nivele të ulëta në krahasim me një vit më parë. Më konkretisht, norma e interesit të kredisë për bizneset është zvogëluar me përkatësisht 0.46 pikë përqindje, 1.1 pikë përqindje dhe 0.55 pikë përqindje për kredinë në lekë, dollarë dhe euro, kundrejt një zvogëlimi me 1.07 pikë përqindje, 0.41 pikë përqindje dhe 1.22 pikë përqindje përkatësisht për individët. Këto zhvillime reflektojnë tendencën e bankave për të mbështetur bizneset me kredi por duke zbutur më pak koston e tyre.

Hapësirë informuese 3. Vrojtimi mbi situatën financiare të individëve dhe bizneseve.

Për të mbështetur vlerësimin mbi gjendjen financiare të individëve dhe të bizneseve, Banka e Shqipërisë kryen një vrojtim të posaçëm i cili zhvillohet çdo gjashtë muaj. Vrojtimi i fundit u krye në periudhën qershor-korrik 2012, duke u fokusuar në zhvillimet e gjashtëmujorit të parë të vitit.

A. VROJTIMI MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJEN E INDIVIDËVE

- Situata financiare

Sipas rezultateve të vrojtimit, gjatë periudhës burimet kryesore të të ardhurave për individët vazhdojnë të mbeten: vetëpunësimi, pensioni dhe puna në sektorin privat, përkatësisht për 25%, 28% dhe 24% të numrit total të të punësuarve në familjet e anketuara. Pesha e "emigracionit" si burim të ardhurash në 6-mujorin e parë 2012, ka mbetur në nivele të njëjta me 6-mujorin e fundit të vitit 2011, ndërsa është rritur pesha e të vetëpunësuarve në raport me totalin e të punësuarve.

- Huamarrja

Në totalin e familjeve të intervistuara, rreth 31% e kampionit (373 familje) pohojnë se kanë aktualisht një hua për të paguar, çka përbën një rritje me rreth 4 pikë përqindje krahasuar me gjashtëmujorin e kaluar. Në 43% të rasteve, familjet huamarrëse deklarojnë se kanë marrë hua nga bankat (39%) dhe institucione të tjera financiare jobankare (4%); në 54% të rasteve, familjet huamarrëse deklarojnë se i janë drejtuar burimeve informale, nga persona fizikë (40%) dhe nga dyqanet (15%). Në 13% të rasteve, familjet deklarojnë se kanë aktualisht më shumë se një hua të marrë nga burime të ndryshme.

Qëllimet kryesore të marrjes së huasë nga familjet mbeten "blerja/riparimi i një prone të paluajtshme" në 36% të rasteve, "konsumi" në 27% të rasteve dhe "zhvillimi i biznesit" në 16% të rasteve. Pesha e familjeve që deklarojnë se kanë marrë hua me qëllim blerje/riparim të një prone ka shënuar rënie me 4 pikë përqindje krahasuar me 6-mujorin e kaluar, ndërsa dy zërat e tjerë kanë qëndruar në nivele të ngjashme. Euroizimi i huamarrjes vazhdon të jetë i ulët (91% e rasteve në lekë), kryesisht për shkak të huamarrjes së lartë nga persona fizikë. Koha e mbetur për shlyerjen e stokut të huasë në momentin e intervistimit, është kryesisht 1-3 vjet në 39% të rasteve dhe deri në 12 muaj në 34% të rasteve.

- Ngarkesa e borxhit për familjet

Në këtë vrojtim, rreth 32% e familjeve borxhmarrëse deklarojnë përkeqësim të aftësisë së tyre paguese, kryesisht për shkak të rënies së të ardhurave, rritjes së shpenzimeve të domosdoshme ose si kombinim i të dyjave. Për të përballuar vështirësitë financiare lidhur me shlyerjen e detyrimeve të borxhit, nga përgjigjet rezulton se në 45% të rasteve familjet ulin shpenzimet e tyre dhe vetëm 8% e rasteve kërkojnë një rinegocim të kushteve të borxhit.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, rreth 65% e familjeve huamarrëse nuk presin ndryshim të aftësisë së tyre paguese, ndërsa rreth 26% presin përkeqësim, krahasuar me 16% në vrojtimin e kaluar. Përsa i përket mundësisë së marrjes së një borxhi të ri në gjashtëmujorin e ardhshëm, rreth 61% e të përgjigjurve kanë deklaruar se nuk ekziston si mundësi.*

Grafik 2.13. Balanca neto e përgjigjeve mbi zhvillimet në aftësitë paguese të individëve dhe pritshmëritë përkatëse.



Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

B. VROJTIMI MBI SITUATËN FINANCIARE DHE HUAMARRJA E BIZNESEVE

- Situata financiare

Për të analizuar gjendjen financiare dhe të huamarrjes së bizneseve në vend në kushtet e mungesës së të dhënave zyrtare, marrim në konsideratë rezultatet e vrojtimit të realizuar për gjashtëmujorin e parë të vitit, nëpërmjet një kampioni prej 712 biznesesh të intervistuara të shpërndara gjeografikisht në të gjithë vendin. Gjatë kësaj periudhe, vetëm 15.7% e bizneseve të intervistuara kanë pohuar zgjerim të veprimtarisë së tyre apo rritje investimesh në 6 muajt e fundit, ndërkohë që pjesa kryesore e tyre (56.7%) nuk e kanë ndryshuar veprimtarinë e tyre.

- Huamarrja

Në totalin e ndërmarrjeve të përgjigjura, 56.4% (ose 47.9% e kampionit total) kanë aktualisht një hua për të paguar, një rritje prej 6.5 pikësh përqindje në krahasim me gjashtëmujorin e kaluar. Financimi i veprimtarisë nëpërmjet huamarrjes si burim më vete apo i kombinuar është realizuar për 29.3% të bizneseve të intervistuara (209 të tilla), rreth 3.6 pikë përqindje më tepër se në gjashtëmujorin e kaluar. Shitjet kanë financuar vetëm 15.3% të ndërmarrjeve të kampionit total ose 31.3% të bizneseve të përgjigjura, duke konfirmuar uljen e nivelit të shitjeve në këtë gjashtëmujor, të pohuar nga 41.7% e ndërmarrjeve të intervistuara. Në kushtet kur pjesa më e madhe e bizneseve pohojnë se mbi 80% e produkteve të tyre shiten brenda vendit, ngadalësimi i aktivitetit ekonomik në vend ndikon në ngadalësimin e shitjeve të bizneseve. Në këtë aspekt, rezultati financiar ka pësuar ulje gjatë këtij gjashtëmujori, e raportuar nga 43.5% e ndërmarrjeve. Ndërkohë, 26.4% e tyre dëshmojnë një rezultat financiar të pandryshuar në këtë periudhë.

Veprimtaria e biznesit është realizuar kryesisht në lekë për 75.3% të bizneseve të përgjigjura dhe vetëm në lekë për 17.5% të tyre. Ndërkohë, bizneset huamarrëse të përgjigjura tregojnë që shuma e huasë së mbetur për t'u paguar është në monedhën vendase për 52.9% të tyre dhe në euro për 36.4% të tyre, duke dëshmuar për ekspozim ndaj rrezikut të kursit të këmbimit.

Huaja e bizneseve është përfituar në 5 vitet e fundit për 49% të të intervistuarve dhe gjatë vitit të fundit për 29.3% të tyre. Sidoqoftë, 48.4% e huave të këtyre

ndërmarrjeve do të shlyhen brenda një afati të mesëm kohor, 29% e tyre në një afat të gjatë, duke lënë kështu një përqindje më të ulët për periudhën afatshkurtër. Qëllimi i përdorimit të huasë është përballimi i shpenzimeve afatshkurtra për 35.6% të bizneseve të përgjigjura dhe kryerja e një investimi afatgjatë për 34.1% të tyre. 73.3% e bizneseve kanë vendosur si kolateral një pasuri të paluajtshme për huanë e tyre, ndërkohë që huamarrja pa kolateral ka vijuar të zvogëlohet, duke arritur në vetëm 2.3% të ndërmarrjeve të intervistuara.

Grafik 2.14. Indeksi i shpërndarjes së pritshmërive mbi pagesën e huasë*.



*Ky indeks është ndërtuar nëpërmjet kuantifikimit të përgjigjeve cilësore mbi pritshmëritë e bizneseve për pagesën totale të huasë në gjashtëmujorin pasardhës. Ai llogaritet si mesatare e ponderuar e frekuencave të përgjigjeve dhe vlerës së tyre për secilën alternativë. Konkretisht, këto vlera janë: 0 = nuk do të ndryshojë, 1 = do të rriten, -1 = nuk do të rriten.
Burimi: Llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

- Ngarkesa e borxhit të bizneseve

Vlera e përgjithshme e huasë në krahasim me kapitalin është afërsisht sa gjysma për 70.4% të ndërmarrjeve të përgjigjura, rreth 3.1% më pak se gjashtëmujorin e kaluar. Rreth 74% e bizneseve të përgjigjura pohojnë se në gjashtë muajt e kaluar shpenzimi për huanë ka zënë deri në 20% të të ardhurave, ndërsa 19.5% e tyre kanë shpenzuar 20-50% të të ardhurave të tyre për ta shlyer atë. Ndër bizneset e përgjigjura, 79% pranojnë që shpenzimi i tyre për pagesën e huasë nuk ka ndryshuar, por 17.2% tregojnë që ky shpenzim ka ardhur në rritje gjatë periudhës së analizuar.

Duke vlerësuar pritshmëritë për gjashtëmujorin e ardhshëm, nga totali i huamarrësve të përgjigjur pritet një rritje e lehtë e pagesës së huasë, ndonëse për sektorë të ndryshëm këto rezultate janë të ndryshme. Gjithsesi, 67.3% e bizneseve nuk parashikojnë të marrin një hua në gjashtëmujorin e dytë të vitit.

* *Kjo pyetje i drejtohet të gjithë kampionit të familjeve (1209 familje) dhe i është përgjigjur 85% e tij (1027 familje).*

3. TREGJET FINANCIARE

Gjashtëmujori i parë i vitit 2012 ka shënuar një rritje të aktivitetit në tregjet financiare. Tregu ndërbankar është karakterizuar nga vëllime më të larta të transaksioneve, duke dëshmuar përshtatshmërinë e likuiditetit dhe perceptimin më të qëndrueshëm për ecurinë e normave të interesit nga ana e operatorëve të tregut. Një ndër zhvillimet kryesore në tregjet financiare ka qenë vendimi i një banke të madhe në vend, pjesë e një grupi të rëndësishëm bankar evropian, për tërheqjen e papritur nga ankandet e borxhit të Qeverisë Shqiptare. Shkak për këtë veprim ishte kërkesa e autoritetit rregullativ të vendit të origjinës, në zbatim të rekomandimeve të Autoritetit Bankar Evropian për përmirësimin e treguesve të kapitalit të grupeve më të mëdha bankare evropiane. Oferta e likuiditetit të bankave të tjera të sektorit dhe veprimet e fuqishme mbështetëse të Bankës së Shqipërisë, arritën të plotësojnë vakumin e krijuar dhe të ruajnë luhatshmëri të ulët të normave të interesit tek titujt e borxhit të qeverisë. Sidoqoftë, kjo ngjarje, e cila testoi kuadrin e Bankës së Shqipërisë për operacionet në treg, tregoi nevojën për rritjen e konkurrencës në tregun bankar, për zgjerimin e bazës së investitorëve në titujt e borxhit të qeverisë dhe përmirësimin e funksionimit të tregut sekondar, me qëllim uljen e përqendrimit në shpërndarjen e borxhit dhe pakësimin e rrezikut të rifinancimit. Emetimet e borxhit gjatë periudhës ishin më të larta në afatin 12-mujor, për t'iu përgjigjur më mirë preferencës së pjesëmarrësve të tregut. Gjatë periudhës, tregu sekondar i titujve të borxhit ka shënuar vëllime më të larta të tregtimit, duke reflektuar veprimet mes bankave për t'iu përshtatur ndryshimeve strukturore të likuiditetit në treg si edhe hyrjen e operatorëve të rinj jobankarë. Tregu i këmbimeve valutore, gjithashtu ka njohur rritje të vëllimeve të tregtimit. Në këtë treg, monedha kombëtare ka shfaqur qëndrueshmëri ndaj shportës së valutave kryesore. Një analizë më e detajuar e ecurisë së tregjeve individuale paraqitet në vijim.

3.1 TREGU PRIMAR I TITUJVE TË BORXHIT

Vëllimi i letrave me vlerë të borxhit të qeverisë të emetuara gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, është ngjitur në nivelin 231.4 miliardë lekë nga 185.6 miliardë lekë që rezultonte një gjashtëmujor më parë. Për sa i takon përbërjes së emetimeve, bonot e thesarit zënë 82.2% dhe notat/obligacionet zënë 17.8% të vlerës. Gjatë gjysmës së parë të vitit, pesha e borxhit me afat më të gjatë se një vit në totalin e borxhit ekzistues është rritur me 3.2 pikë përqindje.

Norma mesatare e interesit të borxhit të emetuar gjatë periudhës është rritur lehtë me 0.06 pikë përqindje në nivelin 7.29%. Në krahasim me një gjashtëmujor më parë, norma mesatare e interesit të bonove të thesarit ka shënuar rënie, ndërsa ajo e borxhit me afat mbi një vit ka shënuar rritje duke kontribuar në rritjen e normës mesatare të interesit për të gjithë borxhin.

Grafik 3.1.1. Ecuria e normës mesatare të interesit të borxhit të emetuar në letra me vlerë (në %).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.1.2. Vëllimi dhe normat e kthimit të bonove në tregun primar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, bonot e thesarit kanë arritur një vlerë prej 190.2 miliardë lekësh nga 158.4 miliardë lekë në fund të vitit 2011. Vëllimi i instrumenteve të emetuara është rritur me 20.1% ndaj fundit të vitit 2011, dhe me 4% ndaj së njëjtës periudhë të një viti më parë. Në krahasim me fundin e vitit 2011, rritja në vëllimin e bonove të thesarit të emetuara i atribuohet rritjes së atyre me afat maturimi 12 muaj me rreth 41 miliardë lekë ose 47.6%, ndërkohë që bonot me afat maturimi 6 muaj kanë rënë me 1.3 miliardë lekë ose 2.9%, dhe ato me afat 3 muaj kanë rënë me 7.9 miliardë lekë ose 28.5%. Në fund të periudhës, në borxhin ekzistues në bono thesari, ato me afat maturimi 12 muaj zinin 66.9%, ato me afat maturimi 6 muaj zinin 22.6% dhe ato me afat maturimi 3 muaj zinin 10.5%. Në borxhin e emetuar me instrumentin e bonove të thesarit, konstatohet prirja për zhvendosjen drejt emetimeve me afat 12 muaj, duke reflektuar edhe preferencën e subjekteve investuese.

Norma mesatare e interesit vijon rënien me ritme të lehta. Niveli në fund të periudhës ishte 6.9%, ose 0.05 pikë përqindje më i ulët se në fund të gjashtëmujorit të dytë të vitit 2011 dhe 0.08 pikë përqindje më i ulët se një vit më parë. Ky nivel vlerësohet 0.5 pikë përqindje më i ulët se mesatarja 4-vjeçare.

Gjatë periudhës, edhe emetimet e borxhit në formën e notave/obligacioneve janë rritur, duke u ngjitur në vlerën 41.2 miliardë lekë ose 51.7% më shumë krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe 18.8% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndër këto emetime, titujt me afat maturimi 2-vjeçar zënë 52.5% të vlerës, pasuar nga ato me afat maturimi 5-vjeçar me normë interesi të ndryshueshme që zënë 23.5%, ato me afat maturimi 3-vjeçar që zënë 12.8%, ato me afat maturimi 5-vjeçar me normë interesi të pandryshueshme që zënë 5.1% dhe ato me afat maturimi 7-vjeçar me normë interesi të ndryshueshme dhe të pandryshueshme që së bashku

zënë 6% të vlerës. Në krahasim me fundin e vitit 2011, borxhi me afat maturimi 2-vjeçar është rritur me 4.4 miliardë lekë ose 25.6% dhe ai me afat maturimi 3-vjeçar pothuaj është dyfishuar duke u rritur me 3.5 miliardë lekë.

Norma e interesit për këto instrumente ka vijuar prirjen rritëse të vërejtur që nga viti i kaluar, megjithatë në raport me mesataren 4-vjeçare qëndron vetëm 0.04 pikë përqindje më lart.

Në vijim pasqyrohet ecuria e normave të interesit sipas strukturës së maturimit të letrave me vlerë të borxhit të qeverisë.

Grafik 3.1.3. Ecuria e ankandeve të obligacioneve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.1.4. Normat mesatare të interesit të borxhit në tregun primar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.2 TREGU SEKONDAR I TITUJVE TË BORXHIT

Në gjysmën e parë të vitit 2012, është vënë re një aktivizim i konsiderueshëm i tregtimit të titujve në tregun sekondar, ku vijon të mbizotërojë shitblerja e bonove të thesarit.

Vëllimi i transaksioneve të bonove të thesarit regjistroi në vlerë nominale një shifër prej 18.4 miliardë lekësh, pothuaj dy herë më e lartë se vlera e tregtimit të realizuar gjatë gjithë vitit 2011 (9.3 miliardë lekë). Vlerat më të larta të tregtimit vijojnë t'i regjistrojnë bonot me afat maturimi 12 muaj, ndonëse gjatë periudhës vëllimi i tregtuar i bonove me afat maturimi 3 muaj pati një rritje më të shpejtë.

Grafik 3.2.1. Vëllimi i tregtimit të bonove në tregun sekondar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

3.3 TREGU NDËRBANKAR

Vëllimi i transaksioneve në tregun ndërbankar u rrit me 42.9% gjatë gjysmës së parë të vitit 2012. Në terma vjetorë, vëllimi i tregut ndërbankar pothuajse është dyfishuar. Për këtë zhvillim kanë kontribuar një sërë faktorësh të përmendur edhe më parë, ku veçojmë veprimet e bankave për t'iu përshtatur ndryshimeve strukturore të likuiditetit në treg, rënien e ritmit të rritjes së kreditimit dhe rritjen e depozitave. Këto faktorë kanë ndikuar përgjithësisht në rritjen e madhësisë së fondeve të disponueshme për veprime në tregun ndërbankar, dhe kanë ushtruar presion për uljen e normave të interesit në këtë treg.

Në transaksionet e tregut ndërbankar, vijojnë të mbizotërojnë ato me afat maturimi 1-ditor, ndonëse numri i transaksioneve me afat maturimi 1-javor dhe 1-mujor është rritur. Gjatë periudhës, vëllimet më të larta të transaksioneve për secilin afat maturimi, u realizuan në muajin mars kur u materializuan ndryshimet e para strukturore të likuiditetit nga operatorët në treg.

Grafik 3.3.1. Vëllimi dhe normat e interesit në tregun ndërbankar.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Veprimet lehtësuese të politikës monetare në gjashtëmujorin e parë të vitit janë reflektuar edhe në normat e interesit në tregun ndërbankar, ku mesatarja e ponderuar ka zbritur në nivelin 4.17%, nga 5.12% një periudhë më parë. E njëjta pirje është transmetuar edhe në ecurinë e normave të interesit të kredive dhe të depozitave të reja në monedhën vendase (trajtuar më gjerë në paragrafët përkatës të kredisë dhe depozitave).

Përsa i përket normës së interesit sipas afatit të maturimit të transaksionit, interesat për transaksionet ditore dhe javore kanë qenë më të larta në tremujorin e parë dhe më të ulëta në tremujorin e dytë, krahasuar me normën bazë të interesit. Ky devijim është minimizuar në fund të qershorit 2012.

3.4 TREGU I KËMBIMEVE VALUTORE

Ecuria e kursit të këmbimit të euros ndaj valutave kryesore vlerësohet e qëndrueshme, duke reflektuar kryesisht ecurinë e tyre në tregjet ndërkombëtare të këmbimit.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, monedha vendase është mbiçmuar ndaj monedhës evropiane me rreth 2.4%, ndërkohë që ndaj dollarit amerikan është nënçmuar me rreth 12.0%. Krahasuar me fundin e vitit 2011, leku është paraqitur i qëndrueshëm në këmbimin me euron, duke u nënçmuar me rreth 5.1% ndaj dollarit amerikan.

Në terma realë, gjatë periudhës kursi nominal efektiv (NEER) dhe kursi real efektiv (REER) i lekut kanë forcuar pirjet e tyre vjetore, duke u dobësuar përkatësisht me 1.3% dhe 1.8%. Kjo ecuri ofron një mbështetje më të mirë për konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregjet e huaja, përsa i takon çmimit të tyre. Sidoqoftë, ky ndikim vlerësohet i moderuar në kushtet kur faktorë të tjerë që lidhen me cilësinë e produkteve dhe tregtueshmërinë e tyre janë shumë të rëndësishëm, dhe kur importet dhe eksportet tona vlerësohen me ndjeshmëri të ulët ndaj ndryshimit të çmimit.

Grafik 3.4.1. Ecuria e kursit të këmbimit për tre monedhat kryesore.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 3.4.2. Treguesit e kursit nominal efektiv (NEER) dhe të kursit real efektiv (REER).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

4. ZHVILLIMET NË SISTEMIN E PAGESAVE GJATË GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2012

4.1 ECURIA E SISTEMIT TË PAGESAVE

Sistemet e pagesave janë një pjesë e rëndësishme në strukturën e një sistemi financiar, duke qenë kanalet nëpërmjet të cilave mundësohet transferimi i fondeve ndërmjet bankave, institucioneve të tjera financiare dhe klientëve. Si rrjedhojë, operimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme dhe eficiente kontribuon në mënyrë të rëndësishme në ruatjen e stabilitetit financiar. Në këtë kuadër, vlerësohet që sistemet AIPS dhe AECH, infrastruktura bazë e pagesave në lekë, kanë operuar në përputhje me kërkesat që përcakton kuadri i tyre rregullativ dhe operacional.

Të dhënat statistikore në lidhje me vlerat dhe vëllimet e transaksioneve të procesuara në këto dy sisteme, gjatë periudhës janar–qershor 2012, tregojnë një rritje të konsiderueshme në terma të vlerës, në një kohë që numri i transaksioneve paraqitet i qëndrueshëm. Në sistemin AIPS, rritja e konsiderueshme e vlerës së transaksioneve ka ardhur kryesisht si pasojë e zërit "Transaksione/instrumente financiare BSH" dhe "Pagesa ndërbankare", duke reflektuar veprimet e bankave në tregun ndërbankar për t'iu përshtatur ndryshimeve strukturore të likuiditetit.

Tabelë 4.1. Aktiviteti në AIPS për gjashtëmujorin e parë 2012.

Sistemi AIPS	Janar - qershor 2011	Janar - qershor 2012
Numri i transaksioneve	37,045.00	37,250.00
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	1,873.23	2,670.66
Vlera mesatare për transaksion (milionë lekë)	50.57	71.70

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 4.2. Aktiviteti në AECH për periudhën janar-qershor 2012.

Sistemi AECH	Janar - qershor 2011	Janar - qershor 2012
Numri i transaksioneve	183,342	183,621
Vlera e transaksioneve (milionë lekë)	28,624	32,257
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	0.16	0.18

Burimi: Banka e Shqipërisë.

4 bankat më aktive në sistem zënë 26.2% të numrit të transaksioneve dhe 45.1% të vlerës së tyre.

Përsa u përket instrumenteve të pagesave, transfertat e kreditit mbizotërojnë në totalin e pagesave, por pesha e tyre është në rënie në favor të pagesave elektronike, pagesave me kartë bankare, debitimit direkt dhe *home banking*.

Tabelë 4.3. Shpërndarja e pagesave për klient sipas llojit të instrumenteve për periudhën janar- qershor 2012.

	Numri					Vlera				
	2008	2009	2010	2011	2012	2008	2009	2010	2011	2012
Transferta kreditimi të iniciuara nga klientët	88.30%	82.16%	81.08%	79.15%	75.58%	97.96%	96.08%	94.25%	95.23%	94.53%
1-transfertë krediti në formë letër	98.42%	97.59%	97.29%	97.05%	96.61%	98.27%	97.93%	97.15%	97.25%	96.71%
2-transfertë krediti në formë joletër	1.58%	2.41%	2.71%	2.95%	3.39%	1.73%	2.07%	2.85%	2.75%	3.29%
Pagesa të iniciuara nga klientët me kartë	4.60%	5.85%	7.15%	9.33%	11.90%	0.11%	0.14%	0.22%	0.28%	0.35%
Debitimi direkt	5.53%	10.94%	10.84%	10.75%	11.81%	0.48%	1.79%	3.55%	2.29%	2.81%
Çeqet	1.56%	1.06%	0.93%	0.77%	0.71%	1.44%	1.99%	1.99%	2.20%	2.31%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5. ZHVILLIME TË SISTEMIT FINANCIAR

Zhvillimet financiare paraqiten të qëndrueshme. Sektori bankar paraqitet i mirëkapitalizuar, likuid dhe me rritje të treguesve të fitimit, megjithatë evidentohet një ritëm më i ulët i rritjes së nivelit të aktiveve krahasuar me një vit më parë. Ritmi vjetor i rritjes së kredisë ka rënë, ndërkohë që depozitat vijojnë të rriten me ritme të qëndrueshme. Institucionet financiare jobanka dhe shoqëritë e kursim-kreditit kanë zgjeruar aktivitetin e tyre, ndërkohë që aktiviteti i shoqërive të sigurimit paraqet ngadalësim. Tregu i pensioneve private suplementare, ndonëse i kufizuar, paraqet zhvillime pozitive që janë reflektuar në rritjen e nivelit të aktiveve të shoqërive që administrojnë fondet e pensionit. Gjatë periudhës, patëm hyrjen në treg dhe zgjerimin e shpejtë të veprimtarisë së një fondi investimi. Krahas zhvillimeve pozitive në sistemin financiar, rreziku i kreditit vijon të mbetet rreziku kryesor për institucionet që kryejnë aktivitet kreditues në vend.

Niveli i ndërmjetësimit financiar në Shqipëri, i llogaritur si raport i aktiveve të sistemit financiar[19] ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) vlerësohet në nivelin 92.8% në fund të qershorit 2012, nga 89.5% në fund të vitit 2011 dhe 86.9% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vëllimi i aktiveve të institucioneve financiare u rrit me rreth 4.2% krahasuar me një gjashtëmujor më parë dhe rreth 11.6% krahasuar me një vit më parë. Sektori bankar mbetet segmenti kryesor i ndërmjetësimit financiar, aktivet e të cilit përfaqësojnë rreth 93.9% të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi dhe rreth 87.2% të PBB-së.

Tabelë 5.1. Pesha e segmenteve të sistemit financiar ndaj PBB-së në vite (në përqindje).

Autoriteti licencues dhe mbikëqyrës	Sistemi financiar	2007	2008	2009	2010	2011	2012-6M1
Banka e Shqipërisë	Sistemi bankar	75.9	76.7	77.5	80.9	84.7	87.2
	Institucione jobanka	1.5	1.7	2.2	2.7	2.5	2.5
	SHKK-të dhe Unionet e tyre	0.6	0.7	0.8	0.8	0.7	0.7
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare	Shoqëri sigurimi	1.4	1.4	1.5	1.4	1.5	1.5
	Fondet e pensionit	-	-	0.01	0.01	0.01	0.01
	Fonde Investimi						0.86

Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[19] *Sistemi financiar përbëhet nga bankat, institucionet financiare jobanka, shoqëritë e kursim-kreditit (SHKK), shoqëritë e sigurimit, fondet e pensioneve private suplementare si dhe fonde të investimit. Në analizën e këtij kapitulli, ju lutemi konsideroni faktin që aktiviteti i jobankave mbështetet në të dhënat e raportuara prej tyre dhe në vlerësime të Departamentit të Stabilitetit Financiar.*

Sektori financiar jobankar, vijon të pasqyrojë një peshë totale të vogël ndaj tërësisë së sistemit financiar. Kështu, totali i aktiveve të sektorit financiar jobankar[20] përfaqëson rreth 6.1% të sistemit financiar, duke shënuar rritje të peshës referuar fundit të vitit 2011 kur rezultonte 5.3%. Kjo rritje i atribuohet futjes në treg gjatë periudhës të fondit të investimit "Raiffeisen Prestige". Në fund të periudhës, pesha e aktivitetit të sektorit financiar jobankar ndaj PBB-së ishte 5.6%.

Grafik 5.1. Pesha e subjekteve të sistemit financiar ndaj totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

[20] *Informacioni për totalin e aktiveve të fondeve të pensionit është marrë nga publikimi më i fundit i AMF, 19 qershor 2012.*

Hapësirë informuese 5.1. Sektori financiar jobankar.

AKTIVITETI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE JOBANKA

Institucionet financiare jobanka licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Në gjysmën e parë të vitit 2012, aktivet e institucioneve financiare jobanka rezultuan 33.8 miliardë lekë, rreth 115.5 milionë lekë (ose 0.3%) më shumë se në fundin e vitit 2011 dhe 1.1 miliardë lekë (ose 3.4%) më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Peshën kryesore në aktivitetin e jobankave e zë aktiviteti kreditues, me një peshë prej 60% të totalit të aktiveve. Edhe pse me ritme pozitive rritjeje, portofoli i kredisë mbetet me një tendencë në rënie që nga gjysma e dytë e vitit 2010.

Grafik 5.2. Ecuria e aktiveve dhe portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i kapitalizimit, i matur si raport i llogarisë së kapitalit me totalin e aktiveve në gjysmën e parë të vitit 2012, ka shënuar rritje në nivelin 38.5% nga 36.8% në fund të vitit 2011 dhe 36.4% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafik 5.3. Ecuria e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe raportit të huave me probleme, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Cilësia e portofolit të kredisë për institucionet financiare jobanka ka vijuar rënien referuar fundit të vitit 2011 dhe të njëjtës periudhë të një viti më parë. Më konkretisht, raporti "hua me probleme / totalit të kredisë" u ngjit në 8.9% nga 6.9% në fund të vitit 2011 dhe 7.6% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Përkeqësimi i cilësisë së kredisë, reflekton ngadalësimin e përgjithshëm të rritjes ekonomike dhe një mjedis përgjithësisht më sfidues për huamarrësit.

Institucionet financiare jobanka kanë shënuar rritje të rezultatit financiar në gjysmën e parë të vitit 2012, ku fitimi neto rezultoi 788 milionë lekë, nga 742 milionë lekë referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Përsa i përket nivelit të të ardhurave për të njëjtën periudhë, ato shënuan nivelin 3.9 miliardë lekë, nga 3.7 miliardë lekë një vit më parë. Kontributin kryesor në këtë rritje të të ardhurave e dhanë kryesisht "të ardhurat nga komisionet" të cilat u rritën me 256 milionë lekë, duke zbutur efektin negativ të rënies së të ardhurave nga interesat, të cilat ranë me 26 milionë.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT

Veprimtaria e shoqërive të kursim-kreditit në gjysmën e parë të vitit 2012 paraqet zhvillime pozitive përsa i përket rritjes së nivelit të aktiveve dhe zgjerimit të portofolit të kredisë krahasuar me fundin e vitit 2011. Megjithatë, ato kanë thelluar humbjen financiare referuar një viti më parë, kryesisht si rezultat i rënies së cilësisë së portofolit të kredisë.

Tabelë 5.2. Ecuria e disa treguesve të aktivitetit të shoqërive të kursim-kreditit dhe unioneve të tyre.

	6M 1-2010	6M 2-2010	6M 1-2011	6M 2-2011	6M 1-2012
Totali i aktiveve (mln lek)	9,378.00	9,705.00	9,649.57	9,808.68	9,901.69
Teprica e kredisë (mln lek)	7,125.00	7,072.00	6,946.58	7,118.68	7,261.55
Teprica e kredisë/totalit të aktiveve (%)	75.90	72.80	71.99	72.58	73.34
Kredi me probleme (mln lek)	237.10	357.90	315.11	315.65	389.20
Kredi me probleme/tepricës së kredisë (%)	3.30	5.06	4.54	4.40	5.36

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shoqëritë e kursim-kreditit bashkë me unionet e tyre kanë thelluar humbjen financiare në nivelin 35.9 milionë lekë, ndërkohë që një vit më parë ato rezultonin me një fitim pozitiv prej 9.6 milionë lekësh. Ky rezultat negativ është kryesisht rrjedhojë e rritjes së provigjoneve të një prej unioneve financiare, ndërkohë që paralelisht me këtë zhvillim evidentohet rritje në shpenzimet administrative dhe të tjera.

AKTIVITETI I SHOQËRIVE TË SIGURIMIT DHE SHOQËRIVE TË PENSIONEVE PRIVATE SUPLEMENTARE

Tregu i sigurimeve për periudhën janar-qershor 2012 paraqet një ngadalësim të aktivitetit të tij ku të ardhurat nga primet dhe numri i kontratave të reja kanë shënuar rënie. Ky ngadalësim është evidentuar edhe në nivelin e kapitalizimit si dhe në treguesit e performancës financiare RoE dhe RoA. Ky treg vijon të mbetet i orientuar tek sigurimet e jojetës.*

Gjatë periudhës janar-qershor 2012, të ardhurat nga primet e sigurimit arritën rreth 4,072 milionë lekë ose 5.56% më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, dëmet e paguara arritën nivelin 1,501 milionë lekë ose 35.9% më shumë se një vit më parë. Si rezultat i kësaj rritjeje, raporti dëme/prime, i cili mat dhe depërtimin e tregut të sigurimeve në sistemin

financiar shënoi një rritje të qenësishme në nivelin 36.8% nga 26% që llogaritej në fund të vitit 2011. Numri i kontratave të lidhura shënoi një rënie me rreth 25.4% krahasuar me periudhën e një viti më parë.

Grafik 5.4. Pesha e zërave të aktiveve të shoqërive të sigurimit, në përqindje.



Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Tregu vijon të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e jojetës, të cilat sollën rreth 88.63% të vëllimit të përgjithshëm të primeve. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar përfaqësuan 54.48% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zunë 45.52% të totalit të tregut.

*Aktivet e sektorit të sigurimeve** për tremujorin e parë të vitit 2012, rezultuan rreth 19.6 miliardë lekë, me një rritje të lehtë prej 234 milionë lekësh (ose 1.21%) referuar fundit të vitit 2011 dhe me 1.3 miliardë lekë (ose 7.3%) më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Peshën kryesore në totalin e aktiveve të shoqërive të sigurimit e përbën zëri "depozita, certifikata depozitash dhe llogari në banka" me rreth 42.7%.*

Treguesi që mat aftësinë e shoqërive të sigurimit për të përballuar humbjet, përfaqësohet nga raporti "kapital ndaj rezervave teknike", i cili për tremujorin e parë të vitit 2012 zbriti në nivelin 132% nga 133.8% në fund të vitit 2011 dhe 172% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rënia e treguesit ka ardhur si rezultat i rritjes më të madhe të rezervave teknike, e cila tregon edhe një pritshmëri më të madhe të ekspozimit ndaj rreziqeve gjatë kryerjes së veprimtarisë të sigurimeve në vend.

Shoqëritë e sigurimit paraqesin një nivel më të ulët të rezultatit financiar i cili në tremujorin e parë të vitit 2012 rezultoi 46.7 milionë lekë nga 331.8 milionë lekë një vit më parë. Ngadalësimi i ndjeshëm i fitimit është reflektuar edhe në treguesit e kthimit RoA dhe RoE, të cilët ranë respektivisht në nivelet 0.25% dhe 0.44%, nga 1.9% dhe 3.4% që shënonin një vit më parë.

Në tremujorin e parë të vitit 2012, një ecuri pozitive shfaqi aktiviteti i shoqërive të pensioneve private suplementare, aktivet e të cilave u ngjitën në nivelin 194.8 milionë lekë nga rreth 154.7 milionë lekë që rezultonin në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Numri i shoqërive administruese të fondeve private të pensioneve vijon të jetë 3.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, ka nisur veprimtarinë fondi i investimit "Raiffeisen Prestige", i cili u licencua në fund të vitit 2011. Në fund të periudhës, ky fond investimi kishte një vlerë aktivesh prej 11.4 miliardë lekësh, duke përbërë 0.92% të totalit të aktiveve të sistemit financiar në tërësi.

* *Mbështetur në publikimin statistikor "Mbi tregun e sigurimeve janar-qershor 2012", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF).*

** *Sipas raportimit më të fundit të bilancit të shoqërive të sigurimit pranë Bankës së Shqipërisë.*

6. SEKTORI BANKAR

6.1 ECURIA E AKTIV-PASIVEVE DHE PËRBËRJA E TYRE

Totali i aktiveve të sektorit bankar përbën rreth 82% të PBB-së së vendit. Në gjysmën e parë të vitit 2012, aktivet e sektorit bankar u zgjeruan me rreth 3.4% krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe me rreth 11% ndaj së njëjtës periudhë të një viti më parë. Ecuria historike e aktiveve të sektorit bankar paraqitet e luhatshme, rrjedhojë kjo e ndryshimeve në kontributin e zërave kryesorë të aktivit (grafik 6.1.1).

Grafik 6.1.1. Kontributi i zërave të aktiveve në rritjen e aktiveve, në pikë përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në ecurinë e aktiveve, shfaqet mbizotërues kontributi i aktivitetit kreditues (përfaqësuar nga "veprime me klientët"). Së fundmi, ky kontribut ka ardhur në rënie si pasojë e ngadalësimit të rritjes ekonomike dhe të një sjelljeje më të kujdesshme nga ana e bankave në akordimin e kredisë. Gjithashtu, zhvillimet që pasuan krizën financiare ndërkombëtare sollën përkeqësim të cilësisë së portofolit të kredisë duke rezultuar në rritje të nivelit të provigjoneve, të cilat kanë tkurrur ecurinë normale të aktiveve, dhe kanë ndikuar negativisht në nivelin e përfitueshmërisë së sektorit bankar. Kërkesa e lartë për financimin e borxhit sovran ka mbajtur të lartë kontributin e "Veprimeve me thesarin dhe ndërbankare" në ecurinë e aktiveve të sektorit bankar.

Në financimin e aktivitetit bankar (në pasiv të bilancit të bankës), vërehet se së fundmi kontributi në gjenerimin e fondeve ka ardhur tërësisht nga aktiviteti depozitues (përfaqësuar nga "veprime me klientët"). Ky konsiderohet si zhvillim pozitiv, i cili ndikon në qëndrueshmërinë e gjendjes së likuiditetit të sektorit bankar. Nga ana tjetër ky zhvillim evidenton nevojën për ruajtjen e vazhdueshme të besimit të publikut në sektorin bankar.

Bankat kanë stabilizuar raportin e përdorimit të kapitalit të tyre (zëri "burime të përhershme") për financimin e veprimtarisë, duke iu përshtatur njëkohësisht kërkesave për shtim kapitali nga autoriteti mbikëqyrës, në kuadër të respektimit të normave rregullative. Përdorimi i kapitalit ka qenë burim i rëndësishëm i financimit të aktivitetit bankar në periudhën e shpërthimit të krizës financiare ndërkombëtare (2008-2009), ndjekur nga

veprimet e Bankës së Shqipërisë për injektimin e likuiditetit dhe ruajtjen e stabilitetit të sistemit financiar në vend.

Grafik 6.1.2. Financimi me bazë vjetore i aktiveve të sektorit bankar, në pikë përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori bankar shqiptar mbetet i dominuar nga 5 banka. Së bashku këto banka përfaqësojnë rreth 68% të huadhënies dhe 75% të depozitave të publikut. Kjo nënkupton që këto banka luajnë një rol të rëndësishëm në kreditimin e ekonomisë dhe një funksion të rëndësishëm në ecurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit financiar shqiptar.

6.2 POZICIONI I SEKTORIT BANKAR NDAJ JOREZIDENTËVE

Investimet e sektorit bankar në mjete të subjekteve jorezidente janë zgjeruar, ku evidentohet rritje e vendosjeve në formën e llogarive rrjedhëse dhe depozitave. Njëkohësisht, përdorimet e linjave të kreditit me grupin bankar zotërues kanë shënuar rënie. Këto zhvillime tregojnë për një situatë të përmirësuar të likuiditetit në sektorin bankar për periudhën e analizuar.

Investimet e sektorit bankar në mjete të subjekteve jorezidente rezultuan 214.5 miliardë lekë, në rritje me rreth 17% krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe rreth 66% në terma vjetorë. Vendosjet e sektorit bankar pranë institucioneve jorezidente u rritën me 25% në terma gjashtëmujorë dhe 77% në terma vjetorë, kryesisht si rezultat i rritjes së llogarive rrjedhëse dhe depozitave. Në përgjithësi, aktivet me jorezidentët përbëjnë 18.5% të totalit të aktiveve, duke shfaqur rritje krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe me një vit më parë.

Përsa i përket detyrimeve të sektorit bankar ndaj jorezidentëve ato u vlerësuan në masën 79.8 miliardë lekë, duke përbërë 6.8% të totalit të detyrimeve. Në këto detyrime, pjesën dërrmuese e zënë detyrimet ndaj grupeve bankare zotëruese.

Vlera e linjave të kreditit të përfituara nga grupet bankare zotëruese ka shënuar rënie, dhe kjo pirje është shfaqur edhe në ecurinë e pjesës së përdorur dhe të papërdorur të linjave të kreditit.

Grafik 6.2.1. Pozicioni i sektorit bankar ndaj jorezidentëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 6.1. Angazhimet e marra nga bankat mëma dhe bankat e tjera të grupit.

Mln lek	Totali i linjës	Pjesa e përdorur	Pjesa e papërdorur
Qershor 2012	55,510.84	13,750.17	41,760.67
Dhjetor 2011	63,422.40	16,903.90	46,518.50
Qershor 2011	65,582.53	19,504.29	46,078.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Nga analiza e mësipërme, ku evidentohet që aktivet e sektorit bankar ndaj jorezidentëve janë pothuaj tre herë më të larta se detyrimet ndaj jorezidentëve, vlerësohet se varësia e sektorit bankar në vend nga grupet bankare zotëruese është e ulët. Megjithatë, në banka të veçanta kjo varësi është më e ndjeshme dhe kërkon një monitorim të kujdesshëm. Nga ana tjetër, bankat evropiane, të cilat zotërojnë disa nga bankat që operojnë në vend, janë ndikuar ndjeshëm nga kriza financiare ndërkombëtare. Përçimi i problemeve të tyre tek bankat që operojnë në vend përfaqëson një kanal të mundshëm rreziku. Është e nevojshme që bankat të llogarisin përmasat e këtij rreziku dhe të vlerësojnë qëndrueshmërinë e tyre, duke ndërtuar skenarë që i përgjigjen realitetit të zhvillimeve financiare ndërkombëtare.

Hapësirë informuese 6.2. Ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët.

Pesha ndaj totalit të aktivit. Në fund të muajit qershor 2012, pretendimet totale ndaj jorezidentëve zinin 10.8% të totalit të aktiveve dhe ato ndaj grupeve bankare zotëruese zinin 3.4% të tyre. Ndërkohë, detyrimet ndaj jorezidentëve zinin 1.7% të pasiveve dhe ato ndaj grupeve bankare zotëruese zinin 1.4% të tyre.*

Ecuria në kohë. Totali i pretendimeve ndaj institucioneve jorezidente ka shfaqur rritje në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, si edhe në krahasim me fundin e vitit 2011. Pretendimet totale thuajse janë dyfishuar në raport me një vit më parë dhe kanë pasur një rritje prej 27.9% në krahasim me fundin e vitit. Të njëjtën prirje kanë pasur edhe pretendimet ndaj grupeve bankare zotëruese të bankave që operojnë në vendin tonë, ku në vlerë absolute këto pretendime thuajse janë trefishuar, ndërkohë që në raport me fundin e vitit kanë pasur një rritje prej 21.1%. Në fund të muajit qershor 2012, pretendimet ndaj grupeve bankare zotëruese në raport me totalin e pretendimeve ndaj jorezidentëve të sektorit bankar zinin 31.8%. Në anën e pasivit, vërehet një rënie e detyrimeve totale të sektorit tonë bankar ndaj institucioneve të tilla, duke shënuar një rënie me 22.6% në raport me qershorin e vitit 2011 dhe me 19.8% në krahasim me fundvitin 2011.

Grafik 6.2.2. Ekspozimi i sektorit bankar me jorezidentët.



Burimi: Të dhënat operative të bankave, përpunim nga Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Pozicioni neto i ekspozimit ndaj jorezidentëve. Sektori bankar paraqitet me një pozicion neto pozitiv ndaj jorezidentëve. Ky pozicion është rritur ndjeshëm në krahasim me një vit më parë, dhe për rastin e marrëdhënies me grupet bankare zotëruese ka kaluar nga vlera negative në vlera pozitive.

Struktura e maturimit të ekspozimeve me afat. Pjesa kryesore e pretendimeve ndaj jorezidentëve maturohet në një afat të shkurtër kohor. Në fund të muajit qershor 2012, pretendimet të cilat maturohen deri në 1 muaj zinin 81.6% të pretendimeve me afat, ndërkohë që detyrimet të cilat maturohen në këtë hark kohor zinin 11.4% të detyrimeve me afat. Peshën më të madhe të detyrimeve e zënë detyrimet të cilat maturohen në më tepër se 6 muaj, me 88.6% të totalit.

Përbërja sipas monedhave.: Në qershor 2012, pretendimet ndaj jorezidentëve paraqiten kryesisht në euro në masën 78.6%, ndërsa pjesa në euro e pretendimeve ndaj grupeve bankare zotëruese është më e lartë, në masën 87.7%. Në anën e detyrimeve ndaj jorezidentëve paraqitet një situatë e ngjashme, ku kryesisht monedha më e përdorur është ajo evropiane për 98.5% të totalit dhe për 98.25% të detyrimeve ndaj grupeve bankare zotëruese.

Përbërja e ekspozimit sipas origjinës së kapitalit të bankave. Në totalin e pretendimeve ndaj jorezidentëve, ato të grupit grek zënë 18% të totalit, ato të grupit italian zënë 14.4%, ato të grupit francez zënë 8.2% dhe ato të grupit shqiptar zënë 4.5%. Pretendimet totale ndaj jorezidentëve paraqiten më të larta se në fundin e vitit 2011 për grupin grek, italian dhe francez, dhe më të ulëta për grupin shqiptar. Pretendimet ndaj grupeve bankare zotëruese janë paraqitur të luhatshme dhe në krahasim me fundin e vitit 2011, ato kanë ardhur në rritje për grupin italian dhe atë francez, por kanë shënuar rënie të theksuar për grupin grek. Në fund të muajit qershor 2012, peshën më të lartë ndaj totalit të detyrimeve ndaj jorezidentëve e shfaq grupi francez me 57.6%, pasuar nga ai grek me 26% dhe ai italian me 10.5%. Ritme të ngjashme paraqiten edhe për detyrimet ndaj grupeve bankare zotëruese, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve totale ndaj jorezidentëve janë detyrime ndaj grupeve bankare zotëruese. Pozicioni neto i ekspozimit paraqitet negativ për grupin francez, ndonëse përmasat e tij janë zvogëluar ndjeshëm. Grupi italian dhe grupi grek shfaqen me një pozicion pozitiv dhe në rritje, ndonëse grupi grek ka shfaqur një luhatshmëri më të lartë.

* *Kjo hapësirë informuese është bazuar në të dhënat operative të raportuara nga sektori ynë bankar mbi marrëdhëniet me jorezidentët.*

6.3 TEPRICA E KREDISË

Në fund të periudhës, pesha e portofolit të kredisë ndaj PBB-së vlerësohet 43.5%. Teprica e kredisë ka vijuar ritmet e ngadalta të rritjes, si rrjedhojë e kërkesës së dobët për kredi dhe e shtrëngimit të kushteve të kredidhënies.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, teprica e kredisë u ngjit në nivelin 571.9 miliardë lekë duke u rritur gjatë periudhës me vetëm 5.7 miliardë lekë ose 1%. Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011, teprica e kredisë u rrit me 42.7 miliardë lekë ose 8.2%. Në terma vjetorë, në fund të qershorit 2012, rritja e kredisë rezulton të jetë 9.3%.

Gjatë periudhës, sipas subjekteve kredimarrëse, rritja më e shpejtë evidentohet në kredinë akorduar ndërmarrjeve publike, në raport me ato private, ndërkohë që kredia dhënë individëve ka pësuar rënie. Më konkretisht, kredia ndaj sektorit publik u rrit me 1.5 miliardë lekë ose 7.4%, duke vijuar me prirjen rritëse të një gjashtëmujori më parë kur rritja e kredisë shënonte 4.8 miliardë lekë ose 30.8%. Kredia ndaj sektorit privat është rritur me 5.2 miliardë lekë ose me 1.3%, shumë më e ulët se një gjashtëmujor më parë kur rritja e kredisë shënonte 43.3 miliardë lekë ose 12.2%. Kredia për individët, ka rënë me rreth 1 miliard lekë ose 0.7%, duke vijuar prirjen e një gjashtëmujori më parë kur ra me 5.3 miliardë lekë ose me 3.4%. Ky ngadalësim i ecurisë së kredisë reflekton një kërkesë më të dobët për kredi për shkak të pasigurisë së bizneseve dhe familjeve mbi ecurinë e ekonomisë dhe shtrëngimin e standardeve të kredidhënies nga bankat pas përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë.

Grafik. 6.3.1. Ecuria vjetore e kredisë për subjektet individë dhe biznese, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.3.2. Ecuria e kredisë për subjektet private dhe sektorët me kontributin në rritje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas monedhës, gjatë periudhës kredia në valutë ka pësuar rënie, ndërsa kredia në lekë është rritur me ritme të qëndrueshme. Më konkretisht, kredia e dhënë në lekë është rritur me 6.4 miliardë lekë ose me 3.5%, ndërkohë që kredia në valutë ka rënë me 0.7 miliardë lekë ose me 0.2%. Në gjysmën e dytë të vitit 2011, rritja e kredisë në lekë ishte 18.3 miliardë lekë ose 11.2% dhe rritja e kredisë në valutë ishte 24.5 miliardë lekë ose 6.8%.

Sipas afatit të maturimit, në rritjen e kredisë gjatë periudhës ka kontribuar pozitivisht kredia afatshkurtër me rreth 4.0 miliardë lekë (e rritur me 2.0%) dhe ajo afatgjatë me rreth 6.8 miliardë lekë (e rritur me 2.7%). Nga ana tjetër, kredia afatmesme ka pësuar rënie me 5.0 miliardë lekë ose 4.4%.

Sipas sektorëve të ekonomisë, kredia është dhënë kryesisht për tregtinë, ndërtimin, industrinë dhe prodhimin e energjisë elektrike, ndërkohë që kredia për sektorët e tjerë ka rezultuar me rritje modeste. Në terma relativë, gjatë periudhës evidentohet rritje për sektorin e arsimit me rreth 22%, industrinë nxjerrëse me rreth 22% si dhe hotelerinë me rreth 12.3% si pasojë e efektit sezonal. Gjatë periudhës, kredia për sektorin e bujqësisë u tkurr me 0.7 miliardë lekë ose 11.8%.

Grafik 6.3.3. Shpërndarja e tepricës së kredisë për biznesin dhe individët sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas qëllimit të përdorimit, kredia për bizneset është orientuar kryesisht për blerje pajisjesh. Kredia në formën "Overdraft" vijon të mbizotërojë në përdorim dhe pesha e saj në total mbetet mbi mesataren 5-vjeçare, ndonëse shfaq një prirje të lehtë rënëse. Tek individët nuk vërehet ndonjë ndryshim strukturor në përdorimin e kredisë, ku kredia për pasuri të paluajtshme mban peshën më të madhe.

Hapësirë informuese 6.3.1. Kredia e re.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, sektori bankar dha kredi të re në masën 126.3 miliardë lekë, duke shënuar një rënie të konsiderueshme prej 25.2 miliardë lekësh ose 16.7% krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe me vetëm 3.5 miliardë lekë ose 2.7% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Për të njëjtën periudhë, sektori bankar mblodhi kredi në masën 119.5 miliardë lekë, nga rreth 116.6 miliardë lekë që shënonte në fund të dhjetorit 2011 dhe 103.2 miliardë lekë të mbledhura gjatë të njëjtës periudhë një vit më parë. Raporti i kredisë së mbledhur me kredinë e dhënë përfaqëson treguesin e përdorimit të kredisë. Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, ky raport u llogarit në nivelin 94.6% nga 77% në fund të gjashtëmujorit të dytë 2011 dhe 79.5% referuar gjashtëmujorit të parë 2011, si rezultat i ritmit më të ulët të rritjes së kredisë së re krahasuar me kredinë e mbledhur.

Sipas grupeve të përdoruesve, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, sektori i biznesit ka përfituar rreth 109.9 miliardë lekë ose rreth 87.04% të kredisë së re, ndërkohë që sektori i individëve përfitoi rreth 16.4 miliardë lekë ose rreth 13% të totalit të kredisë së re. Grafiku 6.3.4 paraqet ecurinë e kredisë së re dhe treguesin e përdorimit të kredisë me bazë gjashtëmujore.

Grafik 6.3.4. Kredia e re dhe përdorimi i kredisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.3.5. Shpërndarja e peshave të kredisë së re për sektorin e biznesit dhe për individët sipas qëllimit të përdorimit, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e kredisë së re për sektorin e biznesit sipas qëllimit të përdorimit, tregon se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, kredia e re është zhvendosur drejt financimit të "kapitalit qarkullues". Për sektorin e individëve vihet re një ritëm më i lartë i zgjerimit të kredisë së re për "konsum të mallrave të qëndrueshme", ndërkohë që kredia e re "për ushtrim aktiviteti" është zgjeruar më ngadalë.

Shpërndarja sipas monedhave, evidenton rritjen e kredisë së re në monedhën vendase dhe në dollarë amerikanë me 0.6% dhe 44%, në nivelet 51.2 miliardë lekë dhe 18.5 miliardë lekë. Ndërkohë, shënohet rënie e konsiderueshme e kredisë së re akorduar në monedhën evropiane me 14.3%, duke zbritur në 56.6 miliardë lekë. Kjo tendencë mund të jetë rrjedhojë e zhvillimeve ndërkombëtare, ku monedha euro ka shfaqur paqëndrueshmëri krahasuar me monedhat e tjera. Nevojitet një periudhë më e gjatë kohe për të vlerësuar qëndrueshmërinë e kësaj pirjeje dhe arsyet e pasojat e saj.

Grafik 6.3.6. Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Shpërndarja e kredisë së re sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë paraqitet në grafikun 6.3.6. Vihen re dy zhvillime kryesore. Së pari, është rritur pesha e kredisë së re dhënë sektorit të "tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë" në rreth 38.8%, nga 32.5% në fund të muajit qershor 2011. Së dyti, ka rënë pesha e kredisë së re për sektorin e "industrisë përpunuese" në 9.1% nga 12.3% që ishte një vit më parë.

ECURIA E NORMAVE TË INTERESIT PËR KREDITË E REJA

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, vërehet një pirje e lehtë rënëse në normat e interesit të kredisë së re për të tre monedhat kryesore (lekë, usd dhe euro) që operojnë në treg. Interesat për kreditë e reja në lekë, kanë shfaqur luhatje të papërfillshme. Norma mesatare e interesit për këto kredi rezultoi 11.41% ose 0.06 pikë përqindje më e ulët se një gjashtëmujor më parë. Në sektorin e biznesit vërehen kushte më pak të favorshme për kredinë e re dhënë në formën "overdraft", pasi norma mesatare e interesit për këtë kategori është rritur me rreth 0.45 pikë përqindje, në nivelin 10.89%. Më të favorshme janë paraqitur kushtet për kredinë e re në lekë dhënë sektorit "individë", ku norma mesatare e interesit të kredisë së re dhënë për ushtrim aktiviteti ka rënë me 0.7 pikë përqindje në nivelin 16.38%.

Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit për kredinë e dhënë në usd zbriti në 6.88%, rreth 1.01 pikë përqindje më e ulët se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2011. Ky fakt ka qenë favorizues për kredinë e re dhënë në formën "overdraft", pasi norma mesatare e interesit zbriti me rreth 2.11 pikë përqindje, në nivelin 6.31%. Prirja në rënie e normës së interesit për kredinë e re në usd, mund të ketë ndikuar në rritjen e kërkesës për këtë kredi. Edhe norma mesatare e interesit për kreditë në euro për të njëjtën periudhë është ulur me rreth 0.25 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin 7.25%. Në këtë rënie mund të ketë ndikuar ecuria e normave mesatare të Euriborit në tregjet ndërkombëtare që zbritën me rreth 0.6 pikë përqindje gjatë periudhës.

Grafik 6.3.7. Ecuria e normave të interesave për kreditë e reja në lekë dhe valutë.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Hapësirë informuese 6.3.2. Lidhja midis kredisë së re nga njëra anë, dhe cilësisë së portofolit dhe normave të interesit nga ana tjetër.

LIDHJA MIDIS KREDISË SË RE DHE CILËSISË SË PORTOFOLIT

Në fund të tremujorit të dytë 2012, ecuria e kredisë së re reflektoi prirjen e bankave për të mbështetur bizneset me kreditim, ndërkohë që kredia për individët është tkurrur. Në totalin e kredisë së re për bizneset, 37.3% e totalit është disbursuar për sektorin e tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë, ndërkohë që sektori i ndërtimit përbën 16.3% dhe sektori i industrisë përpunuese 6.7%. Nga ana tjetër, cilësia e portofolit të kredisë së bizneseve është përkeqësuar më shumë se cilësia e portofolit të kredisë së individëve. Sipas sektorëve, raporti i kredive me probleme është 25.5% për sektorin e tregtisë, riparimit të automjeteve dhe artikujve shtëpiakë, 29.6% për sektorin e ndërtimit dhe 23.1% për industrinë përpunuese. Raporti i kredive me probleme për individët shënon 16.9% (pa përfshirë jorezidentët). Për të gjykuar nëse bankat kanë reaguar ndaj përkeqësimit të cilësisë së portofolit nëpërmjet uljes së kredisë së re për secilin sektor, bizneset dhe individët, është ndërtuar korrelacioni i ndryshueshëm në kohë që lidh pikërisht kredinë e re me raportin e kredive me probleme. Ecuria e korrelacionit për çdo sektor paraqitet në grafikët në vijim.

Indeksi i korrelacionit për totalin tregon se pas një niveli të lartë të tij në fillim të vitit 2009, indeksi është zvogëluar gradualisht duke reflektuar tendencën e bankave për të ngushtuar kredinë e re në kushtet e përkeqësimit të cilësisë së portofolit. Ndërkohë, pas shtatorit të vitit 2011 korrelacioni është rritur duke ndjekur kryesisht zhvillimet në treguesin e korrelacionit për bizneset, rritja e të cilit ka reflektuar rritjen e kredisë së re për ristrukturim. Gjatë dy muajve maj-qershor 2012, korrelacioni është ulur duke reflektuar tendencën e bankave për të ngadalësuar kreditimin e bizneseve. Ndërkohë për sektorët e veçantë, koeficienti i korrelacionit është pozitiv dhe i lartë për sektorin e prodhimit, shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit dhe të ujit, dhe të bujqësisë. Sektori i ndërtimit reflekton një indeks negativ korrelacioni midis ecurisë së kredisë së re dhe cilësisë së tij të portofolit për të gjithë periudhën e paskrizës.

Grafik 6.3.8. Indeksi i korrelacionit midis kredisë së re dhe raportit të kredive me probleme, sipas sektorëve.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Nga ana tjetër, korrelacioni i kredisë së re dhe cilësisë së portofolit për individët në periudhën e paskrizës është negativ. Ky zhvillim reflekton reagimin e shpejtë të bankave në uljen e kredisë së re për individët në kushtet e përkeqësimit të cilësisë së kredisë por edhe të zhvendosjes së kreditimit për ristrukturim të bizneseve. Tendenca e fortë në rënie e koeficientëve të korrelacionit tregon se në kushtet e një reagimi të fortë të bankave gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, kredia e re për individët është ngadalësuar në mënyrë të ndjeshme.

LIDHJA MIDIS KREDISË SË RE DHE NORMËS SË INTERESIT

Lidhja që ekziston midis kredisë së re sipas sektorëve të ekonomisë dhe normës përkatëse të interesit vlerësohet nëpërmjet analizës së ecurisë së korrelacionit përkatës. Për sektorin e bizneseve, vlerësohet se koeficienti i korrelacionit është negativ për të gjithë periudhën duke reflektuar lidhjen e zhdrejtë që ekziston midis kredisë së re dhe normës së interesit. Gjithsesi, pirja në rritje e këtij korrelacioni pas qershorit 2011 për kredinë e re për kapital qarkullues dhe investime për pasuri të paluajtshme, reflekton tendencën e bankave për të ngadalësuar kreditimin për këto qëllime dhe rritjen e normave përkatëse të interesit. Tendenca në rënie e korrelacionit për kredinë overdraft reflekton pirjen e bankave për ngadalësim të

Grafik 6.3.9 Indeksi i korrelacionit midis kredisë së re dhe normës së interesit sipas qëllimit të përdorimit.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

kreditimit në formë overdraft-i por edhe të kostos së tij. Ndërkohë edhe kreditimi për investime në blerje pajisjesh është ngadalësuar, por norma e tij e interesit vijon të mbetet në rritje.

Përsa i përket individëve, korrelacioni pozitiv midis kredisë së re dhe normës së interesit për konsum të mallrave të qëndrueshme dhe jo të qëndrueshme para vitit 2010 pasqyron tendencën në rritje të kredisë për këtë qëllim shoqëruar nga norma më të larta interesi. Ndërkohë, korrelacioni për të gjitha kategoritë e tjera të kredisë është negativ.

Gjatë fillimit të vitit 2012, vërehet një rritje e korrelacionit për të gjitha kategoritë me përjashtim të mallrave të qëndrueshme për shkak të uljes së kredisë së re për këtë qëllim por edhe të normave përkatëse të interesit. Përjashtim bën kredia e re dhënë individëve për pasuri të paluajtshme, që gjatë muajve maj-qershor 2012 ka një rritje të lehtë por me një kosto më të lartë. Kjo tendencë e fortë e ngadalësimit të kredisë së re për individët është reflektuar në një rritje të shpejtë të korrelacionit total të tyre krahasuar me një tendencë më të zbutur për bizneset dhe kredinë në total.

6.4 ECURIA E DEPOZITAVE

Depozitat e sektorit bankar kanë vijuar të rriten gjatë periudhës, por me ritme më të ulëta se në periudhën paraardhëse.

Depozitat vijojnë të mbeten të përqendruara në bankat më të mëdha të sektorit bankar dhe shkalla e përqendrimit të tyre shënon rritje në terma vjetorë. Totali i depozitave, në gjysmën e parë të vitit 2012, ka shënuar rritje me 4% në krahasim me muajin dhjetor 2011 dhe me 12.2% krahasuar me një vit më parë.

Gjatë periudhës, në strukturën e depozitave vërehet një rënie e vlerës së depozitave me afat maturimi 6-12 muaj për rreth 28%, dhe një zhvendosje drejt depozitave me afat më të shkurtër. Kjo ecuri mund të reflektojë një nevojë më të lartë për likuiditet nga ana e publikut (tërheqjen e kursimeve në një periudhë afatshkurtër), si rrjedhojë e pritshmërive për një ecuri ekonomike më të ngadaltë në vend. Për bankat, kjo ecuri rrit nevojën për monitorimin e kujdesshëm të madhësisë dhe ecurisë së aktiveve likuide.

Lidhur me strukturën e depozitave sipas monedhës, vërehet se në qershor të vitit 2012, depozitat në lekë dhe ato në valutë zënë thuajse të njëjtën peshë në totalin e depozitave, secila me vlerë rreth 480 miliardë lekë. Një vit më parë depozitat në lekë zinin 48% të totalit të depozitave.

Grafik 6.4.1. Norma e rritjes së depozitave, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.4.2. Struktura e depozitave të sektorit bankar sipas maturimit.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 6.4.1. Depozitat e reja me afat.

Grafik 6.4.3. Ecuria e depozitave të reja.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 6.4.4. Normat e interesit për depozitat e reja me afat, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Ecuria e depozitave të reja me afat në monedhën vendase ka treguar rënie gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012. Gjatë kësaj periudhe u pranuan 250 miliardë lekë depozita të reja me afat në lekë ose rreth 23.3% më pak se në gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Kjo rënie ka ardhur në një kohë kur norma mesatare e interesit për depozitat në lekë ka pësuar ulje në 4.5%, nga 4.8%. Për sa i takon strukturës së maturimit të depozitave të reja në lekë, gjatë periudhës vërehet rënie me rreth 3.8 pikë përqindje në peshën e depozitave të reja me afat maturimi 3 muaj, në nivelin 19.3%, dhe rritje e peshës së depozitave të reja me afat maturimi 12 muaj me rreth 10.1 pikë përqindje, në nivelin 36.2%.

Depozitat e reja me afat në usd të pranuara nga sektori bankar, në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012 ishin 363.6 milionë usd, rreth 23.6% më pak se një vit më parë. Struktura e depozitave ka shfaqur një rritje me 6.8 pikë përqindje të peshës së depozitave me afat 12 muaj dhe një rënie me 9 pikë përqindje të peshës së depozitave me afat maturimi 1 muaj. Gjatë periudhës, norma mesatare e interesit për depozitat e reja në usd, ka qenë 1.6%, krahasuar me 1.2% në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Depozitat e reja me afat në euro të pranuara nga sektori bankar ishin 1.68 miliardë euro, duke rënë me 31.6% në krahasim me gjashtëmujorin e parë të vitit 2011. Kjo normë rënieje është reflektuar pavarësisht rritjes me rreth 0.3 pikë përqindje të normës mesatare të interesit në krahasim me një vit më parë, nga 2.2 në 2.5%. Në lidhje me strukturën e maturimit të depozitave të reja në monedhën evropiane, vërehet rritje e peshës të depozitave me afat maturimi 12 muaj me 13.3 pikë përqindje, në nivelin 26.6%, ndërsa pesha e depozitave me afat maturimi 1 muaj ka rënë me 21.3 pikë përqindje, duke zbritur në nivelin 34.9%.

6.5 KAPITALIZIMI I VEPRIMTARISË

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit[21] shënoi vlerën 15.66%, krahasuar me 15.56% në fund të vitit 2011 dhe 14.6% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ecuria e këtij treguesi jepet në grafikun 6.5.1.

Grafik 6.5.1. Ecuria e normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, në përqindje.



Burimi:Banka e Shqipërisë.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, kapitali rregullator i sektorit bankar rezultoi 100.2 miliardë lekë ose 1.7% më i lartë se në fund të vitit 2011. Aktivet dhe zërat jashtë bilancit të ponderuara me koeficientët e rrezikut shënuan një rritje me rreth 6.9 miliardë lekë (ose 1.1%) krahasuar me fundin e vitit 2011, në nivelin 639.6 miliardë lekë.

Në vijim paraqiten në mënyrë të përmbledhur vlerat e treguesit të mjaftueshmërisë së kapitalit, për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit dhe origjinës së kapitalit.

Tabelë 6.5.1. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit.

	Sektori	Grupi 1	Grupi 2	Grupi 3	Italian	Francez	Grek	Shqiptar
Qershor 2012	15.66	28.5	13.4	15.8	20.2	13.3	15.2	14.6
Dhjetor 2011	15.56	27.9	14.1	15.5	20.2	12.5	16.6	13.9
Qershor 2011	14.64	30	13.5	14.3	18.7	13.3	13.3	12.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Niveli i kapitalizimit për tërësinë e sektorit bankar tejkalon normën minimale të kërkuar, ndërkohë që bankat e Grupit 2 evidentojnë vlerën më të ulët të treguesit prej 13.4%. Sipas origjinës së kapitalit, nivelet më të larta të normës së mjaftueshmërisë së kapitalit e shfaqin bankat me kapital italian dhe ato me kapital grek.

Kapitali i aksionerëve, në fund të muajit qershor 2012, ishte 99.4 miliardë lekë, në rritje me rreth 2 miliardë lekë (ose 2.1%) kundrejt fundit të vitit 2011. Kapitali i paguar përbën zërin kryesor të kapitalit të aksionerëve të sektorit bankar, duke zënë 90% të tij. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, kapitali i paguar kishte vlerën 89.6 miliardë lekë, rreth 6.8 miliardë lekë ose 8.3% më shumë se në fund të vitit 2011, duke evidentuar rritjen e kapitalit nga disa banka.

[21] *Raporti i kapitalit rregullator ndaj totalit të aktiveve të ponderuara me rrezikun.*

6.6 REZULTATI FINANCIAR DHE EFICIENCA E BURIMEVE

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2012, aktivet mesatare që sjellin të ardhura u ngjitën në nivelin 977.5 miliardë lekë, duke përfaqësuar rreth 90.7% të vlerës së përgjithshme të aktiveve mesatare të sektorit bankar. Ky tregues shënoi rritje me 38.5 miliardë lekë ose 4.1% kundrejt muajit dhjetor 2011 dhe me 58.3 miliardë ose 6.3% kundrejt një viti më parë. Raporti "Pasive mesatare që shkaktojnë shpenzime/Aktive mesatare që sjellin të ardhura" është në nivelin 99.7%, rreth 5.4 pikë përqindje më i lartë se në fund të muajit dhjetor 2011, dhe 6.3 pikë përqindje më i lartë se një vit më parë.

Të ardhurat neto të veprimtarisë[22] së sektorit bankar, rezultojnë 17.3 miliardë lekë ose 21.6% më të ulëta se në të njëjtën periudhë të një viti më parë, dhe përfaqësohen totalisht nga të ardhurat neto nga interesat (të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera kanë vlerë negative). Kostot operative[23] të veprimtarisë shënojnë vlerën 12.3 miliardë lekë ose 5.2% më të larta se një vit më parë. Si rezultat, raporti i kostove operative ndaj të ardhurave neto rezulton në nivelin 71% nga 52.9% për të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Raporti i shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarisë[24] ndaj të ardhurave arriti në 82.7%, krahasuar me 93% në muajin qershor 2011, rrjedhojë e rënies së shpenzimeve për provigjone me rreth 6.8 miliardë lekë.

Grafik 6.6.1. Ecuria e kthimit nga kapitali (RoE) dhe aktiveve (RoA), në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, rezultati neto është pozitiv në masën 2.36 miliardë lekë, i dyfishuar kundrejt së njëjtës periudhë të një viti më parë. Vlen të theksohet fakti se rezultati neto nga interesat është thuajse i pandryshuar, dhe ai nga veprimtaritë e tjera në rënie. Rritja e rezultatit neto vjen kryesisht nga rënia e konsiderueshme e shpenzimeve për provigjone. Gjithashtu, fitimi i sektorit bankar vazhdon të mbetet i përqendruar në bankat më të mëdha.

Kthimi mbi aktivet (RoA), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 0.42% nga 0.22% për të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kthimi mbi kapitalin (RoE), i kthyer në bazë vjetore, ka rezultuar 4.8%. Në fund të muajit qershor 2011, ky tregues ishte 2.4%.

[22] *Të ardhurat neto nga interesat plus të ardhurat e tjera neto.*
[23] *Pa përfshirë shpenzimet për provigjone.*
[24] *Kosto oprerative plus shpenzime për provigjone dhe rezerva të tjera.*

Grafik 6.6.2. Kthimi nga kapitali dhe aktivet për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Hapësirë informuese 6.6. Faktorët që ndikojnë kthimin nga kapitali (ROE).

Kthimi nga kapitali ROE, i përllogaritur si rezultati neto në raport me kapitalin, është gjerësisht i përdorur në matjen e përfitueshmërisë së bankës. Një rritje e ROE-s është përgjithësisht një zhvillim pozitiv, megjithatë duhet interpretuar me kujdes pasi mund të reflektojë ndryshime në faktorë të tjerë të ndryshëm nga përfitueshmëria, siç mund të jetë për shembull rritja e aktiviteteve me rrezik për bankën. Në këtë kuptim, një rritje e ROE-s jodetyrimisht reflekton një përmirësim të fortësisë financiare të sistemit.

*Një mënyrë e zbërthimit të ROE-s, është ndarja e këtij treguesi në katër faktorë: marzhi i fitimit, të ardhurat e rregulluara me rrezikun, niveli i rrezikut dhe leva financiare (Tabela 6.6.1).**

$$ROE \frac{\text{Rezultati neto}}{\text{Të ardhura nga veprimtaria}} \times \frac{\text{Të ardhura nga veprimtaria}}{\text{Aktive të ponderuara me rrezikun}} \times \frac{\text{Aktive të ponderuara me rrezikun}}{\text{Aktive totale}} \times \frac{\text{Aktive totale}}{\text{Kapitali}}$$

*Tabelë 6.6.1. Zbërthimi i ROE**.*

Faktori	Përshkrimi dhe implikimi në stabilitetin financiar
Marzhi i fitimit	Mat diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve Efekti i rritjes: pozitiv
Të ardhurat e rregulluara nga rreziqet	Vlerëson nivelin e të ardhurave duke e skontuar me nivelin e rreziqeve Efekti i rritjes: pozitiv
Niveli i rrezikut	Mat pirjen për rreziqe (i referohet nivelit të rrezikut të kredisë së një banke) Efekti i rritjes: negativ
Leva financiare	Mat ndikimin e borxhit Efekti i rritjes: negativ

Sipas renditjes së mësipërme, një rritje e ROE-s si pasojë e një marzhi fitimi më të lartë (fitimi/të ardhurat nga veprimtaria kryesore) pranohet se redukton paqartësinë financiare të një banke, pasi reflekton një diferencë më të madhe mes të ardhurave dhe shpenzimeve. Një rritje në të ardhurat e rregulluara me rrezikun (të ardhurat nga veprimtaria kryesore/aktive të ponderuara me rrezikun) gjithashtu, mund të shihet si pozitive për stabilitetin, pasi pasqyron më shumë të ardhura lidhur me aktivet me rrezik.

Një rritje e ROE-s, pasojë e levës financiare (total i aktiveve/kapitalin) nga ana tjetër, mund të pasqyrojë një humbje të fortësisë financiare, pasi nënkupton një rritje të borxhit dhe/ose zvogëlim të kapitalit dhe për pasojë rritjen e rreziqeve për bankën. Një rritje e ekspozimit ndaj rrezikut (aktive të ponderuara me rrezikun/ totalin e aktiveve), sipas të njëjtës logjikë, mund të ketë efekt negativ në gjendjen financiare, pasi mund të nënkuptojë që banka ka ndërmarrë investime në projekte me rrezik më të lartë.

Grafik 6.6.3. Ecuria dhe përbërja (e linearizuar) e ROE-s.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Pra, për të vlerësuar nëse një ROE më e lartë nënkupton që një bankë është më rezistente ndaj goditjeve, duhet vlerësuar nëse kjo gjendje vjen kryesisht nga një marzh i mirë dhe një eficiencë më e lartë, apo nga një nivel i lartë rreziku dhe levë e lartë financiare.

Në rastin e bankave të sistemit, ndryshimet në ROE këto vitet e fundit kanë ardhur kryesisht nga luhatjet në marzhin e fitimit dhe në nivelin e rrezikut (Grafik 6.6.3). Në vitet 2008 dhe 2009, ROE ra me përkatësisht 9 dhe 7 pikë përqindje. Përveç rënies të marzhit të fitimit, vërehet zvogëlimi i efektit levë. Nga ana tjetër, trendi rënës i ROE-s (2009) u kompensua nga rritja e nivelit të rrezikut. Kjo do të thotë se rënia e ROE-s reflekton jo vetëm humbje të fortësisë financiare, por edhe një rritje të ekspozimit ndaj rreziqeve. Ndërkohë, efektshmëria e sistemit ka ardhur në rritje (të ardhurat e rregulluara me rrezikun).

Rënia e ROE-s në vitin 2011 ishte plotësisht pasojë e një marzhi të përkeqësuar fitimi që mund të shihet si një tregues i rënies së fuqisë financiare të sektorit bankar.

* *Kjo analizë është përdorur fillimisht nga Banka e Anglisë në Raportin e Stabilitetit Financiar (Dhjetor 2003).*

** *Kjo përqasje nuk merr parasysh llojin e ekspozimeve jashtë bilancit të bankës dhe si këto të fundit ndikojnë në profilin e rrezikut për bankën.*

7. MONITORIMI I RREZIQEVE NDAJ TË CILËVE EKSPOZOHET SEKTORI BANKAR

7.1 RREZIQET E TREGUT

7.1.1 RREZIKU I KURSIT TË KËMBIMIT

Ecuria e diferencës mes aktiveve në valutë dhe detyrimeve në valutë gjatë periudhës, si edhe rritja e peshës së pozicionit të hapur valutor ndaj kapitalit rregullator, tregojnë për një rritje të ndjeshmërisë së sektorit bankar ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit. Sidoqoftë, në rastin e supozimit të lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, vlerësohet se ato nuk do të kenë një ndikim të ndjeshëm në treguesit e kapitalit të sektorit bankar.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, aktivet në valutë të sektorit bankar shënuan vlerën 645.8 miliardë lekë, me një rritje prej 4.8% krahasuar me një gjashtëmujor më parë dhe 17.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit të aktiveve në fund të qershorit 2012 është përkatësisht 55.8% dhe 52.3%. Krahasuar me një vit më parë, është rritur pesha e aktiveve dhe e detyrimeve në valutë kundrejt totalit, përkatësisht me 6.23 dhe 3.9 pikë përqindje. Pavarësisht rritjes së diferencës ndërmjet aktiveve dhe pasiveve në valutë në nivelet më të larta të viteve të fundit, ajo mbetet brenda intervalit historik 0-10%.

Sektori bankar paraqet një ekspozim më të lartë ndaj rrezikut të drejtpërdrejtë të kursit të këmbimit, edhe pse kjo madhësi vlerësohet e kufizuar. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, pozicioni valutor neto në termat e kapitalit rregullator ka shënuar vlerën 6.02%, më e larta që prej muajit korrik 2010.

Grafik 7.1.1. Pesha e aktiveve dhe detyrimeve në valutë ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar, në përqindje (dhjetor '06 – qershor '12).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.1.2. Ecuria e pozicioneve valutore neto ndaj kapitalit rregullator, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sipas grupeve të bankave, bankat e grupit 2 kanë thelluar pozicionin e tyre "në shitje" gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit, ndërsa bankat e grupeve 1 dhe 3 ishin pozicionuar "në blerje".

Grafik 7.1.3. Ecuria e pozicioneve valutore neto ndaj kapitalit rregullator për grupet sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.1.4. Diferenca midis aktiveve-pasiveve sipas periudhave të riçmimit (në mln lekë).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.1.2.RREZIKU I NORMËS SË INTERESIT

Gjatë periudhës, diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve të ndjeshme ndaj normës së interesit sipas periudhave të riçmimit paraqitet negative. Për periudhën deri në 1 muaj kjo diferencë rezulton negative për rreth 0.7 miliardë lekë, për periudhën deri në 3 muaj kjo diferencë rezulton negative për rreth 71 miliardë lekë dhe për periudhën deri në 12 muaj kjo diferencë rezulton negative në masën 82 miliardë lekë.

Vlerat negative të diferencës mes aktiveve dhe pasiveve të ndjeshme ndaj normës së interesit, veçanërisht për periudhën e riçmimit mbi 3 muaj, e ekspozojnë sektorin bankar ndaj rrezikut të rritjes së normës së interesit. Megjithatë, efekti në kapitalin e sektorit bankar i rritjes së mundshme të normës së interesit vlerësohet i kufizuar në kushtet kur pesha e këtyre diferencave ndaj totalit të aktiveve të sektorit bankar është relativisht e ulët, respektivisht sipas periudhave të riçmimit 0.06%, 6.1% dhe 7.1%.

- *NDRYSHIMI MIDIS NORMAVE TË INTERESIT TË KREDIVE DHE DEPOZITAVE TË REJA*

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, diferenca midis normës mesatare të kredive dhe normës mesatare të depozitave, është ngushtuar për të tre monedhat kryesore, përkatësisht me 0.5 pikë përqindje për veprimet në lekë, 0.6 pikë përqindje për veprimet në dollarë amerikanë dhe 0.8 pikë përqindje për veprimet në euro. Për valutën, shkak kryesor për këtë ndryshim është ulja e normave mesatare të interesit për kreditë dhe rritja e normave mesatare të interesit të depozitave në euro dhe dollarë, ndërsa për lekun shkak është rënia më e lartë e normës mesatare të interesit të kredive kundrejt uljes së normës mesatare të depozitave. Vlen të theksohet fakti se *spread*-i për monedhën vendase është zgjeruar ndjeshëm në muajin qershor, si pasojë e rënies së lartë të normës së interesit për depozitat në lekë[25], por kjo nuk ka arritur të ndikojë në rënien e vlerës mesatare të *spread*-it gjatë periudhës gjashtëmujore.

Grafik 7.1.5. Ecuria e ndryshimit të normave të kredive dhe depozitave me afat, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.2 RREZIKU I KREDITIT

Gjatë periudhës, cilësia e kredisë ka vijuar rënien. Rreziku i kredisë është rreziku kryesor në aktivitetin e sektorit bankar.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, aktivet me rrezik[26] të sektorit bankar rezultuan rreth 639.7 miliardë lekë, rreth 6.9 miliardë lekë ose 1.1% më shumë se një gjashtëmujor më parë dhe 20.9 miliardë lekë ose 3.4% më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Aktualisht ato përbëjnë rreth 55.2% të totalit të aktiveve të sektorit bankar. Aktivet që konsiderohen pa rrezik (me koeficient rreziku 0%) rezultuan 457.9 miliardë lekë dhe kanë një rritje vjetore prej 18.6 miliardë lekësh ose 4.2%.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, aktivet me rrezik që ponderohen me koeficient rreziku 150%, shënuan një rritje me rreth 1.6 miliardë lekë ose 1.1% krahasuar me një gjashtëmujor më parë, duke u ngjitur në nivelin e 153.9 miliardë lekëve. Aktivet me koeficient rreziku 50% dhe

[25] *Normat e depozitave me afat në lekë kanë rënë nga 4.4% (maj 2012) në 0.8% në qershor 2012, duke sjellë zgjerim të qenësishëm të spread-it për këtë monedhë.*

[26] *Për qëllim të llogaritjes së normës së mjaftueshmërisë së kapitalit, aktivet ponderohen me një koeficient të caktuar rreziku (20%, 50%, 100% ose 150%). Në përgjithësi, aktivet me rrezik mbizotërohen nga portofoli i kredisë dhe përfshijnë edhe investimet në letrat me vlerë të borxhit e vendosjet pranë institucioneve financiare.*

Grafik 7.2.1. Ecuria e aktiveve me rrezik, indeks dhjetor 2005=100.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.2.2. Ecuria e aktiveve me rrezik sipas grupeve të bankave, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 7.2.3. Ecuria e huave me probleme, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

100%, ranë respektivisht me rreth 2.9% dhe 0.6% referuar një gjashtëmujori më parë. Ndërkohë, aktivet me rrezik të ulët (me ponderim 20%), kanë shënuar rritje me rreth 32.3 miliardë lekë ose 24% krahasuar me gjashtë muaj më parë. Edhe gjatë kësaj periudhe bankat kanë vijuar të investojnë në aktive me koeficient të ulët rreziku, duke reflektuar preferencën për vendosjet në formën e depozitave dhe të llogarive rrjedhëse, si edhe veprimet për zbatimin e kërkesave rregullative për treguesit e likuiditetit.

Sipas madhësisë së bankave, analiza tregon një raport më të ulët të aktiveve të ponderuara me koeficientët e rrezikut kundrejt totalit të aktiveve, për të gjitha grupet gjatë periudhës, si rezultat i ritmit më të lartë të rritjes së aktiveve. Peshën më të lartë të aktiveve me rrezik në totalin e aktiveve vijojnë ta kenë bankat e Grupit 2 me rreth 65.9%.

Në gjysmën e parë të vitit 2012, vlera e huave me probleme të sektorit bankar ka vijuar pirjen rritëse duke u ngjitur në nivelin 120.6 miliardë lekë, nga 106 miliardë lekë në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe 89 miliardë lekë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave u ngjit në nivelin 21.1% nga 18.8% në gjysmën e dytë të vitit 2011 dhe 17% në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Totali i provigjoneve ka ndjekur të njëjtën pirrje rritëse si huatë me probleme, duke zënë rreth 11.3% të totalit të kredisë në fund të qershorit 2012. Krahasuar me një vit më parë, rritja e provigjoneve ka rezultuar me një ritëm më të lartë (rreth 40.6%) se rritja e huave me probleme (35.6%) duke u reflektuar në një rritje të raportit të mbulimit ("provigjone/kredi me probleme"), në nivelin 53.64% (rreth 2 pikë përqindje më shumë se në qershor 2011).

Aftësia e sektorit bankar për të mbuluar me kapital kreditë me probleme ka rënë, pasi raporti "hua me probleme neto / kapital rregullator" u ngjit në fund të periudhës në nivelin 55.8%, nga 52% në fund të vitit 2011 dhe 47.4% në fund të qershorit 2011. Rritja e këtij treguesi tregon se bankat duhet të gjejnë mënyra për të fuqizuar kapitalin e tyre rregullator, për të përballuar rënien e cilësisë së kredisë dhe rritjen e provigjoneve për rrezikun e kreditit.

Grafik 7.2.4. Ecuria e provigjoneve (boshti në të majtë) dhe raportit të mbulimit të huave me probleme (boshti në të djathtë), në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Struktura e klasifikimit të kredive sipas cilësisë së tyre ka rezultuar me ndryshime të lehta në përbërjen e saj, megjithatë shfaqet një prirje rritëse e klasave më cilësi më të ulët. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, kredia në klasën "standard" ka shënuar një rënie me rreth 11 miliardë lekë ose me 2.6%, duke u zhvendosur në klasat e tjera të cilësisë më të ulët. Kështu, klasa "në ndjekje" është rritur me 2.4 miliardë lekë ose 5.8%, klasa "nënstandard" është rritur me rreth 2 miliardë lekë ose 3.7%, klasa "të dyshimta" është rritur me 6.1 miliardë lekë ose 27.5% dhe klasa "të humbura" regjistroi rritjen më të madhe në vlerë absolute me 6.3 miliardë lekë ose 19.9%. Në totalin e kredisë së klasifikuar, kredia "standarde" ka humbur peshë me rreth 2.7 pikë përqindje duke zbritur gjatë periudhës në nivelin 71.2%.

Grafik 7.2.5 . Ecuria e klasave të portofolit të kredisë, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Sektori bankar vijon të paraqitet më i ekspozuar ndaj rrezikut të kreditit në portofolin e kredisë në valutë dhe në atë për bizneset. Huatë me probleme bruto ndaj totalit të huave për të dy këto kategori u rritën përkatësisht në nivelet 22.6% dhe 23.8%, nga 19.6% dhe 20.8% të llogaritura një gjashtëmujor më parë, duke qenë mbi nivelin mesatar të kredive me probleme.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2012, një sërë sektorësh të cilët në vetvete zënë një peshë të vogël në totalin e kredisë, kanë paraqitur përkeqësime të cilësisë së kredisë. Këtë kategori e kryesojnë bizneset që operojnë në fushën e: shëndetësisë dhe veprimtarive sociale, ku raporti i kredive me probleme ndaj totalit të kredisë së dhënë në këtë fushë është rritur me 18.7 pikë përqindje; sektori i arsimit, ku raporti është rritur me 8.2 pikë përqindje; bujqësia, ku raporti është rritur me 6.5 pikë përqindje. Cilësia e portofolit të kredisë ka shënuar rënie edhe për sektorët e administrimit publik, ku raporti i kredive me probleme është rritur me 20.3 pikë përqindje, dhe të hotelerisë e restoranteve ku raporti

është rritur me 4.3 pikë përqindje. Këta dy sektorë kanë përfituar edhe një pjesë të konsiderueshme të kredisë së re gjatë periudhës. Për sektorët më përfaqësues, ecuria e cilësisë së kredisë paraqitet në grafikun 7.2.6.

Grafik 7.2.6. Cilësia e portofolit të kredisë sipas sektorëve të ekonomisë, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Teprica e kredisë në valutë ku të ardhurat e huamarrësit janë në lekë, ka pësuar rënie gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2012 për rreth 15% në nivelin 182.3 miliardë lekë, duke zbritur në 31.9% të tepricës së kredisë dhe 47.6% të tepricës së kredisë në valutë. Sipas monedhave, rreth 85% e kësaj kredie është në euro dhe rreth 16.8% është në monedhën amerikane. Në fund të periudhës, raporti "hua me probleme në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit / teprica e kredisë në valutë, ku kredimarrësi është i pambuluar nga rreziku i kursit të këmbimit" është ngjitur në nivelin 23.6%, duke u rritur me rreth 4.7 pikë përqindje krahasuar me një periudhë më parë dhe me 6.5 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas monedhës, kontributin kryesor në rritjen e treguesit, e ka dhënë kredia në usd[27]. Kjo ecuri mund të ketë qenë pasojë e nënçmimit të lekut ndaj monedhës amerikane gjatë vitit të fundit.

Mbulimi me kolateral[28] i portofolit të kredisë, shënoi rritje në nivelin 78.7% nga 76.4% në fund të vitit 2011. Për portofolin e kredisë me probleme, mbulimi me kolateral zbriti në masën 84.6%, duke shënuar rënie të lehtë nga mbulimi prej 85.2% që vlerësohej në fund të vitit 2011.

Grafikët në vijim tregojnë përbërjen e kredisë sipas llojit të kolateralit dhe ecurinë përkatëse të cilësisë së kredisë. Vërehet se kredia e kolateralizuar me "kolateral tjetër" është rritur gjatë viteve të fundit dhe cilësia e saj është përmirësuar gjatë periudhës. Një ecuri të mirë ka patur edhe kredia e pakolateralizuar, por rënia e cilësisë së saj në periudhën e fundit është shoqëruar me tkurrjen e ofertës nga bankat. Cilësia e kredive që ka si kolateral pasuritë e paluajtshme (tregtare dhe rezidenciale) është përkeqësuar gjatë periudhës.

[27] *Më konkretisht, sipas monedhave i njëjti tregues në euro, në qershor 2012 rezultoi 22.8% nga 20.3% në dhjetor 2011 dhe 17.6% në qershor 2011. Ndërsa në monedhën amerikane (usd) referuar të njëjtës periudhë, rezultoi 24.7% nga 10% në dhjetor 2011 dhe 13% në qershor 2011.*

[28] *Kolaterali në formën e pasurive të paluajtshme (rezidenciale, tregtare ose tokë), cash etj.*

Grafik 7.2.7. Ecuria e kredisë sipas llojit të kolateraleve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.3 RREZIKU I LIKUIDITETIT

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar krahasuar me fundin e vitit 2011 dhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo ecuri, ka përkuar me rritjen e vlerës së aktiveve likuide nga ana e sektorit bankar, duke përmirësuar qëndrueshmërinë e sektorit bankar ndaj rrezikut të likuiditetit.

Në fund të periudhës, afati mesatar i maturimit të mbetur për aktivet e sektorit bankar u vlerësua në 27.6 muaj, nga 28.7 muaj në fund të vitit 2011 dhe 30.1 muaj në të njëjtën periudhë të një viti më parë. I njëjti tregues për detyrimet e sektorit bankar rezultoi 11.7 muaj, nga 12.3 muaj në fund të vitit 2011 dhe 11.5 muaj në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Grafiku 7.3.1. Maturimi mesatar i mbetur i aktiveve dhe detyrimeve, në muaj.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Diferenca në maturim midis aktiveve dhe detyrimeve është ngushtuar në nivelin 15.9 muaj, nga 16.4 muaj në fund të vitit 2011 dhe 18.5 muaj në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky ngushtim ka ardhur kryesisht si rezultat i rënies së maturimit të mbetur të kredive, të cilat përbëjnë zërin kryesor të aktiveve, me rreth 1.2 muaj referuar fundit të vitit 2011, në nivelin 41.1 muaj. Përsa i përket zërit kryesor të detyrimeve, depozitat, maturimi mesatar i mbetur i tyre ka shënuar një rënie prej 0.72 muaj në nivelin 4.75 muaj nga 5.5 muaj në fund të vitit të kaluar. Kjo rënie mund të jetë një pirje e individëve

për të vendosur kursimet e tyre në depozita me afat të shkurtër (niveli i depozitave ka shënuar rritje për shportat e maturimit 1-3 muaj dhe 3-6 muaj dhe rënie për periudha më të gjata kohore). Kjo ecuri e cila mund të reflektojë preferencën e depozituesve në kushtet e rënies së normës së interesit të depozitave, duhet të monitorohet me kujdes dhe në periudhat e ardhshme pasi vijimi i saj e bën më të ndjeshëm sektorin bankar ndaj ndryshimeve në preferencat e depozituesve dhe goditjeve të ndryshme të situatës së likuiditetit.

Grafik 7.3.2. Maturimi mesatar i mbetur i depozitave dhe kredive, në muaj.



Burimi:Banka e Shqipërisë.

Treguesit "aktive likuide / detyrime afatshkurtra" dhe "aktive likuide / totali i aktiveve" shfaqen të përmirësuar kundrejt fundit të vitit 2011 dhe kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, duke treguar nivel të kënaqshëm likuiditeti të sektorit bankar.

Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2012, raporti "aktive likuide / detyrime afatshkurtra (me maturim deri në 12 muaj)" rezultoi 36%, kundrejt 33.2% në fund të muajit dhjetor 2011 dhe 30.2% në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sipas monedhave, vlera e raportit paraqitet më e lartë për lekun dhe euron dhe më e ulët për dollarin. Konkretisht, për lekun rezulton 45.4%, për euron 27.3% dhe për dollarin 19.9%. Gjatë periudhës, edhe raporti "aktive likuide / totali i aktiveve" ka shënuar rritje me 3.4 pikë përqindje, në nivelin 29%. Sipas madhësisë së aktivitetit, të tre grupet e bankave paraqesin rritje në të dy treguesit kundrejt një viti më parë. Përgjithësisht, e njëjta ecuri vlen edhe për bankat të ndara sipas origjinës së kapitalit, ku vetëm grupi francez shfaq një rënie të lehtë në treguesin "aktive

Grafik 7.3.3. Ecuria e aktiveve likuide ndaj totalit të aktiveve për sektorin bankar dhe grupet e bankave sipas madhësisë së aktivitetit, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

likuide / detyrime afatshkurtra". Në tërësi, këto dy raporte paraqiten në përmirësim dhe në përgjithësi mbi nivelet minimale të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë[29].

Grafik 7.3.4. Ecuria e aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, në përqindje.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

7.4 VLERËSIM I QËNDRUESHMËRISË SË SEKTORIT BANKAR SIPAS USHTRIMIT TË PROVËS SË REZISTENCËS[30]

Nëpërmjet provës së rezistencës ose analizës "*stress-test*" me vështrim nga e ardhmja, vlerësohet stabiliteti i sistemit financiar dhe mjaftueshmëria e kapitalit për sektorin bankar për një periudhë kohore deri në fund të vitit 2013. Prova e rezistencës vlerëson ndikimin e situatave makroekonomike në gjendjen financiare të sektorit bankar, duke përjashtuar mundësinë e rritjes së kapitalit të paguar gjatë periudhës së marrë në konsideratë. Në praktikë, situata zakonisht përkeqësohet gradualisht dhe bankat kanë kohë të marrin masat e nevojshme, duke injektuar kapital. Kjo analizë përmban tre skenarë: skenarin bazë dhe dy versione të skenarëve të rënduar.

Skenari bazë bazohet në parashikimin e treguesve ekonomikë dhe financiarë mbështetur kryesisht në ecurinë e tyre historike. Skenarët e rënduar të analizës supozojnë një situatë "të stresuar" me një probabilitet

[29] *Sipas ndryshimeve në rregulloren "Për administrimin e rrezikut të likuiditetit" miratuar me vendimin nr.71, datë 14.10.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bankat duhet të respektojnë në çdo kohë nivelin minimal të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra në masën 20% për monedhën kombëtare, 20% në monedhë të huaj dhe 25% në total.*

[30] *Theksojmë që prova e rezistencës nuk përfaqëson një mënyrë parashikimi. Në mënyrë të qëllimshme skenarët përmbajnë zhvillime negative dhe ekstreme, por me një probabilitet të ulët ndodhjeje, për të provuar rezistencën e sektorit bankar ndaj tyre. Megjithëse bankat nxiten të vlerësojnë kapacitetin e gjendjes së tyre financiare për të përballuar ndikimin e këtyre skenarëve, ato nuk duhet t'i konsiderojnë këta skenarë si ngjarje të pritshme nga ana e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen. Skenarët janë të ndryshueshëm përgjatë kohës, në varësi të zhvillimeve ekonomike dhe financiare. Nga ana tjetër, skenarët nuk marrin në konsideratë veprimet që mund të kryejnë bankat për të forcuar në vazhdimësi situatën e tyre financiare dhe qëndrueshmërinë ndaj rreziqeve.*

të ulët ndodhjeje[31], duke u mbështetur në tre goditje të mundshme në ekonominë shqiptare: a) ngadalësim i mëtejshëm i kreditimit; b) rritje e normave të interesit të tregut; dhe c) nënçmim i monedhës vendase.

Tabelë 7.4.1. Supozimet për ndërtimin e stress test-it.

	Skenari bazë		Skenarët e rënduar			
			Goditje në kredi		Goditje në kredi dhe nënçmim i kursit të këmbimit	
Vlera në terma mesatarë	2012	2013	2012	2013	2012	2013
Rritja vjetore e PBB-së në %	1.7	2.08	1.1	1.8	0.6	1.13
Rritja vjetore e normave të interesit të tregut	0.0	0.5 p.p.	0.5 pp	1 pp	0.5 pp	1 pp
Mbiçmimi i lekut kundrejt dy monedhave kryesore (EUR dhe USD) në %	0.9	0.05	0.9	0.05	-10%	-10%
Rritja vjetore e parashikuar për tepricën e kredisë në %	8.5	8.8	4.25	4.4	4.25	4.4

Burimi: Supozime të Departamentit të Stabilitetit Financiar dhe projeksione të Departamentit të Kërkimeve, Banka e Shqipërisë.

Vlerësimet për treguesin e cilësisë së portofolit të kredisë deri në fund të vitit 2013 (Grafik 7.4.2) tregojnë se probabiliteti i përballjes me vlera ekstreme (larg mesatares) të raportit të kredive me probleme është më i lartë në skenarin e rënduar krahasuar me skenarin bazë.

Grafik 7.4.2. Shpërndarja e dendurive të vlerave të raportit të kredive me probleme për tremujorin e fundit të viteve 2012 dhe 2013 të simuluara me metodën Monte Carlo sipas skenarit bazë dhe skenarit të rënduar.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Ndikimi i ecurisë së mësipërme të cilësisë së portofolit të kredisë të portofolit (krahas ecurisë së elementeve të tjerë) në treguesit e kapitalit të sektorit bankar paraqitet në vijim. Rezultatet janë paraqitur në terma të mjaftueshmërisë së kapitalit për sektorin bankar në tërësi dhe të bankave individuale, respektivisht në fund të viteve 2012 dhe 2013.

[31] *Departamenti i Kërkimeve, në Bankën e Shqipërisë.*

Tabelë 7.4.2 a). Rezultatet për fundin e vitit 2012.

	Skenari bazë		Skenari i kredisë		Skenari i kursit të këmbimit	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali Rregullator		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest [1]/	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë [2]/	Jo		Jo		Po	
Kapital bazë (Kapitali bazë / Totali i aktiveve me rrezik)		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest [3]/	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë [4]/	Jo		Po		Po	

Tabelë 7.4.2 b). Rezultatet për fundin e vitit 2013.

	Skenari bazë		Skenari i kredisë		Skenari i kursit të këmbimit	
	Banka	Sektori	Banka	Sektori	Banka	Sektori
Kapitali rregullator		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I kapitalizuar
Nënkapitalizim modest [1]/	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë [2]/	Jo		Jo		Po	
Kapital bazë (Kapitali bazë / Totali i aktiveve me rrezik)		I kapitalizuar		I kapitalizuar		I nënkapitalizuar
Nënkapitalizim modest [3]/	Po		Po		Po	
Nënkapitalizim i rëndë [4]/	Jo		Po		Po	

[1]= Nën raportin prej 12%.
[2]= Nën raportin prej 8%.
[3]= Nën raportin prej 6%.
[4]= Nën raportin prej 3%.
Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Rezultatet e ushtrimit tregojnë që në tërësi, sektori bankar paraqitet i qëndrueshëm në rast të realizimit të supozimeve për treguesit përkatës. Niveli i kapitalizimit për të gjithë sektorin mbetet mbi nivelin minimal të kërkuar në rastin e skenarit bazë. Në rastin e skenarëve më të rënduar që përfshijnë supozimet përkatëse për uljen e normës së rritjes së PBB-së, uljen e nivelit të kreditimit dhe nënçmimin e kursit të këmbimit, banka të veçanta dhe sektori bankar mund të kenë nevojë për kapital shtesë. Në kushtet e presioneve nga zhvillimet ndërkombëtare dhe aktivitetit ekonomik në vend, bankat duhet të monitorojnë me kujdes veprimtarinë e tyre për të mundësuar një nivel të përshtatshëm kapitalizimi për çdo situatë.

Hapësirë informuese 7.4. Prova e rezistencës përmes përqasjes "poshtë-lart".

Aktualisht, për realizimin e ushtrimit të provës së rezistencës, Banka e Shqipërisë ndërton skenarët makroekonomikë dhe përdor të dhënat zyrtare të raportuara nga bankat individuale për të vlerësuar ndikimin e këtyre skenarëve në kapitalizimin e bankave. Në këtë rast, i gjithë procesi kryhet pranë Bankës së Shqipërisë pa përfshirë bankat. Kjo përqasje, konceptohet ndryshe si "nga lart – poshtë".

Gjatë vitit 2012, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë nismën e ndërtimit të ushtrimit të provës së rezistencës përmes përqasjes "nga poshtë-lart", që do të zhvillohet me një frekuencë vjetore. Siç mund të kuptohet, kjo përqasje synon vlerësimin e qëndrueshmërisë së bankave dhe të sektorit bankar ndaj goditjeve makroekonomike përmes përfshirjes së rezultateve të vlerësuara nga vetë bankat sipas skenarëve të ofruar nga Banka e Shqipërisë. Bankat duhet të vlerësojnë ndikimin e goditjeve në treguesit e aktivitetit të tyre në terma të zërave të bilancit, tabelës së të ardhurave dhe shpenzimeve, rrezikut të kredisë, rrezikut të tregut etj. Pas përpunimit të rezultateve, bankat individuale i dërgojnë ato në Bankën e Shqipërisë e cila i përpunon dhe i krahason ato me vlerësime të brendshme të formës "nga lart-poshtë". Çdo ndryshim në vlerësime midis Bankës së Shqipërisë dhe bankave individuale është objekt diskutimi në takimet e përbashkëta. Versioni përfundimtar i ushtrimit përmbledh vlerësimet e provës së rezistencës sipas rezultateve të bankave individuale të cilat janë rishikuar në rast nevoje.

Zbatimi i përqasjes "nga poshtë – lart" ofron mundësinë e përdorimit të një baze më të gjerë dhe më të detajuar të të dhënave të bankave në krahasim me ato që disponohen në Bankën e Shqipërisë, duke mundësuar potencialisht marrjen e rezultateve të një cilësie më të lartë. Gjithashtu, nëpërmjet angazhimit të bankave individuale në ushtrim, kjo përqasje rrit vigjilencën e tyre ndaj rreziqeve makroekonomike, si dhe nxit ndërtimin e kapaciteteve për realizimin e rregullt të ushtrimit të rezistencës nga vetë bankat.

Ushtrimi zyrtar i vitit 2012 u parapri nga një version pilot i realizuar në periudhën tetor-nëntor 2011, i cili iu drejtua të gjitha bankave të sektorit por ishte i detyrueshëm për 5 bankat më të mëdha. Në ushtrimin zyrtar u përfshinë 5 bankat më të mëdha në Shqipëri, aktivet e të cilave përfaqësonin 73.4% të totalit të aktiveve të sektorit bankar në fund të vitit 2011. Me krijimin e një baze më të gjerë rezultatesh dhe pas konsolidimit të cilësisë së tyre, ato do t'iu komunikohen bankave pjesëmarrëse, si edhe do të publikohen në formën e përshtatshme.

SHTOJCË 1. INDEKSI I FORTËSISË FINANCIARE[32]

ECURIA E INDEKSIT TË FORTËSISË FINANCIARE TË SEKTORIT BANKAR QERSHOR 2012

Vlerësohet se në fund të qershorit 2012, vlera e indeksit të fortësisë financiare ka zbritur në nivelin 83.3, duke shënuar një rënie me rreth 2.4% referuar fundit të vitit 2011, dhe një rritje të lehtë me 0.13% referuar të njëjtës periudhë të një viti më parë. Vlera e indeksit të fortësisë financiare paraqitet nën nivelin mesatar të periudhës[33] prej 94.7 dhe njëkohësisht poshtë nivelit të periudhës bazë (Dhjetor 2005=100). Rënia e indeksit u shkaktua si rezultat i efektit të kombinuar të ecurisë së nënindekseve përbërëse të indeksit të fortësisë financiare, si më poshtë:

- *Cilësia e aktiveve ka pësuar rënie të mëtejshme, si rezultat i rënies së nënindeksit në nivelin 66.5, nga 68.6 që vlerësohej në fund të vitit 2011. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së huave me probleme (bruto) dhe (neto) të sektorit bankar.*

- *Nënindeksi i likuiditetit ka shënuar rënie, me rreth 4.2% në nivelin 85.4 si rezultat i rënies së raportit përbërës të tij "aktive me maturim deri në 3 muaj/detyrime me maturim deri në 3 muaj", raport i cili në gjysmën e parë të vitit ra nga 77.2% në 73.1%.*

- *Nënindeksi i rrezikut të kursit të këmbimit ka shënuar rënie, çka tregon ekspozim më të lartë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, për shkak të llogaritjes së anasjelltë të këtij nënindeksi. Ky ekspozim më i lartë ka ardhur si rezultat i rritjes së raportit "zërat e bilancit[34]/kapitali rregullator" në 8.7% nga 3.7% e llogaritur në fund të vitit 2011.*

- *Nënindeksi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar rënie në gjysmën e parë të vitit 2012, me rreth 3.5% në nivelin 65.5. Edhe pse raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar përmirësim në qershor 2012, përbërësi tjetër i këtij nënindeksi, "kapitali i lirë[35]/totali i aktiveve" ka shënuar rënie në nivelin 24% nga 29% që llogaritej në fund të vitit 2011 si rezultat i rritjes së huave me probleme neto.*

---

[32] *Metodologjia e ndërtimit të Indeksit të Fortësisë Financiare është prezantuar në Raportin e Stabilitetit Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2010.*

[33] *Mesatarja i referohet periudhës dhjetor 2005-qershor 2012*

[34] *Zërat e bilancit i referohen diferencës aktive minus pasive në valutë, pa përfshirë zërat jashtë bilancit.*

[35] *Kapitali i lirë = Kapital aksioner - Aktive fikse (mjete të qëndrueshme+hua me probleme neto).*

Ndërkohë, nënindekset që kanë kontribuar pozitivisht në ecurinë e indeksit të fortësisë financiare dhe rrjedhimisht në performancën e sektorit bankar analizohen si më poshtë:

- *Nënindeksi i përfitueshmërisë ka shënuar një përmirësim të dukshëm në gjysmën e parë të vitit 2012, në nivelin 79.1 nga 71.1 në fund të vitit 2011, si rezultat i rritjes së njëkohshme të të dy raporteve përbërëse të këtij nënindeksi.*

- *Nënindeksi i rrezikut të normës së interesit ka shënuar rritje, gjë e cila tregon për një ekspozim më të ulët ndaj këtij rreziku si rezultat i llogaritjes së anasjelltë të këtij nënindeksi. Në gjysmën e parë të vitit 2012, vlera e nënindeksit rezultoi 102.3 nga 92.7 që llogaritej në fund të vitit 2011.*

Në vijim paraqitet grafikisht dhe në formë tabelore, ecuria e vlerave të indeksit të fortësisë financiare për sektorin bankar dhe e nënindekseve përbërëse të tij.

Grafik 8.1. Ecuria e Indeksit të Fortësisë Financiare.



Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Tabelë 8.1. Ecuria e nënindekseve dhe indeksit të fortësisë financiare për sektorin bankar.

Nënindekset	Cilësia e aktiveve	Rreziku i likuiditetit	Rreziku i kursit të këmbimit	Përfitueshmëria	Mjaftueshmëria e kapitalit	Rreziku i normës së interesit	Indeksi i Fortësisë Financiare
Dhjetor 05	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00	100.00
Mars 06	98.46	100.76	104.50	106.09	100.00	100.18	101.67
Qershor 06	96.97	100.02	155.33	100.70	94.77	91.54	106.56
Shtator 06	98.46	97.40	108.51	100.15	94.77	97.15	99.41
Dhjetor 06	98.46	91.40	114.78	100.50	94.77	91.92	98.64
Mars 07	98.15	95.17	110.97	104.88	89.54	96.55	99.21
Qershor 07	98.15	89.93	144.07	106.39	89.54	94.55	103.77
Shtator 07	97.83	91.45	102.89	105.88	101.41	97.67	99.52
Dhjetor 07	97.52	87.33	148.84	104.34	89.54	94.63	103.70
Mars 08	96.06	90.34	105.30	97.46	89.54	97.32	96.00
Qershor 08	92.09	79.46	149.27	99.57	89.54	87.29	99.54
Shtator 08	92.37	84.73	121.53	98.11	89.54	90.62	96.15
Dhjetor 08	84.92	76.86	130.95	90.01	89.54	100.27	95.43
Mars 09	83.81	77.25	149.27	72.69	89.54	102.82	95.90
Qershor 09	82.95	71.62	126.12	73.22	89.54	111.53	92.50
Shtator 09	81.83	77.80	122.23	73.16	89.29	108.74	92.18
Dhjetor 09	80.75	77.04	134.14	78.51	87.37	113.02	95.14
Mars 10	79.00	87.23	119.59	84.89	85.89	105.09	93.62
Qershor 10	78.70	77.14	110.50	86.68	86.72	108.03	91.29
Shtator 10	76.59	89.82	130.91	81.87	80.32	109.01	94.75
Dhjetor 10	76.26	80.19	111.71	84.75	79.33	95.84	88.01
Mars 11	75.60	83.61	124.25	75.65	74.20	93.93	87.87
Qershor 11	70.95	68.58	116.78	74.64	65.46	102.99	83.23
Shtator 11	69.16	84.72	129.52	73.53	65.86	100.84	87.27
Dhjetor 11	68.63	89.11	122.96	71.14	67.93	92.71	85.41
Mars 12	67.11	99.52	104.14	85.42	67.98	105.95	88.36
Qershor 12	66.54	85.36	101.26	79.11	65.52	102.27	83.34

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

SHTOJCË 2. INDEKSI I RREZIKUT SISTEMIK DHE REZULTATET E VROJTIMIT PËR PERCEPTIMIN E RREZIKUT SISTEMIK NGA BANKAT

Hapësirë informuese 8.1. Indeksi i rrezikut sistemik financiar për Shqipërinë (IRSF).

Matja e rrezikut sistemik dhe analiza e tij mbeten të rëndësishme në vendimmarrjen makroprudenciale, duke ndihmuar në identifikimin dhe vlerësimin e kërcënimeve të stabilitetit financiar.*

*Për këtë qëllim më poshtë është paraqitur indeksi i rrezikut** sistemik i cili mat nivelin e stresit financiar për ekonominë e vendit tonë, nëpërmjet informacionit mbi segmente të ndryshme të sistemit financiar, të agreguar në një tregues të vetëm. Treguesit e përdorur, të grupuar në 4 nënindekse, përfaqësojnë segmente të rëndësishme të sistemit financiar në një ekonomi: sektorin bankar, tregun e parasë, tregun e këmbimeve (kursi i këmbimit) dhe tregun e shtëpive. Këto nënindekse paraqiten të peshuara në mënyrë që të reflektojnë kontributin e tyre në sistemin financiar dhe në aktivitetin ekonomik të vendit. Ata gjithashtu synojnë të sigurojnë informacion të ndryshëm dhe plotësues mbi nivelin e stresit financiar në segmente të ndryshme të tregut.*

Grafik 8.1.1 Indeksi i rrezikut sistemik financiar.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

*Më sipër, paraqitet Indeksi i Rrezikut Sistemik Financiar (IRSF), sipas kontributit të secilit nënindeks (në të majtë) në nivelin e përgjithshëm të tij (në të djathtë), si edhe sipas vlerësimit të korrelacioneve (në të djathtë), duke përdorur variancë-kovariancat përkatëse të secilit nënindeks. Sipas këtij indeksi dallohen periudhat kryesore me një nivel më të lartë stresi. Përveç situatës së theksuar të stresit me një fillim në fundin e vitit 2008 për shkak të krizës financiare, fundi i vitit 2011 ka paraqitur një nivel të dallueshëm stresi në sektorin financiar, i cili ndonëse me një ritëm rënës, ka vijuar edhe përgjatë tremujorit të parë të vitit aktual. Kërkesa e tkurrur për kredi*** , oferta më e shtrënguar dhe cilësia e përkeqësuar e saj, ndryshimet në kursin e këmbimit dhe në çmimet e shtëpive, të pasqyruar edhe në*

efektin e kolateralit, kanë kontribuar në rritjen e nivelit të këtij indeksi të rrezikut sistemik financiar, kryesisht prej bashkëveprimit të segmenteve të ndryshme të sistemit financiar me njëri-tjetrin.

Përfshirja në këtë indeks e tregut të shtëpive, synon vlerësimin e ekspozimit të drejtpërdrejtë që ky treg përçon në tregjet e tjera në këtë sistem. Në rast të mospërfshirjes së tij, ecuria e indeksit të rrezikut sistemik financiar paraqitet në grafikun e mëposhtëm.

Grafik 8.1.2. Indeksi i stresit të sistemit financiar pa përfshirjen e nënindeksit të tregut të shtëpive.



Burimi: Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Sipas të dyja formave të vlerësimit, ekspozimi ndaj rrezikut ka pësuar një rënie graduale pas përfundimit të tremujorit të parë të vitit 2012.

* *Rrezik sistemik është quajtur materializimi i goditjeve kur mungesa e stabilitetit financiar merr përmasa të tilla që dëmtojnë funksionimin e sistemit financiar deri në masën që mirëqenia dhe rritja ekonomike preken në mënyrë materiale (Hollo et al, 2011).*

** *Një prezantim i detajuar i metodologjisë së përdorur për ndërtimin e Indeksit të Rrezikut Sistemik paraqitet në materialin "Një indeks për rrezikun sistemik financiar në Shqipëri", Vasilika Kota dhe Arisa Saqe, Departamenti i Stabilitetit Financiar, Banka e Shqipërisë, prezantuar në Workshop-in e 5-të të Kërkimeve në Evropën Juglindore, Tiranë, 10-11 nëntor 2011.*

*** *Sipas Vrojtimit të Aktivitetit Kreditues për tremujorin e parë 2012, përgatitur nga Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë.*

Hapësirë informuese 8.2. Rezultatet e vrojtimit "Perceptimi i rrezikut sistemik nga sektori bankar".

Ky vrojtim me frekuencë tremujore, i nisur në mars 2012, ka si qëllim të kuantifikojë perceptimet e bankave që operojnë në vend, lidhur me rreziqet sistemike që mund të kërcënojnë sektorin bankar. Në këtë vrojtim marrin pjesë të gjitha bankat. Nga rezultatet e vrojtimit të dytë (korrik 2012), konstatohet:

- *5 rreziqet e cilësuara më shpesh nga bankat, të renditura sipas madhësisë së ndikimit në sistemin financiar në rast të materializimit të tyre janë: 1) Përkeqësimi i ekonomisë së brendshme; 2) Transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme; 3)Vështirësi në ekzekutimin e kolateraleve; 4)Rritje e rrezikut të kreditit për bizneset; 5) Rritje e rrezikut të kreditit për të gjitha subjektet njëkohësisht.*

Grafik 8.2.1. Rreziqet më të vështira për t'u përballur në nivel institucioni.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

- *3 rreziqet sistemike më pak shqetësuese për sektorin bankar rezultojnë të jenë: 1) Rreziku i inflacionit në vend; 2) Probleme të funksionimit të tregut ndërbankar; 3) Probleme në funksionimin e sistemit të pagesave.*

- *Rreziqet sistemike që bankat konsiderojnë si "më të vështira" për t'u përballuar në nivel institucioni janë: "përkeqësimi i ekonomisë së brendshme" dhe "transferimi i goditjeve nga ekonomia e jashtme". Kjo për shkak të natyrës komplekse dhe gjithëpërfshirëse të tyre. Lidhur me rrezikun e "vështirësisë në ekzekutimin e kolateraleve", bankat e shohin problemin kryesisht tek mangësitë ligjore e rregullative që shkaktojnë vonesa në këtë proces.*

- *Rreth 53% e sistemit bankar percepton një probabilitet mesatar të ndodhjes së një rreziku të rëndësishëm sistemik në afat të shkurtër (deri në 12 muaj), ndërkohë që kjo frekuencë rritet në 56% në periudhën afatmesme (1-3 vjet).*

- *Rreth 67% e bankave të sistemit mendojnë se probabiliteti i ndodhjes së një rreziku sistemik është rritur në periudhën afatshkurtër deri në 1 vit dhe kjo përqindje rritet në 75% kur horizonti kohor shtrihet në periudhën afatmesme 1-3 vjet.*

Grafik 8.2.2 Probabiliteti i ndodhjes së një rreziku të rëndësishëm sistemik.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

Grafik 8.2.3. Ndryshimi i probabilitetit të ndodhjes së një rreziku sistemik.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

- *Ndër strategjitë kryesore të cilësuara nga bankat për zbutjen e rrezikut sistemik në periudhën afatshkurtër janë: "forcimi i sistemeve të brendshme të kontrollit" dhe "shtrëngimi i kushteve të kreditimit". Me shtrirjen e horizontit kohor në afat të mesëm, bankat e vënë më shumë theksin në strategjitë e "diversifikimit të aktivitetit", "shtimin e kapitalit", "ndërmarrjen e politikave për të rritur depozitat" dhe "orientimin drejt sektorëve strategjikë të ekonomisë".*

- *Pavarësisht rritjes së rreziqeve të perceptuara, shumica e bankave deklarojnë se kanë besim të mjaftueshëm në sistemin financiar në vend si për periudhën afatshkurtër ashtu edhe për atë afatmesme. Kështu, në vrojtimin e korrikut 2012, 10 nga 16 banka (në total zotërojnë 76% të aktiveve të sistemit), deklarojnë se kanë besim të mjaftueshëm në sistemin financiar në periudhën afatshkurtër dhe ky numër rritet në 11 banka (77% e aktiveve të sistemit) në periudhën afatmesme.*

Grafik 8.2.4. Besueshmëria e bankave në sistemin financiar shqipëtar.



Burimi: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Stabilitetit Financiar.

- *Të pyetura se si ka ndryshuar niveli i besimit në sistemin financiar në vend gjatë 6 muajve të kaluar (duke patur si referencë muajin korrik 2012), 14 nga 16 banka të përgjigjura kanë deklaruar se niveli i besimit të tyre nuk ka ndryshuar, pasi sistemi është i mirëkapitalizuar dhe likuid.*